



INTERNATIONAL
NUREMBERG
PRINCIPLES
ACADEMY

Botim Special nr. 1

**Drejtësia Tranzicionale
në Gjermani pas 1945
dhe pas 1990**

nga Sanya Romeike



Ky botim eshte bere nen kujdesin e Grupit Shqiptar te te Drejtave te Njeriut
www.ahrg-al.org



INTERNATIONAL
NUREMBERG
PRINCIPLES
ACADEMY

Botim Special nr. 1

Drejtësia Tranzicionale në Gjermani pas 1945 dhe pas 1990

nga Sanya Romeike





Shënim

Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut (Akademia e Nurembergut) është një fondacion i përkushtuar ndaj zhvillimit dhe avancimit të së drejtës ndërkombëtare penale. Ky fonacion i cili e ka selinë në Nuremberg, qytetin që njihet si vendlindja e së drejtës ndërkombëtare penale moderne, është i konceptuar ndër të tjera si një forum për diskutimin e çështjeve bashkëkohore në këtë fushë.

Misioni i Akademisë së Nurembergut është që të promovojë universalitetin, ligjshmërinë dhe pranimin e së drejtës ndërkombëtare penale. Fushat kryesore të veprimtarisë përfshijnë kërkimin ndërdisiplinor, trajnimet dhe shërbimet e këshillimit të përshtatura posaçërisht për grupet e synuara dhe edukimin e të drejtave të njeriut. Akademia e Nurembergut ka në një fokus të veçantë bashkëpunimin me vendet dhe shoqëritë që përballen me sfida që lidhen me të drejtën ndërkombëtare penale.

Akademia e Nurembergut u themelua nga Ministria e Jashtme Gjermane, Shteti i Bavarisë dhe qyteti i Nurembergut.

Sanya Romeike, autorja e këtij botimi, ka studiuar histori bashkëkohore, histori të antikitetit dhe gjuhë angleze në Universitetin Otto-Friedrich në Bamberg. Më pas ajo ka punuar si hulumtuese dhe mësimdhënëse në Universitetin e Kielit. Aktualisht ajo jeton në Berlin dhe punon si konsulente e pavarur dhe historiane. Ajo është e interesuar në çështje që lidhen me të drejtat e njeriut dhe shkeljet e këtyre të drejtave gjatë diktaturave, përballjen në me të kaluarën dhe kulturat përkujtimore.

Imazhet që shfaqen gjatë publikimit paraqesin detaje nga Salla nr. 600 në të cilin Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak u zhvillua gjatë 1945-1946 (fotot u realizuan nga Torsten Honig).

Opinionet e shprehura në këtë botim i përkasin vetëm autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Akademisë së Nurembergut.

Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut

Egidienplatz 23
90403 Nuremberg
Tel +49 911 231-10379
Fax +49 911 231-14020
info@nurembergacademy.org
www.nurembergacademy.org

© 2016 International Nuremberg Principles Academy

Pasqyra e lëndës

4 Shënim

5 Pasqyra e lëndës

7 Lista e Shkurtimeve

9 Parathënie

10 1. Hyrje: Çfarë është Drejtësia Tranzicionale?

13 2. Drejtësia Tranzitore pas vitit 1945: Përballja me diktaturën Nacional-socialiste.

13 a) Sfidat dhe rrethanat

14 b) Ndjekja penale: Kriminelët Nacional-socialistë përpara gjyqit

14 I. Gjykimi i krimeve naziste nga Gjykatat Ndërkombëtare

17 II. Gjykimi i krimeve naziste nga gjykatat gjermane të Zonave të Pushtuara Perëndimore dhe të RFGJ-së

21 III. Gjykimi i krimeve naziste nga gjykatat gjermane në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

24 c) Lustracioni: “Denazifikimi” i shoqërisë gjermane

24 I. “Denazifikimi” në Zonat Perëndimore dhe në RFGJ

27 II. “Denazifikimi” në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

29 d) “Wiedergutmachung”: Reparacionet, Kthimi dhe Dëmshpërblimi

29 I. Pretendimet e Fuqive Fitimtare për reparacione

31 II. Politika e Dëmshpërblimit në RFGJ

34 III. Politika e Kompensimit në RDGJ

36 e) Dokumentimi, Paralajmërimi, Përkujtimi

36 I. Riedukimi dhe Edukimi Qytetar në Zonat Perëndimore dhe RFGJ

37 II. Përmbysja “Antifashiste - Demokratike” në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

38 III. Kulturat Përkujtimore në “Lindje” dhe “Perëndim”

45 3. Drejtësia Tranzicionale pas vitit 1990: Përballja me Diktaturën në RDGJ

45 a) Sfidat dhe Rrethanat

47 b) Ndjekja Penale: Gjykimi i Krimeve të kryera në RDGJ

51 c) Lustracioni: “Destasifikimi” i Shërbimit Civil

55 d) Rehabilitimi dhe Rivendosja e së Drejtës

55 I. Ligje për Korrigjimin e Padrejtësive ndaj viktimave të regjimit

57 II. Zgjidhja e Çështjes së Pronës përmes kthimit dhe kompensimit

60 e) Dokumentimi, Paralajmërimi, Përkujtimi

65 4. Përfundime

68 Bibliografi





Lista e Shkurtimeve

- RFGj** Republika Federale Gjermane
- BStU** Bundesbeauftragter für die Unterlagen des Staatssicherheitsdienstes der ehemaligen Deutschen Demokratischen Republik – Komisioneri Federal për Dosjet e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit në Ish Republikën Demokratike Gjermane
- RDGJ** Republika Demokratike Gjermane
- Gestapo** Policia Sekrete e Shtetit
- TUN** Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar
- DKK 38** Direktiva Nr. 38 e Këshillit të Kontrollit
- KKA 10** Ligji Nr. 10 i Këshillit Aleat të Kontrollit
- MfS** Ministerium für Staatssicherheit – Ministria për Sigurinë e Shtetit
- NS** Nacional-socializëm
- NSDAP** Nationalsozialistische Deutsche Arbeiterpartei – Partia Punëtore Nacional-socialiste Gjermane (Partia Naziste)
- SED** Sozialistische Einheitspartei Deutschlands – Partia e Unitetit Socialist të Gjermanisë
- SOZ** Zona Sovjetike e Pushtuar
- SMAD** Sowjetische Militäradministration in Deutschland – Administrimi Ushtarak Sovjetik në Gjermani
- SS** Schutzstaffel Skuadroni Mbrojtës i NSDAP





1. Hyrje

Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut prezanton këtë studim mbi përvojën gjermane të përbaljes me të kaluarën pas Luftës së Dytë Botërore në 1945, dhe fundin e diktaturës komuniste të Gjermanisë Lindore në 1990. Studimi është shkruar nga historiania gjermane Sanya Romeike, në emër të Akademisë.

Ky publikim dëshiron t'u japë lexueseve, në veçanti atyre nga ato vende të cilat sot përballesh me të kaluarën e tyre të diktaturës dhe luftës, një pamje të përgjithshme të historisë dhe përvojës gjermane të 70 viteve të fundit. Studimi hap një dritare për lexuesin nëpërmjet aksesit në përvojën gjermane. Gjithashtu, ky studim dëshiron të mbështesë lexuesit e tij në kërkimet e tyre të mëtejshme me informacioneve më të detajuara, nëpërmjet burimeve që gjenden në faqen e internetit të Akademisë Ndërkombëtare të Parimeve të Nurembergut.

Ky botim përvijon koncepte të drejtësisë së tranzicionale, por nuk pretendon të analizojë historinë e Gjermanisë nga kjo pikëpamje. Prandaj, disa aspekte (si garancitë për jo-përsëritje) janë përjashtuar për të mos tejkaluar limitet e këtij projekti.

Më tej, ky botim hedh dritë mbi barrierat e shumta dhe kohën që i është dashur Gjermanisë të arrijë në pikën ku është sot: një shembull i njohur në nivel ndërkombëtar si një shtet që në mënyrë intensive dhe të suksesshme arriti të përballet me të kaluarën e vet. Në të njëjtën kohë, kritika e parashtruar nga autorja tregon se sa shumë punë i mbetet për të bërë akoma Gjermanisë. Në një shembull, autori shkruan:

“Fakti që shoqëria gjermane ishte e aftë të kalonte nga një gjendje shtypjeje dhe heshtjeje, në një aksion aktiv ndaj krimeve dhe fajit, shpesh konsiderohet një faktor kryesor në demokratizimin e saj. Megjithatë, trajtimi i së kaluarës naziste ka qenë dhe akoma mbetet një proces i jo i lehtë dhe unanim, madje është një proces i mbrujtur nga debate të nxehta. Deri më sot, ky proces hasur kundërsh-time të shumta për mënyrën e drejtë të trajtimit dhe interpretimit të së kaluarës; megjithatë, kjo është gjithashtu pjesë e përbaljes me të.

Ky paragraf i marrë nga studimi i znj. Romeike thekson fokusin paradigmatic të këtij botimi:

“Nga njëra anë, ky botim dëshiron të kontribuojë në diskutimet aktuale në vendet në konflikt dhe pas-konflikti, duke shpresuar se këto diskutime do të ndikojnë në adresimin e gabimeve e të kaluarës.

Nga ana tjetër, dëshiron të kontribuojë në diskutimet e këtushme mbi të kaluarën, duke qenë se këto debate në Gjermani ende nuk kanë përfunduar.

Akademia dëshiron të falënderojë znj. Romeike për dedikimin dhe për gatishmërinë për t'u angazhuar një diskutim të frytshëm edhe me anëtarët e Akademisë. Falënderim i veçantë u shkon të gjithë atyre që kanë mbështetur, nëpërmjet rishikimeve kritike të tekstit dhe këshillave të tyre, znj. Romeike dhe Akademinë në këtë projekt.

Bernd Borhardt

Drejtor Themelues

Akademia Ndërkombëtare e Parimeve të Nurembergut



1. Hyrje: Çfarë është Drejtësia Tranzicionale?

Shekulli i XX njihet edhe si “periudha e ekstremeve”, e karakterizuar nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, luftërat, tirania, por edhe nga lëvizjet për demokratizim dhe liberalizim. Pyetjet mbi mënyrën “e duhur” për t’u përballur me këto krime, tranzicionet e suksesshme, mënyrat për të vendosur paqe të qëndrueshme dhe siguri në situata post-konflikti, kanë marrë një rëndësi të veçantë në shekullin e XX. Në këtë kontekst lindi edhe koncepti i “Drejtësisë Tranzicionale”, dhe që tashmë ka marrë një rëndësi globale. Drejtësia Tranzicionale, sipas Buckley-Zistel, i referohet “instrumenteve dhe përpjekjeve për t’u përballur me të kaluarën pas një konflikti apo regjimi të dhunshëm dhe që bëjnë të mundur tranzicionin drejt një shoqërie të qëndrueshme në paqe dhe më demokratike”.¹

Ky term u përdor për herë të parë në vitet 1990, koha e transformimeve globale të pas Luftës së Ftohtë. Termi buron nga lëvizjet e të drejtave të njeriut dhe koncepti fillestar i referohej ndjekjes penale të shkeljeve së të drejtave të njeriut të kryera nga regjimet e kaluara diktatoriale dhe shtypëse. Përveçse për të mbajtur gjallë një punë të rëndësishme akademike, ideja e drejtësisë tranzicionale u përshtat dhe u përvetësua gjatë dy dekadave të fundit nga organizatat ndërkombëtare, komuniteti i ndërtuesve të paqes (peace-building) dhe të drejtave të njeriut. Si rrjedhojë kuptimi i këtij termi u zgjerua për t’u bërë ombrellë për një shumëllojshmëri instrumentesh, mekanizmesh dhe masash që shkojnë përtej aspektit ndëshkues të përballjes me të kaluarën.²

Sot, koncepti i drejtësisë tranzicionale karakterizohet nga lidhja e ngushtë mes fazës së tranzicionit dhe realizimit të drejtësisë. Kjo e fundit nuk duhet kuptuar vetëm në aspektet juridike. Koncepti përçon idenë se paqja dhe siguria mund të vendosen në vend vetëm kur krimet e mëparshme të luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të adresohen nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm. Vetëm «një sqarim i plotë i padrejtësive të së shkuarës»³ parandalon që e kaluara të bëhet barrë për të ardhmen. Vetëm një shkëputje prej saj bën të mundur “parandalimin e krimeve të ardhshme, krijimin e besimit në një formë të re qeverisëse dhe arritjen e pajtimit të palëve në konflikt”.⁴ Me kalimin e kohës është zhvilluar një shumëllojshmëri instrumentesh që merren me të kaluarën, me qëllim parandalimin dhe mos përsëritjen e krimeve dhe konflikteve. Më të rëndësishmet ndër to janë:

- ndjekja penale nga gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- kërkimi i së vërtetës p.sh. ekspozimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut përmes komisioneve të së vërtetës (truth commissions);
- Dëmshpërblimi (reparations) për viktimat në formë rehabilitimi, kompensimi (financiar apo material) dhe kthimit (të pasurive);
- reformat institucionale (veçanërisht ato në gjyqësi, polici dhe ushtri) dhe largimi i autorëve, veçanërisht të elitave të vjetra nga poste të rëndësishme shoqërore; dhe
- përkujtimi p.sh nëpërmjet ngritjes së përmendoreve dhe muzeve.

Proceset e transformimit pas konfliktesh të dhunshme janë komplekse dhe unike. Shumica e rasteve kërkon kombinimin e masave të ndryshme për t’u marrë efektivisht me

¹ Përkthyer nga gjermanishtja, Buckley-Zistel, Susanne. 2007. Handreichung. “Transitional Justice” faqe 2-7; Buckley-Zistel, Susanne. 2008. “Transitional Justice als Weg zu Frieden und Sicherheit. Möglichkeiten und Grenzen.” SFB-Governance Working Paper Series 15.

² Cituar nga Fischer, Martina. 2011. “Transitional Justice and Reconciliation. Theory and Practice”. Në: Austin, Beatrix et al. (ed) Advancing Conflict Transformation. The Berghoff Handbook II, faqe 406-430. Opladen: Barbara Budrich Publishers, Buckley-Zistel et al. 2014. “Transitional Justice Theories: An Introduction”. Në: Buckley-Zistel et al, (ed) Transitional Justice Theories. Abingdon: Routledge, faqe 1-3.

³ Përkthyer nga gjermanishtja; Buckley-Zistel, Handreichung, faqe 2.

⁴ Cituar nga Teitel, Ruti G. 2003. “Transitional Justice Genealogy”. Harvard Human Rights Journal 16:69-94.



të kaluarën. Në të njëjtën kohë, përvoja ka treguar se edhe ndërmjet masave të zgjedhura si dhe kërkesave dhe nevojave të tjera të shoqërisë në tranzicion mund të krijohen tensione. Në veçanti, tension ekziston midis nocioneve të ndryshme: «drejtësisë» dhe «paqes», dy qëllime të rëndësishme të drejtësisë së tranzicionale; «ndëshkimit» dhe «pajtimit»; «drejtësisë ndëshkuese» dhe «asaj restauruese».⁵ Kështu, vetë drejtësia e tranzicionale përfshin si një potencial të caktuar konfliktesh, ashtu edhe mundësi të mëdha për të transformuar shoqërinë. Konteksti i tranzicionit dhe sfidat e tij, rrethanat dhe kërkesat e palëve dhe qytetarëve diktojnë mekanizmat që do të përdoren dhe nëse këto të fundit do të jenë të suksesshme. Gjithashtu, rol të rëndësishëm dhe vendimtar luajnë: lloji i konfliktit të mëparshëm, mënyra e zgjidhjes së konfliktit, suksesi apo jo i tranzicionit në lidhje me çrrënjosjen e regjimit të vjetër, si karakteri ashtu edhe dimensionet e padrejtësive të kaluara, stabiliteti i vendit të prekur, disponueshmëria e burimeve, qëndrimi i qeverisë së re, si dhe struktura e rendit shoqëror.

Ky studim dëshiron të përshkruajë dhe diskutojë përvojën gjermane të përballjes me të kaluarën e saj të pas Luftës së Dytë Botërore dhe rënies së diktaturës komuniste. Studimi nuk pretendon të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse historinë gjermane nga perspektiva e studimeve të drejtësisë së tranzicionale. Megjithatë, të dhënat e paraqitura kanë për synim të japin informacion mbi mënyrën që Gjermania zgjodhi për t'u përballur me të kaluarën e saj. Kjo mendohet të jetë me interes për lexuesit dhe sidomos për ata që vijnë nga ato vende të cilat po përjetojnë ose kanë përjetuar konflikte të dhunshme apo sundimin shtypës. Sot Gjermania konsiderohet ndërkombëtarisht një shembull i një konfrontimi relativisht të suksesshëm me të kaluarën. Studimi gjithashtu zbulon se sa angazhues dhe polemik mund të jetë procesi i menaxhimit të tranzicionit, duke marrë si tregues edhe kohën e gjatë që është dashur për të arritur këtë qëllim, nivelin dhe shumëllojshmërinë e kundërshtive të hasura gjatë përballjes së Gjermanisë me të kaluarën e saj, pas vitit 1945 dhe pas 1989/90.

⁵ Cituar nga Clark, Phil dhe Palmer, Nicole: Challenging Transitional Justice. Në: Id. Granville, Danielle (ed.) Critical Perspectives in Transitional Justice. Antwerpen 2012, faqe 1-16. Lustracioni, p.sh, mund të konsiderohet krahas nevojës për rindërtim social (siç mund të jetë nevoja për punonjës të aftë). Shpesh, kjo nuk është e mundur të bëhet pa amnistuar dhe ri-integruar personat fajtorë në shoqëri. Megjithatë, kjo mund të shkaktojë pakënaqësi dhe hakmarrje nga ana e viktimave, ose edhe diskriminim apo persekutim të ri nga elitat e vjetra.



2. Drejtësia Tranzitore pas vitit 1945: Përballja me diktaturën Nacional-socialiste

a) Sfidat dhe rrethanat

Procesi i sqarimit të së kaluarës dhe diktaturës Nacional-Socialiste (Naziste) në Gjermani pas 1945 është konsideruar si një nga rastet më komplekse dhe të larmishme në drejtësinë tranzicionale të periudhës së pasluftës.⁶ Së pari, kjo mund t'u atribuohet sfidave të mëdha me të cilat u përball, e më tej rrethanave specifike në të cilat ndodhi ballafaqimi me diktaturën e kaluar Naziste dhe pasojat e saj.

Dorëzimi pa kushte i Vermahtit (forcave të armatosura të regjimit nazist) më 8 maj 1945, jo vetëm që i dha fund Luftës së Dytë Botërore në Evropë, por edhe plot 12 vjet diktaturë NS-te. Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, Gjermania humbi sovranitetin e saj të cilin e rimori vetëm pas vitit 1949, vit në të cilin u krijuan dy shteteve të reja gjermane: Republika Federale e Gjermanisë (FRGJ) dhe Republika Demokratike Gjermane (RDGJ). Fuqitë fitimtare të koalicionit kundër Hitlerit: Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe së bashku me Francën morën së bashku autoritetin suprem mbi Gjermaninë. U takoi atyre të vendosnin për mënyrën se si do të merreshin me vendin ku lufta dhe politika e asgjësimit e cilit kishte tejkaluar si në karakter ashtu edhe në masë çdo krim të njohur nga bota deri më atëherë.

Lufta e ndërsyer nga Gjermania kishte sjellë dhunë në pothuajse çdo cep të Evropës dhe u kishte kushtuar jetën më shumë se 40 milionë njerëzve.⁷ Nacional-socialistët kishin ngritur regjime terrori në shumë vende evropiane. Kundërshtarët socialë dhe politikë u persekutuan, grupe të ndryshme njerëzish u stigmatizuan si «anti-socialë», «kriminelë», dhe «ciganë», po ashtu homoseksualët, “Dëshmitarët e Jehovahit”, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, pacientët psikiatrik dhe sidomos hebrenjtë, u deportuan në kampe përqendrimi, u skllavëruan, torturuan, abuzuan, u mbyllën në geto, u zhveshën nga e drejta e votës dhe pronës, u vranë sistematikisht në ekzekutime masive, në kampet e shfarosjes dhe përmes të ashtuquajturës “eutanazi.” Gjithë kjo u rëndua edhe më tej nga krimet kundër të burgosurve të luftës, partizanëve, civilëve madje edhe kundër ushtarëve të tyre, si edhe skllavërimi i miliona njerëzve përmes punës së detyruar.

Në dritën e këtyre krimeve, Aleatët kishin filluar që para mbarimit të luftës të thurnin plane për të ardhmen e Gjermanisë së pasluftës. Qëllimi i tyre kryesor ishte eliminimi i plotë i nazizmit dhe i militarizmit brenda shoqërisë gjermane për të parandaluar çdo agresion të mundshëm dhe kërcënim të paqes globale nga ana e Gjermanisë.⁸ Në tetor të vitit 1943, Aleatët vendosën të ndëshkojnë kriminelët gjermanë të luftës dhe t'i dorëzojnë autorët nazistë atyre vendeve në të cilat ata kishin kryer krime. Atje, ata do të dënoheshin në përputhje me ligjet në fuqi të vendit përkatës. «Kriminelët më të mëdhenj të luftës», nga ana tjetër, u sollën përpara Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar (International Military Tribunal, shkurtuar si TUN) ku u dënuan nga fuqitë fitimtare të bashkuara. Planet e Aleatëve nuk përfunduan me ndjekjen penale të krimeve. Duke pasur parasysh rrënjosjen e thellë të Nacional-Socializmit në shoqërinë gjermane dhe milionat e bashkëpunëtorëve, mbështetësve, përfituesve dhe oportunistëve që kishin mbështetur regjimin nacional-socialist deri në rrëzimin e tij të plotë, u mendua se kishte ardhur koha për një spastrim të Nacional-Socialistëve nga postet e rëndësishme

⁶ Cohen, David. 2006. “Transitional Justice in Divided Germany after 1945”. Në: Elster, John (ed.) *Retribution and Reparation in the Transition to Democracy*. faqe 59-89. Cambridge University Press.

⁷ Në tërësi, rreth 55 milion njerëz humbën jetën gjatë Luftës së Dytë Botërore.

⁸ Qëllimet e Aleatëve përfshinin të ashtuquajturat katër (ose pesë) D-të: çmilitarizimin, denazifikimin, decentralizimin, demokratizimin (dhe deindustrializimin).



shoqërore (“denazifikimi”) dhe një «riedukim» i të gjithë shoqërisë gjermane. Për më tepër, Gjermania duhet të ndreqte dëmet e shkaktuara të luftës, paguante reparacione dhe përgjigjej për krimet e saj (të gjitha këto përmbledhen tek «Wiedergutmachung» që fjalë për fjalë mund të përkthet si “ta ndreqësh, ta rikthesh siç ishte apo ta bësh mirë sërish”).⁹

Deri në themelimin e dy shteteve gjermane në vitin 1949, dhe pjesërisht më pas deri në mes të viteve 1950,¹⁰ çështja e përballjes me të kaluarën në Gjermani drejtohej dhe kontrollohej nga aktorë të jashtëm. Pavarësisht planeve të përbashkëta, kishte shumë pak koordinim dhe veprim të përbashkët nga ana e Aleatëve. Aleatët kishin dallime në qëllime dhe pikëpamje kontradiktore mes tyre, që buronin nga botëkuptimet,¹¹ përvojat e ndryshme me regjimin nazist dhe interesat politike. Për shkak të ndarjes së Gjermanisë në katër zona të pushtuara, secila nën kontrollin e njëres prej forcave fitimtare, u zhvilluan qasje të ndryshme. Dallimet më të mëdha ekzistonin midis Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe dhe Francës në njërin anë, vende të cilat kishin si qëllim vendosjen e një demokracie të stilit perëndimor; dhe Bashkimit Sovjetik në anën tjetër, i cili kishte për qëllim të krijonte një rend shoqëror socialist nën udhëheqjen komuniste me ndihmën e komunistëve gjermanë. Kjo e fundit rezultoi në krijimin e një diktature të stilit sovjetik. Në varësi të interesit dhe në diskrecionin e secilës forcë pushtuese, gjermanët ishin më pak ose më shumë të përfshirë në procesin e përballjes me të kaluarën. Për pasojë edhe interesat e tyre u morën diku më pak e diku më shumë në konsideratë. Edhe pas kalimit të përgjegjësisë vendimmarrëse në duart dy shteteve gjermane, nuk u arrit ndonjë qasje e unifikuar në lidhje me ballafaqimin me të kaluarën naziste. Kjo për shkak të sistemeve të tyre mjaft të ndryshme politike dhe ekonomike por edhe identiteteve të ndryshme kombëtare.¹²

Seksionet në vijim mbi masat e përveçme të drejtësisë tranzicionale të ndërmarra në katër zonat e pushtuara dhe dy shtetet gjermane tregojnë se ballafaqimi me të kaluarën pas vitit 1945 ishte një proces i ndërlikuar dhe i paqëndrueshëm. Role vendimtare në këto procese luajtën agjentë të ndryshëm të cilët kishin interesa të lëkundshme, synime dhe interpretime të ndryshme të së kaluarës. Kështu faza të caktuara ishin edhe më intensive se të tjerat. Sidomos në dekadën e pas-luftës, vihen re një shumëllojshmëri qasjesh konfuzë ku mbizotëruan kontradikta të shumta dhe pasoja të padëshiruara apo të paqëllimshme.

b) Ndjekja penale: Kriminelët Nacional-socialistë përpara gjyqit

I. Gjykimi i krimeve naziste nga Gjykatat Ndërkombëtare

Gjyqi i të ashtuquajturve kriminelë kryesorë të luftës përpara Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar filloi menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore më 20 nëntor 1945, në Nuremberg, “qytetin e tubimeve të partisë naziste dhe ligjeve raciale.”¹³

⁹ “Wiedergutmachung” nuk gjen përkthim fjalë për fjalë në shqip. Përshtatur në shqip nga redaktori.

¹⁰ Në vitet 1954-1955, të dyja shteteve (më së shumti) iu rikthyte sovraniteti: FRGJ-së përmes heqjes së Gjendjes së Pushtimit dhe RDGJ përmes një deklaratë nga ana e Bashkimit Sovjetik.

¹¹ Veçanërisht kuptimi i ndryshëm mbi demokracinë dhe rrënjët e Nacional-socializmit ose fashizmit.

¹² Në kontekstin e konkurrencës ideologjike të Luftës së Ftohtë, RFGJ, e konsideronte veten si vazhduesen ligjore të “Rajhut të Tretë” duke u distancuar prej tij në të njëjtën kohë dhe u vete-deklaruar si “Shtet anti-totalitar”, ndërsa RDGJ u vetë-deklarua si një shtet i ri pa asnjë lidhje apo përgjegjësi në lidhje me të shkuarën nacional-socialiste.

¹³ Reichel, Peter. 2009. “Der Nationalsozialismus vor Gericht und die Rückkehr zum Rechtsstaat”. Në Reichel, Peter et al. (ed.) Nationalsozialismus - die zweite Geschichte: Überwindung, Deutung, Erinnerung. faqe 22-26. München C.H. Beck; Cohen, “Transitional Justice”, faqe 60-63; Steinbach, Peter. 1999. “Der Nürnberger Prozeß gegen die Hauptkriegsverbrecher”. Në Ueberschär, Gerd R. (ed.) Der Nationalsozialismus vor Gericht. Die alliierten Prozesse gegen Kriegsverbrecher und Soldaten 1943-1952. faqe 32-44. Frankfurt am Main: Fischer Verlag; Zentgraf, Henrike. 2013. “Nürnberg” in Vergangenheit und Gegenwart. Aus Politik und Zeitgeschichte 63:8-14; Reichel, Peter. 2001. Vergangenheitsbewältigung in Deutschland. Die Auseinandersetzung mit der NS-Diktatur von 1945 bis heute. München: C.H. Beck Verlag; Weinke, Annette. 2006. Die Nürnberger Prozesse. München: C.H. Beck Verlag, faqe 17-58.

Qëllimet aleate ishin të shumëfishta. Duke qenë se dukej e pamundur kapja dhe ndëshkimi i të gjithë autorëve Nacional-Socialistë, Aleatët vendosën të ndjekin penalisht të paktën ata që identifikoheshin si aktorët kryesorë përgjegjës, të ekspozojnë krimet më të rënda dhe të vendosin në vend drejtësinë në kuptimin simbolik të fjalës. Prandaj, banka e të pandehurve në Nuremberg përmbloodhi udhëheqjen e «Rajhut të Tretë» (ata të cilët kishin mbetur gjallë ose nuk kishin hequr dorë nga përgjegjësitë e tyre duke kryer vetëvrasje, siç bëri Adolf Hitleri, Josef Goebbels dhe Heinrich Himmler¹⁴). Megjithatë, qëllimi nuk ishte (vetëm) akuza ndaj një grupi të vogël individësh, por akuza ndaj përfaqësuesve të regjimit Nacional-Socialist. Për këtë arsye, 24 të pandehurit¹⁵ e zgjedhur për t'u vënë përpara drejtësisë në Nuremberg mishëronin organet qendrore udhëheqëse shtetërore dhe administrative, ushtarake dhe të Partisë Naziste (NSDAP), autoritetet pushtuese, skuadronet SS-se, policinë, industrinë e luftës dhe ekonominë private. Qëllimi i Aleatëve u bë veçanërisht i dukshëm në shpalljen dhe ndëshkimin e gjashtë institucioneve si «organizata kriminale». Këto përfshinin qeverinë, korpusin udhëheqës të NSDAP-it, skuadronet SS-se përfshirë këtu edhe Shërbimin e Sigurisë SD, Gestapon, SA-në (the Storm Detachment) dhe Shtabin e Përgjithshëm të Komandës Supreme të Vehrmaht-it.

Në mënyrë që të përballeshin me cilësinë dhe sasinë e pashembullt të krimeve, dhe për të kontribuar në avancimin e të drejtës ndërkombëtare, fuqitë fitimtare «krijuan një bazë të re juridike»¹⁶ përmes hartimit të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak (Statuti i TUN). Ky Statut përbënte bazën ligjore të gjykimit dhe krijonte e përcaktonte rregullat procedurale, veprat penale dhe akuzat përkatëse. Një risi në të ishte jo vetëm gjykata e sapo themeluar dhe e përbërë nga gjyqtarë dhe prokurorë nga të katër fuqitë fituese, por edhe akuzat e ngritura.

Këto akuza u ngritën në bazë të katër grupeve të (veprave penale apo) krimeve:¹⁷

- Planifikimi dhe bashkëpunimi kriminal për kryerjen e krimeve kundër paqes, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit;
- Krimet kundër paqes: planifikimi, përgatitja, fillimi dhe zhvillimi i një lufte agresioni;
- Krimet e luftës: shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës; dhe
- Krimet kundër njerëzimit: duke përfshirë vrasje, shfarosje, skllavërim, dëbim dhe persekutim mbi baza politike, racore ose fetare.

Akuzat e ngritura për pikat 2 dhe 3 u bazuan në traktatet apo marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese, si Konventa e Gjenevës apo Pakti «Kellogg-Briand», të cilat ishin shkelur nga aktet në fjalë. Ndërsa dy akuzat e tjera ende nuk ishin kodifikuar dhe nuk njiheshin ndërkombëtarisht si krime apo ndjekur penalisht si të tilla. Aleatët kishin për qëllim t'i jepnin fund kësaj kulture të mosndëshkimit duke kërkuar për herë të parë në histori që përfaqësuesit shtetërorë të konsideroheshin personalisht përgjegjës për krime të këtij lloji.¹⁸

Risia e dy akuzave të mësipërme dhe procedurës së parashikuar në Statutin e TUN çoi në polemika të shumta. Ndër të tjera, ky statut u kundërshtua me arsyetimin se

¹⁴ Për një listë të plotë të akuzuarve dhe funksionet e tyre në shtetin nazist, shih: Weinke, Nürnberg Prozesse, faqe 29.

¹⁵ Nga 24, vetëm 21 të pandehur ishin të pranishëm gjatë gjykimit: njeri prej tyre kishte kryer vetëvrasje përpara fillimit të procesit; një tjetër u deklarua i paaftë për gjykim dhe i fundit në pamundësi për t'u arrestuar u dënua në mungesë.

¹⁶ Zentgraf, «Nürnberg», faqe 9. përkthyer nga gjermanishtja.

¹⁷ Për nja pasqyrë të të pandehurve, akuzave dhe dënimeve përkatëse, shih Reichel, Nationalsozialismus, faqe 29. Për një përshkrim të detajuar të të gjitha vendimeve, shih Internationaler Militärgerichtshof. 1946. Das Urteil von Nürnberg. Grundlagen eines neuen Völkerrechts. Vollständiger Text. München: Nymphenburger Verlagshandlung.

¹⁸ Një tjetër risi në ligjin ndërkombëtar ishte aktakuza ndaj 6 institucioneve të deklaruara si organizatave kriminale. Në lidhje me këtë, Karta e TUN vendosi që nëse një organizatë ishte deklaruar si kriminale nga Gjyqi i Nurembergut, anëtarët e saj mund silleshin përpara gjyqit si përgjegjës. Përveç kësaj Karta e TUN përcaktoi se zbatimi i urdhrave eprore nuk konsiderohet si shkak i ligjshëm për përjashtim nga përgjegjësia penale.



akuzat për «krime kundër njerëzimit» ishin të paligjshme, dhe shkelnin ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal (Rückwirkungsverbot), i cili bazohet në parimin “nulla poena sine lege”. Ky i fundit lejon gjykimin e akteve të cilat konsiderohen të paligjshme në kohën e kryerjes së veprës penale. Duke pasur parasysh mazorinë e madhe të krimeve naziste, Aleatët hodhën poshtë kundërshtime të tilla që buronin nga pozita e pozitivizmit ligjor. Në pikëpamjen e tyre, aktet në fjalë ishin krime që shkelnin ligjin natyror, edhe pse nuk ishin kodifikuar si shkelje nga ligji kombëtar ose ndërkombëtar. Për këtë arsye u argumentua se, të pandehurit ishin në dijeni të faktit që po kryenin krime.¹⁹

Të pandehurit dhe avokatët e tyre përdorën kundërshtime të tilla për të denoncuar gjyqin si drejtësi të njëanshme apo “drejtësi e fitimtarit” dhe për të sfiduar ligjshmërinë e akuzave dhe mohuar legjitimitetin e tyre. Të akuzuarit u vetë deklaruan «jo fajtorë për akuzat e ngritura», kërkuan mbrojtjen e urdhrave eprore, duke vënë në dukje se ata veç kishin përmbushur detyrat e tyre, duke ia kaluar të gjitha përgjegjësitë Adolf Hitlerit apo padijes.²⁰

Aleatët punuan shumë për zbulimin dhe mbledhjen e provave. Ky proces kishte filluar që gjatë luftës. Gjatë gjyimit, i cili tërhoqi vëmendje të madhe nga mediat kombëtare dhe ndërkombëtare, u cituan si prova më shumë se 5.000 dokumente. Për shembull, në grumbullin e provave u përfshinë edhe xhirime origjinale filmike, që tregonin çlirimin e kampeve të përqendrimit apo fjalime të të pandehurve. 240 persona u sollën si dëshmitarë, duke përfshirë ish të burgosur në kampet e përqendrimit, të mbijetuarit e kampeve të shfarosjes (extermination camps) dhe anëtarë të regjimit nazist. Kjo jo vetëm për të treguar zbatimin e parimeve të sundimit të ligjit, të cilat kërkojnë provimin e fajit individual të secilit të pandehur si parakusht për dhënien e dënimit, por edhe për të realizuar në njëjtën kohë një tjetër qëllim të Aleatëve veçanërisht Shtetet e Bashkuara. Ky qëllim kishte të bënte me ekspozimin e përmasave të krimeve naziste, ndërgjegjësimin e shoqërisë gjermane dhe të gjithë publikut ndërkombëtar. Aleatët shpresonin se kjo do të nxiste një ndryshim të mentalitetit, demokratizimin e shoqërisë gjermane dhe do të parandalonte qëllimet agresive të Gjermanisë në të ardhmen.²¹

Dënimet ndaj kriminelëve kryesorë nazistë u shpallën pas 218 ditësh gjykimi, më 30 shtator dhe 1 tetor 1945. Tre nga gjashtë organizatat e paditura u dënuan si organizata kriminale. Këto ishin: Gestapo, SS (një organizatë paraushtarake lidhur me Partinë Naziste, duke përfshirë edhe SD Sicherheitsdienst des Reichsführers e cila ishte agjencia e inteligjencës e SS dhe Partisë Naziste), si edhe korpusin udhëheqës të NSDAP-it ose Partisë Naziste. Tre të pandehur u liruan, katër u dënuan me burgim nga dhjetë deri njëzet vjet, tre të tjerë u dënuan me burgim të përjetshëm, ndërsa 12 të pandehurit e mbetur u dënuan me vdekje. Dënimet me vdekje²² u ekzekutuan më 15 tetor 1945.²³

¹⁹ Një legjitimim i mëtejshëm i të gjitha vendimeve mund të gjendet në “Das Urteil von Nürnberg”.

²⁰ Meyer, Dennis. 2007. “Nürnberger Prozess”. Në Fischer, Tobias dhe Lorenz, Matthias N. (ed.) Lexikon der “Vergangenheitsbeurteilung” in Deutschland. Debatten - und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945. faqe 21-22. Bielefeld: Transkript.

²¹ Ibid.

²² Hermann Göring shmangu dënimin duke kryer vetëvrasje. Në rastin e Martin Bormann, i cili u gjykua në mungesë, dënimi nuk u zbatua ndonjëherë. Eshtrat e tij u gjetën më 1972 në Berlin.

²³ Përveç Gjyqeve të Nurembergut, katër fuqitë pushtuese zhvilluan gjyqe të shumta në zonat e tyre respektive të pushtimit (ose edhe në vendet e tyre), të tilla si 12 gjyqet pasuese të TUN në Nuremberg, gjyqet ndaj personelit të kampeve të përqendrimit. Në total, 1,814 persona u dënuan nga amerikanët, 1,085 nga britanikët, 2,107 nga francezët dhe rreth 26,000 deri në 45,000 (të llogaritura me përafërsi) nga forcat pushtuese sovjetike. Për më tepër shih: Cohen, Transitional Justice, faqe 63-67.



II. Gjykimi i krimeve naziste nga gjykatat gjermane të Zonave të Pushtuara Perëndimore dhe të RFGJ-së

Paralelisht me përpjekjet Aleate, vetëm disa muaj pas luftës, vetë gjyqësori gjerman filloi procedurat e hetimeve paraprake dhe ngritjen e padive mbi krimet naziste. Ndonëse skeptikë nëse duhet t'u besonin gjermanëve ndjekjen e krimeve naziste, Aleatët e kuptuan se shoqëria gjermane e kishte të nevojshme të shihte se gjermanët nuk u ndëshkuan si kriminelë vetëm nga gjykatat Aleate, por edhe nga vetë gjyqësori gjerman.²⁴

Gjyqësorit gjerman iu dha zyrtarisht leje për t'u marrë me krimet NS-te nga Ligji nr. 10 i Këshillit të Kontrollit Aleat (KKA), i cili hyri në fuqi më 10 dhjetor 1945. Megjithatë, juridiksioni i gjyqësorit gjerman ishte i kufizuar në krimet e kryera nga gjermanët kundër gjermanëve apo personave pa shtetësi. Ky ishte një kufizim i konsiderueshëm, duke marrë parasysh faktin që pjesa më e madhe e krimeve (më të rënda) naziste ishin kryer ndaj personave të kombësive të tjera. Në të njëjtën kohë KKA 10 zgjeroi fushëveprimin e gjyqësorit gjerman, pasi në përputhje me verditin e Nurembergut kodifikoi «krimet kundër paqes», «krimet e luftës», «krimet kundër njerëzimit» dhe «anëtarësimin në organizata kriminale» si vepra penale duke përcaktuar edhe dënimet përkatëse. Në këtë mënyrë, gjykatat gjermane ishin në gjendje të ndëshkonin veprime të cilat nuk ishin përfshirë apo të përfshira pjesërisht në Kodin Penal gjerman të 1871, i cili shërbente si bazë dytësore ligjore për gjykimin e NS-ve.²⁵

Fokusi i fazës së parë të gjykimeve të krimeve NS-te, e cila zgjati deri në themelimin e RFGJ-së në vitin 1949, ishte denoncimi vrasjeve të të burgosurve politikë dhe tyre që konsideroheshin «disfatistë» pak para përfundimit të luftës, krimet kundër hebrenjve gjermanë (sidomos gjatë «Kristallnacht») dhe persekutimi i kundërshtarëve politikë. Veçanërisht denoncimet, përbënin një pjesë të madhe ose deri në 38 për qind të të gjitha gjykimeve të hershme të NS-ve. Ndër to, disa gjykime kishin të bënin me krimin e «eutanasisë», që ishte vrasja e personave me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike si dhe pacientëve psikiatrikë.

Kjo fazë e hershme e gjykimeve u karakterizua nga fakti se shumë pak nga rastet kishin filluar me iniciativë të prokurorëve të shtetit apo nga hetimet e tyre sistematike. Pjesa më e madhe e ndjekjeve penale u vunë në lëvizje përmes raportimit të autorëve të supozuar në polici nga ana e viktimave, vartësit apo miqtë e tyre. Numri i procedimeve të nisura u rrit me shpejtësi dhe arriti kulmin e saj në vitin 1948. Deri në fund të vitit 1949, gjykatat gjermane kishin dënuar në total 4.667 persona si autorë të krimeve naziste. Ky numër ishte i barabartë me numrin e dënimeve nga ana e fuqive pushtuese perëndimore. Megjithatë, dënimet për krimet më të rënda naziste ishin të rralla.²⁶

²⁴ Broszat, Martin. 1981. Siegerjustiz oder strafrechtliche "Selbstreinigung". *Vergangenheitsbewältigung der Justiz 1945-1949*. Vierteljahrshefte für Zeitgeschichte 4:477-544. Weinke, Annette. 2006. *Alliierter Angriff auf die nationale Souveränität? Die Strafverfolgung von Kriegs- und NS-Verbrechen in der Bundesrepublik, der DDR und Österreich*. Në: Frei, Norbert (ed.) *Transnational Vergangenheitspolitik. Der Umgang mit deutschen Kriegsverbrechern in Europa nach dem Zweiten Weltkrieg*, faqe 37-94. Göttingen: Wallstein Verlag dhe Miquel, Marc von. 2005. *Der befangene Rechtsstaat. Die westdeutsche Justiz und die NS-Vergangenheit*. Në: Kenkmann, Alfons dhe Zimmermann, Hasko (ed) *Nach Kriegen und Diktaturen. Umgang mit Vergangenheit als internationales Problem. Bilanzen und Perspektiven für das 21. Jahrhundert*. faqe 81-96. Essen: Klartext; Greve, Michael. 2003. 'Täter oder Gehilfen? Zum strafrechtlichen Umgang mit NS-Gewaltverbrechern in der Bundesrepublik Deutschland'. Në: Weckel, Ulrike dhe Wolfrum, Edgar (ed) 'Bestien' und 'Befehlsempfänger'. *Frauen und Männer in NS-Prozessen nach 1945*, faqe 194-221. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht. Cohen, "Transitional Justice". faqe 82-86.

²⁵ Kjo ishte e vërtetë p.sh. për rastet e denoncimeve që nuk ishin kodifikuar si krime nga Kodi Penal gjerman, por si "krime kundër njerëzimit" nga KKA 10. Shih Ahrendt, Roland: *Rückkehrungsverbot*. Në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Mattias. N. (ed) *Lexikon der Vergangenheitsbewältigung in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945*. faqe 27-28. Bielefeld: Transkript. Zbatimi i KKA 10 u lejua nga gjykatat gjermane në zona të ndryshme të pushtimit dhe rezultate ishin mjaft të ndryshme si në ndjekjen penale ashtu edhe në dënimet e aplikuar.

²⁶ Raim, Edith. 2011. *NS-Prozesse und Öffentlichkeit. Die Strafverfolgung von NS-Verbrechen durch die deutsche Justiz in den westlichen Besatzungszonen 1945-1949*. Në: Osterloh, Jörg dhe Clemens, Vollnhals (ed.). 2011. *NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR*. Faqe 33-53. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht. Numrat sipas Eichmüller, Andreas. 2008. *Die Strafverfolgung von NS-Verbrechen durch westdeutsche Justizbehörden seit 1945. Eine Zahlenbilanz*. Vierteljahrshefte für Zeitgeschichte 4:621-640.



Me themelimin e RFGJ-së dhe rimëkëmbjen graduale të sovranitetit, ndjekja penale e krimeve naziste ndryshoi në shumë aspekte.²⁷ Nga njëra anë, juridiksioni i gjyqësorit gjerman u zgjerua për të përfshirë krimet kundër jo-gjermanëve (siç janë krimet e kryera në ish territoret e pushtuara). Nga ana tjetër, zbatimi i KKA 10 si një ligj i veçantë penal ex-post-facto në lidhje me veprën penale të “krimeve kundër njerëzimit», u shfuqizua me kërkesë të Qeverisë Federale të Gjermanisë në vitin 1951. Kjo reflektoi mungesën e vullnetit nga ana e Gjermanisë Perëndimore për të përdorur dispozitat penale prapavepruese për të ndëshkuar krimet naziste. Si pasojë, personat e përfshirë në këto krime mund të ndiqeshin penalisht vetëm përmes Kodit Penal gjerman, i cili ishte i pamjaftueshëm për ndjekjen e krimeve në fjalë.

Në vitet 1950 numri i hetimeve dhe gjykimeve filloi të bjerë shpejt dhe në mënyrë të konsiderueshme. Ndërsa në vitin 1949 kishte pasur 1,465 gjykime, numri ra në 957 në vitin pasues, 386 një vit më vonë dhe arriti numrin më të ulët me 22 gjyqe në vitin 1959. Kjo rënie i atribuohet disa shkaqeve. Numri i denoncimeve që më parë ishte faktori kryesor i fillimit të ndjekjeve penale, kishte rënë në mënyrë të konsiderueshme.²⁸ Për më tepër, Kodi Penal gjerman ofronte një kuadër ligjor të pamjaftueshëm, pasi KKA 10 me dispozitat e tij prapavepruese ishin bërë të pavlefshme.²⁹ Në veçanti, në rrjedhën e viteve 1950, vepra të shumta në këtë kuadër u parashkruan. Në këtë mënyrë, në fund të dekadës, vetëm dëmtimi fizik, burgimi i paligjshëm me pasojë vdekjen, vrasja e thjeshtë dhe ajo në rrethana cilësuese (manslaughter) mund të ndiqeshin penalisht. Në të njëjtën kohë, mundësitë për ndjekje penale u kufizuan më tej përmes amnitive, si për shembull, Straffreiheitsgesetze (Amnesty Acts) të vitit 1949 dhe 1954.³⁰ Me kalimin e viteve, si parashkrimi ashtu edhe dhënia e amnitive, reflektuan kundërshtinë e përhapur ndaj ndjekjes penale të krimeve naziste. Gjithnjë e më shumë zëra filluan të ngrihen edhe për dhënien e një amnistie të përgjithshme, si shprehje e dëshirës mbizotëruese për të lënë të shkuarën pas. “Fajtorët e vërtetë», lexonte një parullë vetë-shfajësuese e kohës, u dënuan në gjyqet Aleate të krimeve të luftës dhe në Gjykatën Ndërkombëtare Ushtarake në Nuremberg. Këtë mendim ndante edhe shumica e gjyqësorit gjerman, radhët e të cilit në vitet e pas luftës mbizotëroheshin nga ish juristët e NSDAP-it (të cilët përbënin deri në 80 për qind të gjithë gjyqësorit në atë kohë). Siç argumentohet në këtë studim, kjo situatë vinte si pasojë e denazifikimit të pamjaftueshëm. Mungesa e vullnetit për të ndjekur penalisht krimet naziste jo vetëm që shpuri në një vete-amnisti de facto për krimet naziste nga ana e gjyqësorit, por edhe pati pasojë të konsiderueshme në mos dënimin edhe të krimeve të tjera të NS-ve.

Në vitin 1958, ndjekja penale e krimeve naziste mori një kthesë pozitive. Kjo erdhi si pasojë e të ashtuquajturit Gjyq të Ulmit ndaj Einsatzgruppen (Skuadrave naziste të vdekjes) i cili konsiderohet si një rastësi fatlume. Mes prillit dhe gushtit të vitit 1958, dhjetë anëtarë kryesorë të një skuadre të lëvizshme (Einsatzkommando), e cila ishte përgjegjëse për vrasjen e disa mijëra hebrenjve në ekzekutime masive në zonën kufitare gjermano-lituanese në verën e vitit 1941, u vunë në bankën e të akuzuarve. Gjatë këtij “gjykimi të parë të madh të Holokaustit»,³¹ karakteri dhe shtrirja e krimeve masive në

²⁷ Eichmüller, Andreas. 2011. ‘Die strafrechtliche Verfolgung von NS-Verbrechen und die Öffentlichkeit in der frühen Bundesrepublik Deutschland 1949-1958.’ në: Osterloh, Jörg dhe Vollnhals, Clemens (ed). 2011. NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR, faqe 53-75. Göttingen: Vandenhoeck dhe Ruprecht; Fröhlich, Claudia. 2011. ‘Der “Ulmer Einsatzgruppen-Prozess” 1958. Wahrnehmung und Wirkung des ersten großen Holocaust-Prozesses.’ në: Osterloh, Jörg dhe Vollnhals, Clemens (ed). NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR, faqe 233-263. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht.

²⁸ Kjo rënie, erdhi si rezultat i raportimeve të mëparshme, migrimit apo largimit, rënies së kujtesës së raportuesve. Kjo e fundit kishte një ndikim negativ në mbledhjen e të dhënave.

²⁹ Shih shënimin nr. 35.

³⁰ Ligji i parë amnistoi krimet e dënueshme me më pak se 6 muaj burgim. Ligji i dytë i përjashtoi krimet e kryera pas tetorit të vitit 1944 të dënueshme më pak se 3 vite burgim. Dënimet e zbutura të dhëna në periudhën e pas-Luftës, ndikoi në dënimet e krimineleve nazistë. Një tjetër arsye për mënjanimin e ndjekjes penale kishte të bënte me shkallën në ulje të presionit nga forcat pushtuese, të cilat filluan të amnistojnë kriminelët nazistë.

³¹ Fröhlich, “Ulmer Einsatzgruppen-Prozess”

“Ostgebiete-n” (territoret e pushtuara të Lindjes), si dhe roli i Einsatzkomandos u zbulua me ndihmën e dokumenteve, ekspertëve (historianë) dhe dëshmitarëve. Pavarësisht se pjesëmarrja e tyre në vrasje u provua në mënyrë të padyshtimtë, gjykata vendosi dënimin e tyre si bashkëpunëtorë aksesorë në vrasje dhe jo si autorë të drejtpërdrejtë. Si rezultat, ata u dënuan për bashkëpunim në vrasje dhe u dënuan me burgim nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie.

Gjyqi, i cili tërhoqi vëmendjen e jashtëzakonshme të medias, hodhi dritë mbi të metat e ndjekjes penale të krimeve naziste dhe mungesën e hetimeve sistematike që kishin çuar në mos fillimin e shumë çështjeve. Për të korrigjuar këto të meta, në fund të vitit 1958, u themelua Zyra Qendrore e Shtetit për Administrimin e Drejtësisë në lidhje me Hetimin e Krimeve Naziste (Zyra Qendrore) në Ludwigsburg. Si agjenci qendrore për hetimin e krimeve të NS-ve, kjo zyrë ishte përgjegjëse për analizimin e provave, fillimin e hetimeve paraprake dhe koordinimin e ndjekjes penale. Vetëm atëherë filloi një ndjekje penale sistematike e krimeve naziste në RFGJ. Kjo rezultoi në një rritje të konsiderueshme të hetimeve. Brenda 12 muajve të parë të ekzistencës së saj, Zyra Qendrore filloi rreth 500 hetime paraprake, të cilat pjesërisht përfshinë disa qindra të dyshuar. Deri në vitin 1964 u shtuan edhe 700 dosje të tjera hetimore. Fokusi u drejtua për nga krimet e kryera në ish territoret e pushtuara, sidomos në ato të kryera në kampet naziste të shfarosjes.³²

Megjithatë, ishte tashmë shumë vonë për gjyqe të shumta dhe mangësitë e arritjeve nuk mund të kompensoheshin më. Koha dhe distanca hapësinore nga kryerja e krimeve shpesh e pamundësonte gjetjen e provave të mjaftueshme dhe dëshmitarëve për të provuar fajësinë dhe dënuar autorët e krimit. Përveç kësaj, hetimet dhe procedimet shpesh merrnin shumë kohë. Shumë të dyshuar vdiqën para se të mund të silleshin përpara gjykatës. Për më tepër, sërish në vitin 1960, qeveria nuk bëri asgjë për të parandaluar parashkrimin e krimeve. Pesëmbëdhjetë vjet pas Luftës së Dytë Botërore, vetëm vepra e vrasjes ishte ende e dënueshme. Si pasojë, krime të shumta të NS-ve mbetën pa u ndëshkuar për shkaqe të ndryshme. Se pari, në shumë raste qëllimi kriminal, si element i nevojshëm për t'u provuar në akuzën e vrasjes, nuk mund të provohej. Së dyti, një vështirësi e mëtejshme kryesore në ndjekjen e krimeve naziste u bë gjithnjë e më e qartë: diferencimi mes vrasjes dhe bashkëpunimit apo autorit dhe aksesorëve apo ndihmësve. Për të dënuar dikë për vrasje, përveç të ashtuquajturat kriteret e vrasjes (të cilësuar si motive dhe veprime)³³ duhej gjithashtu të provohej se personi kishte “dashur krimin i vepër të tij/saj”³⁴ (animus auctoris).

Kjo nuk ishte vetëm e vështirë për t'u provuar, por edhe gati e pamundur në kontekstin e një makinerie vrastare të drejtuar nga shteti, të organizuar dhe planifikuar si një aparat burokratik gjigand dhe që vështirë se mund të redukohej në veprime dhe motive personale dhe individuale të autorit të krimit. Shumë nga të pandehurit përdorën me lehtësi justifikimin e ndjekjes së «urdhrave nga lart», duke e përshkruar veten si «instrumente» në kryerjen e vullnetit tjetërkujt, që rezultoi në të ashtuquajturin Gehilfenjudiktur ose në praktikën mbizotëruese ligjore të kohës për dënimin e autorëve të krimit si ndihmës apo bashkëpunëtorë, dhe jo si vrasës.³⁵ Kjo gjithashtu pasqyroi nocionin e përhapur gjerësisht dhe që i atribuonte të gjitha përgjegjësitë Hitlerit dhe

³² Për më shumë detaje: Fröhlich, 'Ulmer Einsatzgruppen-Prozess'; dhe Weinke, Annette. 2008. Eine Gesellschaft ermittelt gegen sich selbst. Eine Geschichte der Zentralen Stelle Ludwigsburg 1958-2008. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.

³³ Sipas Martin Broszat vrasjet naziste, u gjykuan shpesh si vrasje të thjeshta (manslaughter). Që këto krime të mos mbesnin të pandëshkuara, Gjykata Federale, urdhëroi që ideologjia raciale Nacional-socialiste të cilësohej si “motiv baze”, dhe që krimet e motivuara prej saj, të konsideroheshin vrasje. Ky interpretim i ri ligjor, ishte vendimtar, dhe bëri të mundur pjesën më të madhe të ndëshkimeve pas viteve 1960. Megjithatë, vrasja vazhdoi të ishte një vepër e ndryshme nga bashkëpunimi. Cituar nga Broszat, Siegerjustiz, faqe 542.

³⁴ Përkthyer nga gjermanishtja, ibid.

³⁵ Ky ishte rezultat i heqjes së KKA 10 si një ligj i posaçëm prapaveprues, i cili e la gjyqësorin gjerman vetëm me standardet e Kodit Penal Gjerman ku kategoritë e veprave penale ishin të kufizuara në vrasjen e tipit “ordiner”, dhe nuk parashikonin vrasjet në masë si ato të kryera gjatë Holokaustit.



një elite të vogël bashkëpunëtorësh përreth tij, duke shfajësuar shumicën e autorëve si «asistentë të vegjël».³⁶

Ky justifikim u bë veçanërisht i dukshëm në ndoshta gjyqin më të shquar të historisë së Gjermanisë Perëndimore të pasluftës, Gjyqit të Aushvicit në Frankfurt. Ky gjykim, i cili u zhvillua në mes të dhjetorit 1963 dhe gushtit 1965, solli në bankën e të akuzuarve 22 persona; duke filluar nga adjutanti i komandantit të kampit, mjekët SS, anëtarët e Gestapos dhe funksionarë të tjerë të kampit. Kur dënimet u dhanë pas 183 ditë seanca gjyqësore, ishte e qartë se “ligji në limitet e kapacitetit të tij nuk mund të përballonte në mënyrë adekuate gjenocidin sistematik”³⁷. Vetëm “autorët e krimeve të tejskajshme” (excess perpetrators) u dënuan për vrasje dhe morën dënime maksimale. Por kjo nuk ndodhi për pjesën tjetër, të atyre të cilët në mënyrë jo drejtpërdrejtë ishin jo më pak përgjegjës për krimet në Aushvic për shkak se sjellja e tyre nuk ishte në tejkallim dhe se ata nuk ishin sjellë me “zell të tepruar” apo në mënyrë sadiste.

Pamja e gjenocidit u shtrembërua dukshëm. Holokausti si një i tërë u shpërbë dhe u zhduk pas veprimeve të një pakice. Megjithatë, gjykimi ishte i një rëndësie shumë të madhe. Më shumë se 200 të mbijetuar dëshmuar për ngjarjet në Aushvic. Ata treguan për «seleksionimin» në platformat e mbërritjes në kamp, gazin, pushkatimet, torturat dhe vrasjet e të burgosurve nga injeksionet me fenol në zemër. U dëgjuan ekspertë të shumtë, të cilët përshkruan ndër të tjera, kontekstin politik dhe historik të vrasjeve masive. Më shumë se 20.000 spektatorë morën pjesë dhe raporte të panumërta të medias iu dedikuan seancave gjyqësore. Përmes Gjykimit të Aushvicit, Holokausti u soll në vëmendjen e shoqërisë gjermane në detaje të papara dhe me intensitet të madh. Gjyqi shënoi një kthesë në mënyrën se si vendi u ballafaqua me të kaluarën përtej dëshirës për të harruar dhe duke hapur një faqe të re drejt një kulture të angazhimit aktiv dhe përkujtimit.

Megjithatë duhet sqaruar se gjyqi i Aushvicit nuk solli ndonjë ndryshim në administrimin e drejtësisë dhe ligjit penal. U desh deri në vitin 1979 që Bundestagu të binte dakord për heqjen e parashkrimit në rastet e vrasjes, në mënyrë që vrasjet masive të NS-it të konsideroheshin të dënueshme. Deri më sot, shumë shkaktarë të këtyre krimeve u gjykuan, megjithatë akoma më shumë procese dhe hetime dështuan. «Kriminalët zyrtarë» (Schreibtischtäter) ose shumë pak nga ata që kishin urdhëruar, planifikuar dhe organizuar vrasjet masive u konsideruan përgjegjës për krimet e tyre³⁸. Nga të gjitha rastet që nga viti 1945, 70 për qind u hetuan deri në 1949, 22 për qind midis viteve 1949 dhe 1958, dhe vetëm 8 për qind prej vitit 1958 dhe në vijim³⁹. Në tërësi deri në vitin 2005, hetime u filluan kundër 172,294 personave të identifikuar. Prej tyre vetëm 14.693 dolën në gjyq dhe 6.656 persona u dënuan. Nga këta vetëm 17 për qind ose 1.147 persona u dënuan për vrasje.

³⁶ Shih veçanërisht Greve, Täter. faqe 197-221; Gerstle, Nathalie. 2007. 'Gehilfenjudikatur.' në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der 'Vergangenheitsbewältigung' in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945. faqe 145-147. Bielefeld: Transkript. Gjithashtu për paragrafët në vazhdim: Fischer, Torben. 2007. 'Frankfurter Auschwitz-Prozess.' në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der 'Vergangenheitsbewältigung' in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945. faqe 136-139. Bielefeld: Transkript; Pendas, Devin O. 2006. The Frankfurt Auschwitz Trial, 1963-1965. Genocide, History, and the Limits of the Law. Cambridge: Cambridge University Press.

³⁷ Pendas, Auschwitz Trial, faqe 10

³⁸ Këtu e ashtuquajtura Amnisti e Ftohtë e vitit 1968 luajti një rol të rëndësishëm si pjesë e reformës penale, një ligj kyç (paragrafi 50 i Seksionit 2 të Kodit Penal) u ndryshua me efekt dënimin më të zbutur në lidhje me bashkëpunimin kur autorët nuk posedonin “karakteristikat e veçanta personale”. Kjo çoi në shkurtimin e afateve të parashkrimit në 15 vjet, afat i kishite kaluar tashmë. Për pasojë hetime të shumta u pushuan dhe mijëra autorë nazistë i shpëtuan ndjekjes penale. Deri më sot, është e ende e kontestueshme nëse këto ishin pasoja të një aksidenti fatkeq apo një modifikim i qëllimshëm për të amnistuar personat përgjegjës për krimet naziste. Langer, Antje. 2007. 'Kalte Amnestie.' në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) 'Lexikon der Vergangenheitsbewältigung' in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 200-201. Bielefeld: Transkript. Sipas David Cohen, 95 % e të gjitha hetimeve paraprahe të filluara nga Zyra Qendrore nuk u pasuan me fillimin e ndjekjes penale. "Transitional Justice" faqe 84.

³⁹ E shprehur në numra: 1945-1949: 4,667 persona të dënuar; 1950-1958: 1,426; 1959-2005: 563. Këto dhe të dhënat numerike në vijim u morën nga: Eichmüller, 'Strafverfolgung Zahlenbilanz,' faqe 621-640. Pasqyruar në: Bundesarchiv. Bilanz der Strafverfolgung wegen NS-Verbrechen. Akesuar në 19 Shkurt 2016. <https://www.bundesarchiv.de/imperia/md/content/dienstorte/ludwigsburg/strafverfolgungsbilanz.pdf>.

Vlerësime të përafërta flasin për 200.000 deri në 250.000 gjermanë dhe austriakë të cilët kishin marrë pjesë drejtpërdrejt (ose jo) në Holokaust (plus autorëve nga vende të tjera, si dhe ata që kishin marrë pjesë në krime të luftës apo krime të tjera naziste). Nga këta është fakt se rreth 100.000 gjermanë dhe austriakë u dënuan në Evropë si kriminelë luftime. Kjo tregon se kontributi i RFGJ është shumë i pakët⁴⁰.

U desh të vinte viti 2011, që të rishikohej praktika juridike mbi këtë çështje. Mbjajta e përgjegjësisë për rolin në industrinë shfarosëse të gjenocidit u njoh për herë të parë nga gjykata në gjyqin kundër Jon Demjanjuk. Në këtë vendim arsyetohej se “individualer Tatnachweis” apo kryerja personalisht e aktit të vrasjes nuk kërkohej domosdoshmërisht dhe për këtë arsye i pandehuri u dënua si “pjesë e industrisë shfarosëse” për bashkëpunim në vrasjen e më shumë se 28.000 hebrenjve në kampin e shfarosjes në Sobibor.

III. Gjykimi i krimeve naziste nga gjykatat gjermane në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

Ndjekja penale e krimeve të luftës dhe atyre naziste ishte veçanërisht e rëndësishme për forcat pushtuese sovjetike. Bashkimi Sovjetik kishte pësuar më shumë viktime dhe dëmet më të egra të luftës. Gjyqet në Bashkimin Sovjetik filluan që në vitin 1943. Pas vitit 1945, gjyqe u zhvilluan edhe nga gjykatat ushtarake sovjetike në Zonën e Pushtuar nga Sovjetikët (SOZ) të cilat dhanë dënime të rënda (të tilla si burgim prej 20 apo 25 vjet, apo dënime me vdekje)⁴¹. Sipas vlerësimeve, 40.000 persona u dënuan nga forcat pushtuese sovjetike⁴². Jo të gjithë të dënuarit ishin realisht autorë nazistë. Shpesh gjykimet u përdorën për të eliminuar dhe hequr qafe kundërshtarët politikë. Shumica e gjykimeve ishin të mbyllura për publikun dhe u karakterizuan nga arbitrariteti, brutaliteti dhe mosrespektimi i rregullave të procedurës bazë të shtetit të së drejtës. U mbajtën gjithashtu në një numër më i vogël “gjyqesh show” të cilat synonin që të demaskonin publikisht kapitalistët si «fajtorët e vërtetë» dhe për të nxitur shpronësimin e tyre. Këto gjykime nuk kishin gjithmonë lidhje me zbulimin dhe ndëshkimin e krimeve naziste, por u përdorën si mjete për përhapjen e ideologjisë komuniste dhe forcimin e pushtetit.⁴³

Ashtu si fuqitë e tjera fitimtare, sovjetikët ishin ngurrues që t'u besonin gjykatave gjermane ndjekjen e krimeve të NS-ve. Parakushti thelbësor për ta ishte denazifikimi i gjyqësorit, i cili u trajtua më me rigorozitet në zonën sovjetike. Kjo çoi në zëvendësimin e juristëve të komprometuar me juristë «borgjezë» të pa kompromentuar. Në pranverën e vitit 1946, gjyqësorit iu besua ndjekja e krimeve naziste të kryera nga gjermanët kundër gjermanëve apo personave pa shtetësi siç përcaktohet në Ligjin nr. 10 të Këshillit të Kontrollit (KKA 10). Megjithatë, kjo leje u dha vetëm në raste të rralla, kështu që nga 1947, vetëm rreth 500 persona u dënuan nga gjykatat gjermane. Krimet që u trajtuan në këto gjykime ishin kryesisht denoncimet, sterilizimi i detyruar dhe krimet e «eutanazisë». Si Administrata Sovjetike Ushtarake (SMAD), ashtu edhe Partia e Unitetit Socialist (SED) u përpoqën të ndikonin rezultatet dhe

⁴⁰ Frei, Norbert. 2006. 'Nach der Tat. Die Ahndung deutscher Kriegs- und NS-Verbrechen in Europa – eine Bilanz.' në: Frei, Norbert (ed.) Transnationale Vergangenheitspolitik. Der Umgang mit deutschen Kriegsverbrechern in Europa nach dem Zweiten Weltkrieg. faqe 7-37. Göttingen: Wallstein Verlag.

⁴¹ Paralelisht me avancimin e Ushtrisë së Kuqe dhe pushtimin e Gjermanisë, disa mijëra të pandehur kriminelë nazistë u ndaluan. Shumë prej tyre u deportuan në kampet e të burgosurve të luftës në Bashkimin Sovjetik. Wentker, Hermann. 2002. 'Die Ahndung von NS-Verbrechen in der Sowjetischen Besatzungszone und in der DDR.' Kritische Justiz 35:60-79.

⁴² Numri është i diskutueshëm edhe në ditët tona. Parashikimet variojnë mes 45,000 dhe 26,000 të dënuar. Rreth 13,000 nga këto gjykime u dhanë në Zonën Sovjetike të Pushtimit. Shih Cohen, 'Transitional Justice,' faqe 63, 67.

⁴³ Wentker, 'Ahndung,' faqe 61-63; Cohen, 'Transitional Justice'. Faqe 67. Për më shumë detaje: Schmeitzner, Mike. 2011. 'Unter Ausschluss der Öffentlichkeit? Zur Verfolgung von NS-Verbrechen durch die sowjetische Sonderjustiz.' Në Osterloh, Jörg dhe Vollnhals, Clemens (ed). 2011. NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR, faqe 149-167. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht; Hilger, Andreas. 2006. 'Die Gerechtigkeit nehme ihren Lauf? Die Bestrafung deutscher Kriegs- und Gewaltverbrecher in der Sowjetunion und der SBZ/DDR'. Në Frei, Norbert (Ed.) Transnational Vergangenheitspolitik. Der Umgang mit deutschen Kriegsverbrechern in Europa nach dem Zweiten Weltkrieg, faqe180-247. Göttingen: Wallstein Verlag.



vendimet e këtyre gjykimeve në bazë të interesave të tyre⁴⁴. Megjithatë, në këtë fazë të hershme, gjyqësori ishte më së shumti ende në gjendje për t'i rezistuar përpjekjeve të manipulimit, dhe për të mbajtur pavarësinë e tij. Kështu, u dhanë dënime të ashpra por të diferencuara dhe në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Megjithatë zhvillimet e ardhshme çuan nga një administratë kryesisht të pavarur të drejtësisë, në instrumentalizimin e saj në rritje dhe në përputhje me politikën e SMAD dhe SED⁴⁵.

Hapa vendimtarë në këtë drejtim u hodhën në vitin 1947 me lëshimin e Urdhrin Nr. 201 të SMAD dhe urdhërësën e tretë për zbatim të Direktivës së Këshillit Kontrollit Nr 38 (DKK38), e cila ishte fillimisht e menduar si një udhëzues për denazifikimin. Ky urdhër vendosi bazën dytësore ligjore të gjykimeve të ardhshme. Hartuar sipas modelit amerikan të denazifikimit (shih kapitullin 2 C I), DKK 38 përmban pesë kategori të inkriminimit si dhe dënimet përkatëse. Këto kategori ishin: shkelësit e mëdhenj, shkelësit, shkelësit më të vegjël, pasuesit dhe personat e shfajësuar. Aplikimi i kësaj direktive në vend të Kodit Penal do të thoshte një zgjerim i konsiderueshëm të veprave të dënueshme. Për shembull, persona të caktuar mund të dënoheshin vetëm për shkak të anëtarësimit të tyre në organizata të caktuara naziste. Për krimet naziste faji individual nuk kishte nevojë të provohej.

Hapa të mëtejshëm përfshinë, së pari dorëzimin e autoritetit për ndjekjen e autorëve nazistë dhomave penale speciale (Sonderstrafkammern) të cilat përbëheshin nga "gjyqtarët e popullit" që kishin lidhje me SED dhe ishin të zgjedhur e trajnuar posaçërisht për këtë detyrë. Së dyti, detyra për fillimin e hetimeve dhe hartimin e akt-akuzave kaloi nga gjyqësori tek policia politike, e cila kishte autoritetin për të vendosur se kush duhet të akuzohej dhe për çfarë. Së treti, të drejtat e të pandehurve ishin të kufizuara. Atyre u lejohej të konsultoheshin me një avokat vetëm pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, pozita e dy të pandehurve dhe gjyqësori u dobësuan në mënyrë të konsiderueshme. Pavarësia e gjyqësorit u lëkund, administrimi i drejtësisë të bazuar në sundimin e ligjit u bë gjithnjë e më pak i mundshëm, ndërsa SMAD dhe SED fituan mundësinë për të ndikuar në gjykime kur të dëshironin.

Si rezultat i kësaj, gjykimet ndaj kriminelëve nazistë u rritën ndjeshëm. Deri në tetor të vitit 1949, 8.321 persona u dënuan nga gjykatat gjermane. DKK 38 u përdor gjerësisht. Vetëm rreth 2.400 persona u dënuan si «shkelës të mëdhenj» të krimeve të luftës dhe krime naziste, ndërsa rreth 5.000 u dënuan për faje kolektive p.sh. për shkak të anëtarësimit të tyre në organizata naziste. Ashtu si në rastin e gjykimeve sovjetike, jo të gjithë të dënuarit ishin nacional-socialistë. DKK 38 përkufizonte «shkelës» edhe ata «të cilët, pas 8 maj 1945, rrezikonin ose [kishin] gjasë të rrezikonin paqen e popullit gjerman ose të botës, përmes evokimit të social-nacionalizmit ose militarizmit, ose nëpërmjet përhapjeve të thashethemet me qëllim të keq»⁴⁶. Gjykimet mund të përdroreshin për të hequr qafe çdo kundërshtar politik të SED. Përveç kësaj, dënimet filluan të rriten në ashpërsi, sipas thirrjes së SED për dënime drakoniane. Veçanërisht dënimet me vdekje ishin në rritje. Përveç kësaj, gjykimet u përdorën për transformimin socialist të marrëdhënieve pronësore. Në shumë raste, të dënuarve iu morr pasuria e cila më pas u shtetëzua.

⁴⁴ I tillë ishte rasti p.sh. i Gjykimit të 'Eutanazisë' në Qershor 1947 në Dresden. SMAD donte një gjykim "show" në të cilin rrethanat lehtësuese ishin përjashtuar. Në të kundërtën, SED u përpoq të ushtronte presion jurisë përmes medias dhe të arrinte kështu ndëshkime drakoniane. Böhm, Boris dhe Scharnetzky, Julius. 2011. 'Wir fordern schwerste Bestrafung: Der Dresdner "Euthanasie"-Prozess 1947 und die Öffentlichkeit.' Në: Osterloh, Jörg dhe Vollnhals, Clemens (ed). 2011. NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit.

⁴⁵ Ibid. shih gjithashtu Wentker, 'Ahndung,' faqe 64-78; Weinke, 'Alliiertes Angriffs,' veçanërisht faqe 44-62; Weinke, Annette. 2002. Die Verfolgung von NS-Tätern im geteilten Deutschland. Vergangenheitsbewältigung 1949-1969 ose Eine deutsch-deutsche Beziehungsgeschichte im Kalten Krieg. Paderborn: Ferdinand Schöningh, faqe 30, 43-47, 69-72.

⁴⁶ Wentker, Hermann. 2001. Justiz in der SBZ/DDR 1945-1953. Transformation und Rolle ihrer zentralen Institutionen. München: Oldenbourg Verlag.



Të ashtuquajturat “Procedura 201” arritën kulmin e tyre me Gjyqet e Waldheimit, në të cilat «mundësitë e dhëna nga Urdhri 201 u shfrytëzuan plotësisht».⁴⁷ Këto gjyqe, të cilat filluan në prill të vitit 1950, përfshinin rreth 3.400 gjyqe sekrete që u trajtuan nga gjykatat speciale. Proceset zgjasnin nga 20 deri në 30 minuta dhe dënimet mesatare ishin nga 15 deri në 25 vjet burgim. Të pandehurit ishin të burgosur nga tre kampet e fundit sovjetike të internimit në SOZ, të cilat qeveria e RDGJ-së kishte kërkuar mbylljen për një kohë të gjatë pasi ato prishin imazhin e një fillim të ri «antifashist-demokratik».

Ndërsa SED kishte si qëllim dhënien fund të denazifikimit dhe gjykimeve të nazistëve, dhe integrimin të gjithë të burgosurve të mbetur (me mbylljen e kampeve) në shoqëri, forcat pushtuese sovjetike i penguan këto plane. Vetëm rreth 10.000 të burgosur u liruan nga SMAD. Rreth 10.500 të cilët tashmë ishin dënuar nga Gjyqet Ushtarake Sovjetike, u dorëzuan në burgjet e RDGJ-së.

Rreth 3.400 të burgosur u hetuan dhe u ndëshkuan nga gjykatat e RDGJ-së. Gjyqet kundër tyre u mbyllën fillimisht për publikun dhe u mbajtën sekrete. Kjo do të ndryshonte kur procesi u bë i njohur publikisht, duke e detyruar SED të ndryshonte strategji. Dhjetë procese gjyqësore të montuara u përgatitën me kujdes dhe u zhvilluan para një publiku të zgjedhur. Në këto gjykime mbrojtësit, dëshmitarët dhe argumentet e përdorura u bazuan në prova strikte dhe dënime të individualizuara duke pretenduar zbatimin e ligjit edhe demonstrimin e egërsinë ndaj «fashistëve».⁴⁸

Gjyqet e Waldheimit, lajmëruan fundin e (vërtetë të) ndjekjes penale të krimeve naziste. Ashtu si në RFGJ, numri i procedimeve u ul në mënyrë të qëndrueshme dhe të konsiderueshme në vitet 1950. Nga 331 gjykime në vitin 1951, ai zbriti në 23 në vitin 1955. Pas këtij viti, vetëm 120 persona u dënuar deri në vitin 1989.⁴⁹ Këto pak gjykime ishin më shumë mjete propagande, të vetë-promovimit të RDGJ-së si një shtet antifashist dhe që luftonte me sukses fashizmin në gjithë territorin e vendit. RFGJ-ja dhe përballja e saj me të kaluarën shërbeu si pikë qendrore referimi. Kjo gjeti shprehjen e vet në procese gjyqësore “show” kundër zyrtarëve të lartë të RFGJ-së, të cilët mendohej se kishin bashkëpunuar me regjimin nazist. Këto gjykime u përdorën për të nxjerrë në pah gabimet e RFGJ-së në përballjen e saj me të kaluarën naziste. Ato u mbajtën në mungesë dhe u drejtuan kundër Shefit të Kancelarisë apo Ministrit Federal të Dëbimit, i cili mori dënim të rëndë.

Akuzat nuk ishin shpikje e pastër. Një numër i madh i nacional-socialistëve, disa prej tyre përgjegjës për krime, kishin fituar pozita të rëndësishme në RFGJ. Megjithatë, SED ishte më pak i interesuar për zgjidhjen dhe dënimin e krimeve sesa për destabilizimin dhe diskreditimin e RFGJ-së si mënyrë për të rritur imazhin e RDGJ-së. Fushatat nuk ishin pa pasojë. Ato shkaktuan shumë skandale në RFGJ në lidhje me ballafaqimin e saj me të kaluarën.

Gjykimet kundër shkelësve nazistë në territorin e tyre, nga ana tjetër, ishin të rralla dhe kryesisht nisur vetëm për të mos mbetur pas RFGJ-së apo për të treguar më shumë ashpërsi dhe përkushtim në ndëshkimin e fashistëve. Këto ambicie çuan në një numër gjykimesh të mbajtura paralelisht apo të ngjashme me ato në RFGJ. Njëri prej tyre ishte gjyqi “show” kundër Horst Fischer, i cili kishte punuar si mjek në kampin e shfarosjes në Aushvic. Megjithëse vendndodhja e tij ishte e njohur që nga viti 1964, gjyqi kundër

⁴⁷ Wentker, Ahndung, faqe 69. Përkthyer nga gjermanishtja.

⁴⁸ Më e detajuar në: Werkentin, Falco. 2011. ‘Die Waldheimer Prozesse 1950 in den DDR-Medien.’ Në: Osterloh, Jörg & Vollnhals, Clemens (ed). 2011. NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR, faqe 221-232. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht.

⁴⁹ Ndryshe nga RFGJ, prokuroria e krimeve naziste në RDGJ nuk u pengua as vazhdimësia e personelit në punë, as nga rezervat në lidhje me përdorimin e ligjeve penale me fuqi prapavepruese. Veprat e kodifikuara nga Karta e TUN (shih kapitullin 2 b 1) janë zbatuar edhe pas 1954-55. “Krimet kundër njerëzimit” dhe “krimet e luftës” u integruan në kodin penal të RDGJ-së në vitin 1968. Si parashkrimi ashtu edhe urdhrat eprore pushuan së ndikuari për këto lloje krimesh.



tij nuk nisi deri në vitin 1966. Ky gjykim u planifikua që të përkonte njëkohësisht me Gjyqin e Frankfurtit. Ashtu si në shumë gjykime të mëparshme, të kaluarës naziste i ishte dhënë një interpretim i ri dhe në përputhje me ideologjinë zyrtare të shtetit. “I.G. Farben”, përfaqësues i kapitalizmit gjermano-perëndimor, u përshkrua si përgjegjësi kryesor për fashizmin dhe krimet naziste. Gjyqi përfundoi me dënimin me vdekje të Horst Fischer-it.

RDGJ-ja mbeti kryesisht joaktive me gjithë «reputacionin e saj si shtet gjerman shembullor antifashist,»⁵⁰ madje edhe kur kishte informacione konkrete në dorë. Kjo qasje u rrit gjatë gjithë viteve 1980 dhe u përdor sidomos në rastet e autorëve nazistë, të cilët kishin fituar pozita të lartë në RDGJ. Autoritetet vendosën të mos procedonin autorët e dyshuar për “Eutanazi” që punonin në pozita të larta në sistemin e kujdesit shëndetësor. Në raste të tjera, Ministria për Sigurinë e Shtetit (MfS; Ministerium für Staatssicherheit) mund të ketë qëndruar e heshtur për të parandaluar rritjen e prestigjit të RFGJ-së. Për shembull një qëndrim i tillë vihet re në rastin e Erich Gust, ish-zëvendës komandantit të Kampit të Përqendrimit në Buchenwald, i cili dyshohej se kishte marrë pjesë në vrasjen e komunistit të njohur Ernst Thälmann. MfS as nuk filloi hetimet ndaj tij dhe as nuk e dorëzoi atë në RFGJ, ku ishte shpallur në kërkim. « Duke e mbajtur vrasësin e Thälmann-it të padënuar nga gjykatat e RFGJ-së, dukej se sillte më shumë përfitim se sa dënimi i tij.»⁵¹

c) Lustracioni: “Denazifikimi” i shoqërisë gjermane

I. “Denazifikimi” në Zonat Perëndimore dhe në RFGJ

Denazifikimi filloi gjatë pushtimit të Gjermanisë nga trupat aleate me shkarkimin e përfaqësuesve kryesorë të shërbimit civil. Paralelisht me këtë, kriminelët e vërtetë nacional-socialistë, apo ata të dyshuar, si dhe personat të cilët u perceptuan si kërcënim i mundshëm ndaj sigurisë, u vunë «automatikisht nën arrest». Këta veçanërisht përfshinin anëtarë të NSDAP-it, SS-ve, Shërbimit të Sigurisë të Reichsführer dhe Gestapos. Në total, 200.000 persona u internuan në zonat perëndimore të pushtuara. 100.000 prej tyre u dënuan në zonën amerikane. Ndërsa disa prej tyre përfituan lirim të parakohshëm, të tjerët qëndruan në burg nga disa muaj deri në tre vjet.⁵² Në janar të vitit 1946, fuqitë aleate u përpoqën të krijonin një trajtim uniform të spastrimeve në të gjitha zonat, por këto përpjekje dështuan. Denazifikimi kishte filluar tashmë në të gjitha zonat e pushtuara dhe kishte marrë formë të ndryshme.⁵³

Në zonën amerikane, nga korriku 1945, denazifikimi u krye me anë të një pyetësi, që përmbante 131 pyetje. Mbajtësit e pozitave kyçe duhej ta plotësonin atë, dhe të jepnin informacion për anëtarësimin e tyre në organizatat naziste. Në varësi të përgjigjeve të tyre, ata u vendosën në një prej pesë kategorive të shkarkimit, të përcaktuara nga qeveria ushtarake.⁵⁴ Pasuria dhe të ardhurat e personave të vendosur në kategorinë më të rëndë e të inkriminimit u ngrinë. Edhe pse plani fillestar kishte për qëllim të largonte vetëm nacional-socialistët me bindje⁵⁵ nga pozitat shoqërore dhe administrative kyçe,

⁵⁰ Wentker, Ahndung, faqe 76. E përkthyer nga gjermanishtja.

⁵¹ Ibid., faqe 78. E përkthyer nga gjermanishtja.

⁵² Deri në fillim të 1947, gati gjysma e të burgosurve ishin liruar nga kampet e internimit në Perëndim dhe vetëm 7,000 nga 67,000 nga kampet Sovjetike. Shih. Cohen, Transitional Justice faqe 69.

⁵³ Për paragrafët në vijim Vollnhals, Clemens: Entnazifizierung. Politische Säuberung und Rehabilitierung in den vier Besatzungszonen 1945-1949, sidomos faqet 7-24 dhe 94-96; Henke, Klaus-Dietmar: Die Trennung vom Nationalsozialismus. Selbstzerstörung, politische Säuberung, “Entnazifizierung”, Strafverfolgung. Në Id. Woller, Hans (ed.): Politische Säuberung in Europa. Die Abrechnung mit Faschismus und Kollaboration nach dem Zweiten Weltkrieg. München 1991, sidomos faqe 32-66; më tej Cohen, Transitional Justice, faqe. 68-71.

⁵⁴ Shiko Komanda Evropiane SHBA, Direktiva e USFET Korrik 1945. Pesë kategoritë ishin: 1. Largimi i detyruar, 2. Largimi diskrecional - rekomandimi negativ, 3. Largim diskrecional - pa rekomandim negativ, 4. Asnjë kundërshtim - asnjë provë e veprimtarisë naziste, 5. Rekomanduar për mbajtje - dëshmi e veprimtarisë antinaziste.

⁵⁵ Nacional-socialistët u konsideruan “të bindur” nëse ata, për shembull, kishin qenë anëtarë të NSDAP para 1 maj 1937.

grupi i synuar u zgjerua gjithnjë e më shumë⁵⁶. Ky zhvillim kulmoi me vendosjen e kontrollit mbi gjithë sektorët ekonomikë. Ish-anëtarë të NSDAP-it apo organizatave të lidhura me të u lejuan të punojnë vetëm si “punëtorë të thjeshtë”.⁵⁷ Në këtë mënyrë, të gjithë ish-anëtarët e organizmave qendrore të nacional-socialistëve iu nënshtruan denazifikimit”.⁵⁸

Deri në mars të vitit 1946, u analizuan 1.26 milion nga totali prej 1.39 milion pyetësorësh. Gjysma e të gjithë personave të shqyrtuar apo 620.617 prej tyre u vendos në kategoritë që kërkonin largim të mundshëm ose të detyrueshëm. Deri në fund të muajt mars, 336.892 prej tyre u pushuan apo nuk u rimorën në punë. Në shërbimin civil, kjo çoi në largimin e nga një deri në dy të tretat e personelit. Mungesa e ekspertëve dëmtoi funksionimin e administratës dhe ekonomisë në mënyrë të konsiderueshme. Masat shpeshherë u konsideruan të padrejta, veçanërisht kategorizimi skematik pa bërë dallime individuale nëse të prekurit iu bashkuan organizatave naziste vullnetarisht apo padashur.⁵⁹ Në këtë mënyrë, denazifikimi tërhoqi kundërshtimin në rritje të popullsisë dhe rriti në solidaritetin ndërmjet nacional-socialistëve aktualë dhe pasuesve të tyre. Për më tepër, ai forcoi rezistencën kundër forcave pushtuese, zvogëloi vullnetin për të bashkëpunuar dhe promovoi vetë-viktimizimin.

Vështirësitë e shumta çuan në një rishikim të politikave denazifikuese. Në mars të vitit 1946, Ligji për “Çlirimin nga Nacional-Socializmi dhe Militarizmi» (Akti i Çlirimit) solli tre ndryshime të rëndësishme. Së pari, procedura e denazifikimit u individualizua, u zgjerua përmes shqyrtimit rast pas rasti dhe rishikimit thuajse-gjyqësor. Kategorizimi skematik sipas kriterëve formale (të tilla si anëtarësimi në NSDAP apo në organizatat e shpallura si kriminale nga TNU) mbeti në fuqi, por këto bashkë me ndalimet e ushtrimit të profesionit ishin vetëm përkohësisht të vlefshme. Ndërsa personat e pa kompromentuar u «lanë jashtë shqyrtimit të mëtejshëm”, të tjerët iu nënshtruan një vlerësimi individual të shkallës së përgjegjësive dhe përfshirjes në “Rajhun e Tretë».

Në bazë të këtij vlerësimi, personat vendoseshin në një nga pesë kategoritë e inkriminimit «sipas diskrecionit të lirë gjyqësor». ⁶⁰ Këto kategori ishin: autorë të shkeljeve të rënda, autorë shkeljesh, autorë të shkeljeve të lehta, ndjekësit dhe të shfajësuarit⁶¹. Në varësi të kategorisë, personi përballëj me dënime që varionin nga gjoba deri në humbjen e pasurisë, pensionit dhe të drejtave civile, ndalimeve në ushtrimin e profesionit apo edhe deri në dhjetë vjet në kampet e punës. Deklaratat e rreme në plotësimin e pyetësorit ishin të dënueshme.

Së dyti, denazifikimi iu la në dorë autoriteteve gjermane. Spruchkammern apo gjykatat vendore civile dhe prokurorët publikë morën përgjegjësinë, ndërsa fuqia e huaj ruajti autoritetin e saj mbikëqyrës ndaj procesit. Së treti, denazifikimi u shtri mbi të gjithë popullsinë e rritur nga mosha 18 vjeç e sipër. 13.41 milionë persona në zonën amerikane plotësuan pyetësorin. 27 për qind e tyre apo 3.66 milionë u duhej të përgjigjeshin për përgjegjësitë e tyre përpara gjykatave.

Gjatë dy viteve të ardhshme, sipërmarrja denazifikuese entuziaste dhe mjaft e gjerë, filloi të tregonte shenjat e para të dështimit. Së pari, në procedurën e denazifikimit

⁵⁶ Ky reagim i forcave amerikane ishte pasojë e “zërave në vendin e tyre që kërkonin dënim më të rëndë të nazistëve”.

⁵⁷ Vollnhals, Entnazifizierung, faqe 12. E përkthyer nga gjermanishtja.

⁵⁸ Borgstedt, Angela. 2009. ‘Die kompromittierte Gesellschaft. Entnazifizierung und Integration.’ Ne Reichel, Peter et.al. (ed) Nationalsozialismus - die zweite Geschichte: Überwindung, Deutung, Erinnerung, faqe 85-105. München: C.H. Beck.

⁵⁹ Fuqitë pushtuese nuk kishin njohuritë e nevojshme për të gjykuar përfshirjen individuale në një mënyrë më të nuancuar. Duke marrë të mirëqenë besnikërinë masive ndaj “Rajhut e Tretë”, ata gjithashtu nuk besonin mjaftueshëm tek autoritetet gjermane për t’u besuar atyre denazifikimit që nga fillimi.

⁶⁰ Henke, Trennung, faqe 38. E përkthyer nga gjermanishtja.

⁶¹ Neni 4 i Befreiungsgesetz (Akti Çlirimit).Për një përkufizim më të hollësishëm të secilës kategori, shih nenet 5-13.



barra e provës u përmbys. Sipas kategorizimit paraprak, «i pandehuri» prezumohej fajtor dhe i takonte atij të shfajësonte veten para gjykatës⁶². Kjo nxitë praktikën e të ashtuquajturave Persilscheine apo dokumenteve të shkruara në formën e një affidavit-e nga miqtë, fqinjët, kolegët apo klerikët, të cilat garantonin integritetin e personit të prekur. Këto u përdorën si mjete për të “zbardhur” të kaluarat inkriminuese. Së dyti, situata u përkeqësua nga përdorimi në tejkallim të kompetencave apo edhe abuziv i fuqive diskrecionale nga ana e gjykatave (p.sh. përmes invokimit të “së drejtës për gabime politike”) për të ndihmuar qytetarë të kompromentuar dhe duke dhënë dënime të buta. Kështu shumë persona në fakt të kompromentuar nga “shkelës” u kategorizuan në «ndjekës». Denazifikimi dhe rehabilitimi shkuan dorë për dorë⁶³.

Faktorë të tjerë ndikuan gjithashtu. Ndër to ishte edhe konteksti i Luftës së Ftohtë dhe nevoja për ta pasur Gjermaninë si një partnere. Kjo çoi në zbehjen e zellit të fuqive pushtuese për thellimin e procesit të denazifikimit. Ky i fundit i la vendin amnistive nga ana e amerikanëve ndaj “pasuesve të dyshuar”. Një valë amnistie u krye në gusht të vitit 1946 ku përveç të rinjve përfituan personat e prekur nga «vështirësitë sociale» dhe së fundmi të burgosurit e luftës u liruan nga ndëshkimi. Si rezultat, vetëm 950 mijë nga 3.66 milionë u përgjigjën për të kaluarën e tyre. Përveç amnistive, amerikanët lehtësuan si dënimet ashtu edhe procedurën e kategorizimit. Ndalimet profesionale u kufizuan vetëm për “shkelësit e mëdhenj”, ndërsa “shkelësit” mund të kategorizoheshin si ndjekës në procedurat përfundimtare. Së fundi, u vendos për dhënien fund të denazifikimit. Vetëm personat e kompromentuar rëndë do të mbanin përgjegjësi pas datës 8 maj 1945.

Ky ndryshim i politikës pati pasoja të konsiderueshme. Meqë gjykatat u morën si fillim me rastet më pak të komprometuara dhe të thjeshta, shumë persona të inkriminuar morën dënime më të buta ose dolën të pandëshkuar. “Hendeku mes aspiratës dhe realitetit”⁶⁴ ishte tashmë i pamohueshëm. Nga 13 milion pyetësorë, u dënuan vetëm gati 10 për qind. Nga këta më pak se 1 për qind morën «dënime të plota apo disavantazhe të përhershme»⁶⁵. Në vend të “pastrimit” dhe “shlyerjes” denazifikimi solli një rehabilitim të gjerë të personave të inkriminuar.

Denazifikimi në zonat e tjera perëndimore (franceze dhe britanike) u orientua sipas qasjes amerikane por me kishte dallime dhe specifika të konsiderueshme⁶⁶. Në parim, denazifikimi u pa në mënyrë më pragmatike, si pjesë e shpërbërjes së organizatave të Partisë Naziste dhe zëvendësimit të elitave. Prioritet iu dha funksionimit të administratës dhe ekonomisë. Duke marrë në konsideratë situatën ekonomike të pas luftës në vendet e tyre, dy forcat e tjera pushtuese dëshironin të minimizonin kostot e pushtimit.⁶⁷ Kështu, një grup më i vogël njerëzish u bë subjekt i rishikimeve krahasuar me zonën amerikane. Fokusi u vu në sistemin e edukimit, atë administrativ dhe gjyqësor. Sektorë të tjerë profesionale u (pothuajse) përjashtuan. Në këtë mënyrë, shumë nacional-socialistë mbeten të pazbuluar dhe të pa ndëshkuar. Kjo i dha emrin Zonës Franceze “Eldorado-ja e kriminelëve të mëdhenj nazistë”.⁶⁸ Atje, 13 nga 669.068 persona të shqyrtuar u kategorizuan si “shkelës të mëdhenj”, 938 si “shkelës”, 2.5 për qind si “shkelës më të vegjël”, 44.7 si “ndjekës” dhe 0.5 për qind si “të shfajësuar”. Të

⁶² Nëse, për shembull, dikush ishte anëtarësuar në NSDAP para 1 majit 1937, prezumohej fajtor ose si person i cili kishte “promovuar konsiderueshëm tiraninë e partisë”. Përkthyer nga gjermanishtja, Henke, Trennung. Faqe 39

⁶³ Borgstedt, Gesellschaft. faqe 93.

⁶⁴ Benz, Wolfgang. 2009. Deutschland unter alliierter Besatzung 1945-1949. faqe 118. Në Benz, Wolfgang dhe Scholz, Michael F. (ed) Gebhardt Handbuch der Deutschen Geschichte. Stuttgart: Klett-Cotta.

⁶⁵ Ibid., faqe 119. Përkthyer nga gjermanishtja.

⁶⁶ Për paragrafin në vijim Vollnhals, ‘Entnazifizierung,’ faqe 16, 24-42; Henke, ‘Trennung,’ faqe. 41-52; Borgstedt, ‘Gesellschaft,’ faqe. 90-95; Cohen, ‘Transitional Justice,’ faqe. 71-80. Për procedurën përkatëse, shiko Vollnhals und Henke.

⁶⁷ Përveç kësaj, denazifikimi në zonat franceze u formua nga qëllimi kryesor politik për të rindërtuar ekonominë franceze duke shfrytëzuar burimet gjermane dhe për të dobësuar fqinjin e saj të rrezikshëm.

⁶⁸ Vollnhals, Entnazifizierung, faqe 28. Përkthyer nga gjermanishtja.

gjitha procedimet e tjera u hodhën poshtë.

Deri më sot nuk dihet se sa prej dy milionë personash të shqyrtuar në Zonën Britanike u dënuan si autorë kryesorë të krimeve naziste. Të dhënat nuk janë të unifikuara por tregojnë gjykimeve të buta. Megjithatë, forcat britanike demonstuan ashpërsi në dënimin e pjesëtarëve të organizatave naziste të cilat u shpallën kriminale në Gjyqet e Nurembergut (kapitulli 2 b i). Ndryshe nga zona të tjera të pushtimit, ata nuk u vendosën para përgjegjesisë përmes procedurave të denazifikimit, por përmes procedurave gjyqësore «klasike» dhe përmes gjykatave të posaçme. Deri në fund të vitit 1949, u zhvilluan 24.145 gjykime, nga të cilat 15.724 persona u dënuan; 5.614 prej tyre me burgim.

Edhe pse denazifikimi në Zonat Franceze dhe Britanike nuk dështoi për shkak të aspiratave të larta (qëllimet ishin më të moderuara), procesi i spastrimit nuk mund të konsiderohet si i efektshëm dhe politikisht thelbësor. Nga fundi i pushtimit, rezultatet e pakta u zvogëluan edhe më tej kur persona madje edhe ata të kompromentuar rëndë, u lejuan të kthehen në shërbimin civil përmes një numri masash të filluara pas themelimit të RFGJ-së (kapitulli 2 c ii).

II. “Denazifikimi” në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

Denazifikimi ishte më rigoroz dhe u zhvillua me shpejtësi në Zonën e Pushtimit Sovjetik. Ndryshe nga forcat amerikane, SMAD-i nuk kishte një politikë të saktë denazifikimi. Megjithatë, ishte e qartë që nga fillimi se spastrimi nuk do të ishte vetëm një «larje hesapësh me Nacional-Socializmin»,⁶⁹ por mbi të gjitha do t'i shërbente qëllimit kryesor “përmbysjes antifashiste-demokratike”. SMAD-i nuk kishte për qëllim vetëm largimin e nazistëve (dhe personave të tjerë politikisht të padëshirueshëm) por zëvendësimin e tyre me një elitë të re komuniste dhe mbrojtjes së synimeve të komunistëve për të udhëhequr vendin.⁷⁰ Motoja ishte: “demokratike në dukje por rreptësisht nën kontroll.”⁷¹

Menjëherë pas luftës, SMAD inauguroi regjistrimin e detyrueshëm të ish-anëtarëve NSDAP-it. Ashtu si në zonat e tjera, kriminelët e dyshuar nazistë dhe anëtarët e organizatave qendrore naziste u vendosën “automatikisht nën arrest”. Vlerësimet flasin për më shumë se 120.000 persona të prekur⁷². Paralelisht me këtë u iniciuan largime të shumta të personave të kompromentuar nga pozita me rëndësi shoqërore. Që nga fillimi, SMAD-i u mbështet nga komunistët gjermane dhe kundërshtarët e tjerë të Nazizmit. Në fazën më të hershme, për shembull «komitetet antifashiste» të themeluara në mënyrë spontane u përbënë nga grupe e ndryshme kundërshtarësh të NS-ve, të cilët u angazhuan në procesin e spastrimit. Njohuritë e tyre lokale ishin të sakta dhe të dobishme në identifikimin e personave NS-ë. Për më tepër, funksionarët e Partisë Komuniste, të cilët kishin marrë trajnime politike në Bashkimin Sovjetik, iu qëndruan në krahë këtyre komiteteve “si një zgjatim i Administratës Ushtarake Sovjetike”⁷². Veprimet josistematike në nivel lokal u fokusuan në heqjen e bartësve të funksioneve qendrore “luftëtarëve të vjetër” dhe denoncuesve; ndalimin e anëtarëve

⁶⁹ Ibid. Faqe 43. Përkthyer nga gjermanishtja.

⁷⁰ Cohen, ‘Transitional Justice,’ faqe 80. Gjithashtu për paragrafët në vazhdim: Vollnhals, ‘Entnazifizierung,’ faqe 43-55; Welsh, Helga A. 1991. ‘Antifaschistisch-demokratische Umwälzung und politische Säuberung in der sowjetischen Besatzungszone Deutschlands.’ Në: Henke, Klaus-Dietmar & Woller, Hans (ed). Politische Säuberung in Europa. Die Abrechnung mit Faschismus und Kollaboration nach dem Zweiten Weltkrieg, faqe 84-107. München: Deutscher Taschenbuch Verlag. Për më shumë në lidhje me konceptimin socialist të demokracisë, shih Kapitullin 2 e ii.

⁷¹ Mählert, Ulrich. 2010. Kleine Geschichte der DDR. Faqe 22. München : C.H. Beck. Përkthyer nga gjermanishtja.

⁷² Mes tyre nuk ishin vetëm nazistët, por shumë njerëz të cilët ishin konsideruar kundërshtarët të pushtimit sovjetik. Ndërsa një pjesë e madhe e të burgosurve në zonat perëndimore u liruan deri në janar 1947, kjo ndodhi vetëm për një numër të vogël të të burgosurve në zonat sovjetike. Shumë të burgosur u çuan në Bashkimin Sovjetik për punë të detyruar. Sipas vlerësimeve, më shumë se një e treta e të burgosurve vdiqën. Shih Cohen, Transitional Justice, faqe 69 dhe shënimin nr. 51.

⁷³ Vollnhals, Entnazifizierung, faqe 43.



dikur aktivë të NSDAP-it dhe Gestapos, por edhe në heqjen e personave të padëshiruar nën pretekstin e bashkëpunimit me nazistët.⁷⁴

Në këtë mënyrë, në korrik 1945 u krijua administrata e re shtetërore dhe vendore me persona politikisht të përshtatshëm në postet kyçe. Këto organe ishin përgjegjëse për masat e mëtejshme denazifikuese, mbi të cilat ato kishin kompetenca të gjera diskrecionale. Nuk pati udhëzime uniforme apo të shtrira në të gjithë zonën. Si rezultat, denazifikimi u trajtua në mënyra të ndryshme nga autoritete të ndryshme. Në disa shtete ish-anëtarët e Partisë Naziste u hoqën vetëm nga pozicionet drejtuese ndërsa në shtetet e tjera u hoqën të gjithë ish-anëtarët NSDAP-it, pavarësisht pozitës së tyre. Ekzistojnë ngjashmëri në sektorët e konsideruar të rëndësishëm për riorganizimin socialist të shoqërisë, të tillë si gjyqësori, sistemi arsimor, policia, industria dhe administrata. Arbitrariteti nuk ishte i pazakontë në këtë proces. Persona të ndryshëm u prekën nga masat denazifikuese jo sepse kishin një të kaluar naziste, por thjesht sepse nuk ishin komunistë të besueshëm. Ashtu si në zonat e tjera, denazifikimi u kufizua nga nevoja për të mbajtur gjallë institucionet e prekura dhe sektorët ekonomikë jetikë. Përfundime u bënë ndaj personelit të specializuar i cili konsiderohej i nevojshëm për funksionim e këtyre institucioneve. Në total, rreth 390.500 persona u larguan apo nuk u rimorën në punë deri në fund të vitit 1946.⁷⁵

Në mënyrë që të zbatonte një qasje uniforme, SMAD-i lëshoi udhëzime që përcaktuan kategoritë e largimit të detyrueshëm dhe diskrecional⁷⁶. Trajtimi i denazifikimit u miratua në komisioneve të posaçme, të përbëra kryesisht nga anëtarë të SED. Të gjitha lejet e punës e dhëna më parë u shfuqizuan dhe 850 mijë ish-anëtarë të NSDAP u shqyrtuan nga e para. Si pasojë, komisionet u mbingarkuan me punë dhe zbatimin e udhëzimeve ishte shumë skematik. Kjo çoi në të tjera largime, që kapën shifrën 64.500 persona deri në mes të 1947.

Në gusht 1947, SMAD papritmas ndryshoi politikë⁷⁷. Denazifikimi kishte avancuar së tepërmi dhe mungesa të dukshme të burimeve njerëzore u vunë re në administratë dhe ekonomi. Pra denazifikimi duhej të kufizohej tek nacional-socialistët aktivë dhe dukej se po shkonte drejt fundit. Anëtarët nominale të ish-organizatave naziste filluan nga ana tjetër të rehabilitoheshin dhe ndër të tjera fituan përsëri të drejtat e tyre civile. Nëse ata tregonin gatishmëri për të tu shkëputur njëherë e përgjithmonë nga idetë nacional-socialiste, mund të ri-integroheshin në shoqëri. Fundi i vërtetë i denazifikimit ishte planifikuar në mars 1948.

Procedimet kundër NS-ve që nuk ishin përfunduar u anuluan përveçse kur kishte prova të mjaftueshme për fillimin e ndjekjes penale. Rastet e tyre, si ato të kriminelëve NS-të iu dorëzuan gjykatave (shih kapitulli 2 b iii). Ndryshimi i politikës do të thoshte se shumë NS-të aktivë dhe të komprometuar rëndë, rastet e të cilëve nuk ishin trajtuar ende, u amnistuan. Është e vështirë të thuhet sa persona në Zonën Sovjetike u prekën nga denazifikimi i përgjithshëm. Informacioni i besueshëm mungon. Sipas vlerësimeve, 200.000 prej 1.5 milion anëtarëve të NSDAP që jetonin në SOZ u larguan përgjithmonë deri në fund të marsit 1948.⁷⁸

Dallimet kryesore mes denazifikimit në zonën Sovjetike dhe zonat Perëndimore nuk qëndrojnë tek procedurat apo dimensionet, por mbi të gjitha në jetëgjatësinë e

⁷⁴ Borgstedt, Gesellschaft, faqe 95.

⁷⁵ Ibid.

⁷⁶ Direktiva e Këshillit të Kontrollit Nr. 24, lëshuar në janar 1946 në përputhje me politiken amerikane të denazifikimit, e cila përmes këtij urdhri hyn në fuqi.

⁷⁷ Shiko SMAD. 1947. Urdhri Nr. 201. 'Richtlinien zur Anwendung der Direktiven Nr. 24 und Nr. 38 des Kontrollrats über die Entnazifizierung'.

⁷⁸ Cituar nga Cohen, Transitional Justice, faqe 81.

masave të marra. Në Zonat Perëndimore, ish NS-të u rehabilituan dhe riintegruan dukshëm deri në vitin 1948. Kjo është veçanërisht e vërtetë për shërbimin civil, ku numri i ish-anëtarëve të NSDAP-it arriti deri në 40 për qind.

Për të gjithë ata që kishin humbur punën e tyre në rrjedhën e denazifikimit, akti për zbatim të Nenit 131 të Ligjit Bazik i cili hyri në fuqi në vitin 1951 u dha mundësi personave prekur nga «denazifikimi» që të kërkonin kthimin në vendin e punës duke hapur dyert e shërbimit civil. Në këtë mënyrë, një pjesë tjetër prej 39.000 personash u riintegruan deri në mars të vitit 1953.⁷⁹ Në njërin anë, këto politika rezultuan në vazhdimësi të personelit që ishte i nevojshëm për rindërtimin e shpejtë RFGJ-së. Në anën tjetër, ato krijuan një barrë të konsiderueshme për procesin e ballafaqimit me të kaluarën në përgjithësi, dhe (mos) ndjekjen penale të krimeve NS-e nga e gjyqësorit, në veçanti.

Në Zonën Sovjetike dhe RDGJ, spastrimi ishte më i përhershëm. Veçanërisht heqja pothuajse e plotë e NS-ve nga gjyqësori, policia dhe administrata ishte e pakthyeshme. Pavarësisht rehabilitimit politik, ish-nazistët nuk u lejuan të ktheheshin në ish vendet e tyre të punës. Shumica e vendeve të lira u zunë nga Partia Komuniste apo anëtarët e SED, ose (të paktën zyrtarisht) nga persona të tjerë të konsideruar si politikisht të përshtatshëm të cilët morën p.sh trajnimeve të përsheptuara për të shërbyer si “gjykatës të popullit” dhe mësues të rinj. Ndonëse nacional-socialistët u dëbuan njëherë e përgjithmonë nga shumë sektorë profesionale, ata u zëvendësuan nga persona që ishin “në shërbim të partisë». Ndryshimet me themel të personelit i hapën rrugë vendosjes së diktaturës socialiste.

Megjithatë, denazifikimi në Zonat Perëndimore dhe RFGJ nuk përfundoi pa efekt. Edhe pse qëllimi i vërtetë i largimit të përhershëm të nazistëve nuk u arrit, denazifikimi arriti të kontribuojë në zbulimin dhe diskreditimin e nacional-socializmit. Përveç kësaj, masat kishin të paktën përkohësisht një efekt “shok” për njerëzit e kompromentuar, të cilët konsideroheshin «të dalë nga shoqëria dhe të poshtëruar»⁸⁰. Edhe pse kjo nuk mund të supozohet se kjo çoi në reformim të brendshëm, personat e riintegruar u desh të tregonin «moderim politik dhe vetëpërmbytje» si dhe përshtatje me rrethanat e reja politike në qoftë se nuk donin të humbnin pozitën e tyre të sapo fituara. Sipas Clemens Vollnhals, veçanërisht « funksionaret NS-të e nivelit të lartë apo ata të njohur lokalisht [...] jetonin kryesisht nën tolerancë edhe pas rehabilitimit të tyre formal, pa arritur të riktheheshin në statusin e tyre të mëparshëm social».⁸¹

d) “Wiedergutmachung”: Reparacionet, Kthimi dhe Dëmshpërblimi

I. Pretendimet e Fuqive Fitimtare për reparacione

Reparacionet për dëmet e luftës dhe humbjet u përcaktuan nga Aleatët në Marrëveshjen e Potsdamit në 1945. Kjo marrëveshje përcaktoi që kërkesat për reparacione nuk do të plotësoheshin me pagesa monetare, por përmes çmontimit të industrisë dhe infrastrukturës gjermane. Territori i reparacioneve ishte i ndarë mes Aleatëve. Bashkimi Sovjetik dhe Polonia do të merrnin dëmshpërblim nga Zona Sovjetike ndërsa Fuqitë e tjera Perëndimore si dhe të gjitha shtetet e tjera përfituese nga Zonat Perëndimore.⁸² Përveç kësaj, mjetet valutore gjermane u tërhoqën dhe u monetizuan. Asetet gjermane

⁷⁹ Shiko Sprockhoff, Anna dhe Fischer, Torben. 2007. ‘131er-Gesetzgebung.’ Në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der ‘Vergangenheitsbewältigung’ in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 94-96. Bielefeld: Transkript

⁸⁰ Kjo dhe dy citatat e ardhshme janë nga: Vollnhals, Entnazifizierung, faqe 64. Përkthyer nga gjermanishtja

⁸¹ Ibid.; me e detajuar në Henke, Trennung, faqe 56-66. Për pyetjen nëse kjo ishte e pashmangshme për dështimin e denazifikimit në Zonën Perëndimore, shih Vollnhals, Entnazifizierung, faqe. 55-64.

⁸² Bashkimi Sovjetik i cili kishte pësuar dëmet dhe humbjet më të mëdha, do të merrte shtesë 10 për qind të demontimit perëndimor pa pagesë, dhe një tjetër 15 për qindësh në këmbim të mallrave.



nga «Lindja», i takuan Bashkimit Sovjetik, dhe ato nga «Perëndimi» Fuqive Perëndimore. Përveç kësaj, flota detare tregtare gjermane dhe thesaret gjermane të arit (përfshirë edhe ato në vendet e huaja) u konfiskuan.⁸³

Parashikime të mëtejshme u vendosën në Konferencën për Reparacionet që u mbajt në shkurt 1946 në Paris dhe ku morën pjesë 18 vende. Edhe pse shumica e saktë e dëmshpërblimit nuk u përcaktua, u ra dakord për një formulë shpërndarjeje të llogaritur sipas madhësisë së vendit përkatës, kontributit të tij në luftë dhe shkallës së dëmit të pësuar. Shpërndarja midis shteteve përfituese do të administrohej nga IARA (Agjencia Ndërkombëtare për Reparacionet) në Bruksel. Shpërndarja e përfitimeve për qytetarët ishte në dorën e çdo shteti përfitues. Kështu «të gjitha kërkesat e qytetarëve të tyre kundër ish-qeverisë gjermane apo degëve të saj që rridhnin nga lufta, pavarësisht nëse këto ishin të natyrës shtetërore apo private»,⁸⁴ duhet të plotësoheshin. Asnjë dallim i saktë nuk u bë në lidhje me dëmet që rezultuan nga lufta ose persekutimi. Të gjitha llojet e dëmeve, me përjashtim të kërkesave nga ana e sigurimeve shoqërore, u përfshinë në konceptin e «reparacioneve».⁸⁵

Aleatët ndanin këndvështrime të ndryshme mbi çështjen e reparacioneve. Kjo bëri që edhe politikat e ndjekura të ndryshonin nga zona në zonë.⁸⁶ Duke pasur parasysh dëmtimet e luftës, Bashkimi Sovjetik ishte i interesuar kryesisht në rindërtimin e vendit dhe shkatërrimin e potencialit luftë-bërës të Gjermanisë. Për këtë arsye, ai ndoqi një politikë të fokusuar së tepërmi në çmontimin e objekteve industriale dhe infrastrukturore. Fabrika, makineri dhe hekurudha u çmontuan dhe u ngarkuan për në Bashkimin Sovjetik. Vetëm në muajin korrik të vitit 1946 Bashkimi Sovjetik ndryshoi politikën e reparacioneve duke e drejtuar atë nga prodhimi aktual i vendit. Përveç kësaj, reparacionet morën edhe forma të tjera, të tilla si përdorimi i të burgosurve të luftës dhe civilëve për punë të detyruar për të mëkëmbur ekonominë sovjetike. Në vitin 1953 edhe për shkak të problemeve të brendshme në RDGJ, Bashkimi Sovjetik vendosi të heqë dorë nga kërkesat e mëtejshme. Këtë rrugë ndoqi edhe Polonia në të njëjtin vit.

Franca ishte po aq e interesuar sa edhe Bashkimi Sovjetik në rindërtimin e saj ekonomik dhe në dobësimin e Gjermanisë. Ajo parashtroi pretendimet e saja përmes çmontimit dhe punës së të burgosurve të luftës. Megjithatë kjo në një masë më të vogël. Qasjet e zgjedhura në zonat Britanike dhe Amerikane ishin tërësisht të kundërta nga sa më sipër. Edhe pse të dyja fuqitë pushtuese ishin të interesuara për demilitarizimin ekonomik të Gjermanisë, ato donin gjithashtu të mbanin një industri të paprekur në kohë paqeje e cila do t'i shërbente ringjalljes së shpejtë të marrëdhënieve tregtare me vendet e tyre. Përveç çmontimit të moderuar, Britania e Madhe dhe SHBA-ja i plotësuan pretendimet e tyre kryesisht përmes pasurive të huaja, pronësisë intelektuale dhe transferimit të know-how.⁸⁷ Në veçanti, Shtetet e Bashkuara, politika e re e të cilave në dritën e Luftës së Ftohtë synonte integrimin e Gjermanisë me Perëndimin, ulën herët pretendimet e tyre dhe zhvendosën fokusin në rindërtimin aktiv nëpërmjet ndihmës ekonomike.

⁸³ Doebling, Karl. 2001. 'Reparationen nach dem zweiten Weltkrieg.' Në Doebling, Karl et.al (ed) *Jahrhundertschuld, Jahrhundertstühne. Reparationen, Wiedergutmachung, Entschädigung für nationalsozialistisches Kriegs- und Verfolgungsunrecht*, faqe 16-20. München: Olzog-Verlag; Fisch, Jörg. 1992. *Reparationen nach dem Zweiten Weltkrieg*. München: C.H. Beck Verlag, faqe 69-80; Bühler, Werner. 1999. 'Reparationen.' Në Benz, Wolfgang (ed.) *Deutschland unter alliierter Besatzung 1945-1949/55. Ein Handbuch*, faqe 161-166. Berlin: Akademie Verlag.

⁸⁴ Frøland, Hans Otto. 2006. 'Eine gewaltige, nicht beglichene Schuld. Die deutsche Entschädigung für NS-Verfolgte in Norwegen.' Në: Hockerts, Hans Günter et.al. (ed) *Grenzen der Wiedergutmachung. Die Entschädigung für NS-Verfolgte in West- und Osteuropa 1945-2000*, faqe 285-356. Göttingen: Wallstein Verlag.

⁸⁵ Hockerts, Hans Günter. 2001. 'Wiedergutmachung in Deutschland 1945-2000.' *Vierteljahresheft für Zeitgeschichte* 2:167-214 (Në vijim cituar i shkurtuar si Hockerts, Bilanz); Fisch, 'Reparationen,' faqe. 109-111; Frøland, Schuld, faqe 295; Hockerts, Hans Günter et. al (ed). 2006. *Grenzen der Wiedergutmachung. Die Entschädigung für NS-Verfolgte in West- und Osteuropa 1945-2000*. Göttingen: Wallstein Verlag (Në vijim cituar i shkurtuar si Hockerts, 'Entschädigung').

⁸⁶ Thelbësore për paragrafët në vijim Bühler, *Reparationen*, faqe 161-167; Fisch, *Reparationen*, faqe. 35-40; 104-116, 242-248.

⁸⁷ Shkencëtarë të shumtë gjermane dhe ekspertë teknikë u sollën në Shtetet e Bashkuara. Jo pak prej tyre kishin kryer krime të luftës.

Në vitin 1953, të gjitha pagesat e mëtejshme të dëmshpërblimeve u shtynë si rezultat i Marrëveshjes së Londrës mbi Borxhet e jashtme gjermane. Marrëveshja vendosi që të gjitha kërkesat e mbetura të zgjidheshin dhe të përmbusheshin vetëm pas përfundimit të një traktati paqeje me Gjermaninë. De facto kjo shënoi fundin e të gjitha pagesave për reparacione duke qenë se deri më sot, një traktat paqe nuk u krye ndonjëherë. Marrëveshja Dy Plus Katër e vitit 1990 nuk është konsideruar si i tillë nga shumica. Në përgjithësi, reparacionet janë konsideruar të përfunduara, përveç kërkesave individuale për kompensim të viktimave naziste të cilat, pas debateve të gjata, u bënë objekt i disa marrëveshjeve ndërkombëtare. (kapitulli 2 d ii)⁸⁸

Është pothuajse e pamundur të përcaktohet shuma e përgjithshme e të gjitha reparacioneve të paguara, sepse nga njëra anë ka mosmarrëveshje të madhe mbi atë që duhet të llogaritet si reparacion. Nga ana tjetër, është e vështirë për të llogaritur përfitime të tilla si know-how dhe puna e detyruar. Vlerësimet e cituara më së shumti flasin për 16.3 bilionë dollarë me çmimet e vitit 1938 në Zonën Sovjetike dhe 14.3 bilionë dollarë ose 16.8 bilionë dollarë në rastin e Zonave Perëndimore.⁸⁹

II. Politika e Kompensimit në RFGJ⁹⁰

Kthimi i aseteve të grabitura dhe shpronësuar filloi në zonat pushtimit amerikan. Menjëherë pas luftës, forcat amerikane vendosën nën kontroll pronën për të identifikuar asetet e vjedhura apo tërhequra, për të siguruar kthimin e tyre tek pronarët e ligjshëm. Për këtë qëllim, Fuqitë Perëndimore miratuan disa ligje paraprake për kthimin e pronës mes viteve 1947 dhe 1949, të cilat urdhëruan personat privatë të kthenin pasuritë që ishin shpronësuar apo marrë për shkak të persekutimit politik, ose të paguanin kompensim financiar. Pas përfundimit të periudhës së pushtimit, këto ligje u integruan në ligjin e RFGJ-së, dhe u zgjeruan në kuadër të Aktit Federal të Kthimit të vitit 1957. Akti detyronte RFGJ-në për të paguar kompensim për pasuritë e grabitura nga Partia Naziste apo autoritetet shtetërore. Përfituesit ishin të persekutuar, kryesisht hebrenj apo edhe të afërmit e tyre të mbijetuar. Kishte mes tyre edhe raste të ashtuquajtura «pasuri pa trashëgimtar», ku ish-pronarët ishin vranë apo nuk kishin trashëgimtarë ligjor. Këto raste iu caktuan organizatave pasardhëse hebraike. Rreth 3.5 bilion marka gjermane iu paguan përafërsisht 100.000 personave privatë deri nga mesi i viteve 1950, kohë kur «kthimi privat» kishte përfunduar në masën më të madhe. Shumë prej tyre ishin prona dhe bizneset nga i ashtuquajturi «Arjanizim».

Rikthimet publike të RFGJ-së u shtuan edhe me 4 bilion marka gjermane, që u paguan kryesisht si kompensim për pasuritë e grabitura dhe «konfiskuara», që përfshinin objekte arti, metale të çmuara dhe stoqe, si dhe bizhuteri, mobileje e shumë të tjera.

Në të dyja rastet, shumat e paguara nuk arritën të dëmshpërblenin atë çfarë kishte qenë në fakt vjedhur ose shpronësuar nga viktimat hebraike. Kjo veçanërisht mund t'i atribuohet faktit se kompensimi u pagua vetëm për ato asete të cilat nuk kishin

⁸⁸ Rombeck-Jaschinski, Ursula. 2005. Das Londoner Schuldenabkommen. Die Regelung deutscher Auslandsschulden nach dem Zweiten Weltkrieg. München: Oldenbourg Verlag; Hockerts, Bilanz, faqe 191; Hockerts, Entschädigung, faqe 14.

⁸⁹ Fisch, 'Reparationen,' faqe 179-226, veç. 196, 216, 218; Hockerts, 'Entschädigung,' faqe 16. Zona Sovjetike dhe për pasojë RDGJ duhej të mbante peshën më të madhe reparacioneve (si në terna relative ashtu edhe ndoshta në vlerë absolute).

⁹⁰ Duke qenë se fokusi i këtij botimi është përballja e Gjermanisë me të kaluarën diktatoriale dhe pasojat e saj, të gjitha masat që lidhen me pasojat e luftës janë duke u përjashtuar. Megjithatë, vlen të theksohet e ashtuquajtura Lastenausgleich (barazimi i barrës) e vitit 1952, iu dedikua kompensimin financiar dhe mbrojtjes së viktimave gjermane të luftës dhe pasojat e saj. Qëllimi ishte shpërndarja e barrës së luftës dhe përballimi solidar i nga e popullata dhe jo vetëm nga individët e veçantë. Për këtë arsye, të gjithë poseduesit ekzistues të pronave në Gjermaninë Perëndimore duhej të paguanin një taksë. Kjo taksë arriti në 50 për qind të pronës në fjalë, dhe duhej të shlyej brenda 30 vjetëve në një fond barazie. (equalization fund). Paratë e fondit u përdorën për të paguar pagesat barazuese për viktimat e luftës. Në vitin 2001, këto pagesa arritën në rreth 115 miliardë marka gjermane. Lastenausgleich është konsideruar si rishpërndarja me e madhe e pasurisë në histori. Hauser, Richard: Zwei deutsche Lastenausgleiche – Eine kritische Würdigung. Në: Vierteljahrshefte zur Wirtschaftsforschung 80 (2011), faqe 103-122. Më e detajuar në: Wiegand, Lutz. 1992. Der Lastenausgleich in der Bundesrepublik Deutschland 1949 bis 1985. Frankfurt am Main..



mbetur në vendet e huaja por ishin sjellë në territorin ku më pas u krijua RFGJ-ja. Kjo situatë ishte shpesh e vështirë ose e pamundur për t'u provuar. Për më tepër, vetëm personat që jetonin në shtetet me të cilat FRGJ kishte marrëdhënie diplomatike mund të paraqisnin kërkesa për dëmshpërblim. Kjo çoi në përjashtimin e shumë përfituesve nga «blloku lindor», të cilët ishin prekur më shumë se të tjerët.⁹¹

Ideja e “Wiedergutmachung” në aspektin e kompensimit të dëmeve ndaj jetës, trupit, shëndetit, lirisë, pronës dhe pasurisë, si dhe pengesave për avancimin profesional ose financiar, u adresua nga Akti Federal Shtesë i vitit 1953, i cili u rishikua në 1956 (Bundesentschädigungsgesetz, BEG, Akti Federal i Kompensimit) dhe 1965 (Bundesentschädigungs-Schlussgesetz, Beg-SG; Akti Përfundimtar Federal për Dëmshpërblimin).⁹² Akti përcaktoi se kush konsiderohej viktimë apo “person i dëmtuar” dhe përcaktoi llojin dhe masën e kompensimit. Afati i fundit për aplikime ishte vendosur fundi i vitit 1969. Pas vitit 1965, Akti u plotësua edhe me fondet e “vështirësisë”.⁹³

Mbi këtë bazë, rreth 650,000 viktima të nazizmit, morën një pagesë vetme dhe 360.000 përfituan pension mujor. Në 1998, këto përfitime të paguara arritën në 70 deri 80 bilion marka gjermane.⁹⁴ Përfitimet e veçanta ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme. Ndërsa pagesat fillestare për çdo të burgosur në kampet e përqendrimit ishin vetëm 5 marka gjermane për çdo ditë burgim, shpenzimet mjekësore dhe pensionet në rastet e dëmeve të shëndetit dhe avancimit në punë ishin dukshëm më bujare. Rreth 80 për qind e pagesave të kompensimit shkuan në vendet e huaja dhe rreth 50 për qind e tyre për Izraelin. Megjithatë, në realitet shumica e viktimave të nazizmit që jetonin në vendet e tjera nuk përfituan nga këto masa për shkak të parimit territorial të kompensimit.⁹⁵

Përveç kësaj, rrethi i përfituesve u ngushtua edhe më tej nga klauzola e marrëdhënieve diplomatike e cila mundësonte kompensimin vetëm për personat që banojnë në shtete me të cilat FRGJ-ja ka mbajtur marrëdhëniet diplomatike. Izraeli ishte i vetmi përjashtim nga kjo dispozitë. Përveç Bashkimit Sovjetik, nuk ekzistonin marrëdhënie diplomatike me asnjë nga shtetet e Evropës Lindore. Bashkimi Sovjetik, nga ana tjetër, nuk ishte i interesuar të negocionte për kompensim të çfarëdo lloji.⁹⁶

Qeveria Federale këmbënguli që pretendimet e viktimave të huaja të përjashtuara duhet të plotësoheshin në kontekstin e reparacioneve, të cilat u shtynë në afat të pacaktuar nga Marrëveshja e Londrës për Borxhet e Jashtme Gjermane. Megjithatë, Qeveria Federale u ndje e detyruar të lidhë marrëveshje ndërkombëtare për kryerjen e pagesave të tilla me disa shtete, kjo për shkak të konsideratave dhe nevojave të politikës së saj të jashtme. E para e këtij lloji ishte Marrëveshja e Luksemburgut me Izraelin e vitit 1952, e cila përbante përfitime në shumën 3 miliardë marka gjermane. Kjo pak a shumë përmblidhte kostot e integritit të rreth gjysmë milion të mbijetuarve të Holokaustit në shoqërinë

⁹¹ Hockerts, 'Bilanz,' faqe 170-175; Hockerts, Hans Günter. 2013. 'Wiedergutmachung in Deutschland 1945-1990. Ein Überblick' Aus Politik und Zeitgeschichte 25-26:15-22 (Shkurtuar në vijimi si Hockerts, 'Überblick'); Goschler, Constantin. 2005. Schuld und Schulden. Die Politik der Wiedergutmachung für NS-Verfolgte seit 1945. Göttingen: Wallstein Verlag, faqe 203-212, 262-272.

⁹² Aktet u bazuan mbi themelet e lëna nga forcat amerikane. Shih Goschler, Constantin: Wiedergutmachung. Westdeutschland und die Verfolgten des Nationalsozialismus. 1945-1954. München et al. 1992; Id., Schuld. Veprimet nuk janë hartuar vetëm nga RFGJ; Kontribut i rëndësishëm erdhi nga Konferenca Hebreje për pretendimet materiale kundër Gjermanisë (Konferenca Hebreje e Kërkesave), një shoqatë ombrellë e më shumë se 20 organizatave hebraike themeluar në vitin 1951 për të përfaqësuar interesat e viktimave hebreje që jetojnë jashtë Izraelit.

⁹³ Për këtë si edhe për paragrafët në vijim Guckes, Opferentschädigung, faqe 33-38; thelbësore Hockerts, Überblick, S. 17-22; Id., Bilanz, faqe 175-203, 209-214; Reichel, Vergangenheitsbewältigung, faqe 73-96; Goschler, Schuld, faqe. 233-247, 413-475.

⁹⁴ Numrat nga: Hockerts, Überblick, faqe 17.

⁹⁵ Për shkak të këtij parimi kompensimi ishte i kufizuar në te persekutoarit që kishin banuar në RFGJ apo në Berlinin Perëndimor në datën efektive të 31 dhjetor të vitit 1952, ose që kanë jetuar nga 1937 brenda kufijve të Rajhut në kohën e persekutimit dhe ishin rezidentë në RFGJ dhe Berlinin Perëndimor deri në datën efektive. Në këtë mënyrë të gjitha viktimat me kombësi të huaj që kishin qëndruar apo kthyer në vendet e tyre si dhe kështu shumica e të gjithë viktimave u përjashtua nga përfitimi. Shih BEG § 4. Rrethi i përfituesve (më vonë) u zgjerua pjesërisht.

⁹⁶ Rrethi i përfituesve u ngushtua më tej nga afatet e aplikimit dhe kriteret e kualifikimit.



izraelite. Më tej, 450 milionë marka gjermane u dhanë në Konferencën e Kërkesave (Pre-
tendimeve) të Hebrenjve si kompensim për hebrenjtë që jetonin jashtë Izraelit.

Ndërmjet viteve 1959 dhe 1964, njëmbëdhjetë të ashtuquajtura «marrëveshje globale» u nënshkruan me shtete të Evropës Perëndimore, Veriore dhe Jugore⁹⁷ për të kompensuar të paktën pjesërisht viktimat e nacional-socializmit që banonin në këto vende. Pagesat arritën në një shumë të përgjithshme prej 876 milionë marka gjermane, shpërndarja e të cilave u krye nga vendet përkatëse. Në këmbim, Qeveria Federale Gjermane kërkoi siguri për përfundimin e të gjitha pretendimeve në lidhje me krimet naziste nga shtetet përfituese. Megjithatë, me përjashtim të Luksemburgut, të gjitha shtetet e tjera rezervuan të drejtën për të pretendime shtesë pas përfundimit të një traktati paqeje të përcaktuar në Marrëveshjen e Londrës. Në vitin 1970 marrëveshje të mëtejshme u lidhën me Jugosllavinë dhe Poloninë, marrëveshje të cilat ofronin më shumë ndihmë ekonomike këtyre vendeve sesa kompensim. Pas ribashkimit të dy shteteve gjermane, Qeveria Federale arriti me ndihmën e SHBA-ve, Marrëveshjen Dy-Plus-Katër e cila në vend një traktati formal paqeje u konsiderua si “Traktat për Zgjidhjen Përfundimtare në lidhje me Gjermaninë” (Treaty on the Final Settlement with Respect to Germany”). Në këtë mënyrë shpresohet tu jepej fund pretendimeve të mëtejshme të kompensimit. Megjithatë, qeveria gjermane u ndje e detyruar të kompensojë viktimat e NS-it që banonin në Evropën Lindore. Për këtë qëllim, «marrëveshje globale» u nënshkruan me Poloninë, Rusinë, Ukrainën dhe Bjellorusinë, si dhe Estoninë, Lituaniën dhe Republikën Çeke, në shumën e përgjithshme 1.8 milionë marka gjermane. Përveç kësaj, Gjermania e bashkuar mbuloi pretendimet e paraqitura nga Konferenca e Kërkesave të Hebrenjve të cilat ishin refuzuar nga RDGJ-ja në lidhje me pronat e rrëmbyera dhe të grabitura gjatë luftës. (kapitulli 2 d iii).

Jo vetëm viktimat e huaja të NS-it ishin të disavantazuara apo përjashtuara nga kompensimi (për një kohë të gjatë). Grupi i «viktimize të harruara», siç u quajt më vonë, përfshiu edhe të quajturit «ciganë», «anti-socialë» apo «kriminelë», viktimat e sterilizimit, punës së detyruar, dhe «vdekjes së lehtë»; si dhe homoseksualëve, dezertorëve ose «kundërshtuesve të luftës.» Këto kategori personash nuk ishin harruar gabimisht, por ishin përjashtuar qëllimisht nga përkufizimi i kategorive të cilat u konsideruan si viktima të persekutimit NS-t në Aktin Federal të Kompensimit. Kjo erdhi si pasojë e një vazhdimësie të të menduarit në terma racorë dhe kriminalë, ku u argumentua se rastet e tyre nuk ishin specifikisht padrejtësi naziste por masa rregullatore “normale” nga shteti ose pasojë(a) të “zakonshme” të luftës.⁹⁸ Vetëm nëse këto pasoja kishin tejkaluar masën e pranueshme për një shtet në sundimin e ligjit, personat e prekur kishin të drejtë të kërkonin përfitime sociale (në një masë të vogël), por jo kompensim si pjesë e “Wiedergutmachung”. U desh kohë, deri në vitin 1980, që kjo formë diskriminimi të adresohet efektivisht nga kritikantët dhe të krijohej një fond i veçantë “vështirësi” (hardship fund) prej 300 milionë marka gjermane.

Në rastin e punës së detyruar, kompanive gjermane dhe Qeverisë Federale iu desh deri në fund të viteve 1990 për të rënë dakord për një zgjidhje. Kjo edhe në kontekstin e padive kolektive të ngritura në Shtetet e Bashkuara për këtë çështje. Kjo çoi në krijimin e fondacionit «Përkujtim, Përgjegjshmëri dhe E Ardhme» i cili u pajis me një buxhet prej 10 miliardë marka gjermane dhe iu ngarkua detyra për të kryer kompensimin financiar të personave të mbijetuar mes atyre që kishin kryer punë të detyruar. Deri në vitin 2007, 1.66 milionë ish-punëtorë të detyruar morën 4.37 miliardë euro në formën e pagesave të kompensimit. Interesat nga një fond i themeluar nga fondacioni u përdorën për të financuar përkujtime dhe projekte dokumentimi⁹⁹.

⁹⁷ Këto ishin Franca, shtetet e Beneluxit, Greqia, Britania e Madhe, Norvegjia, Danimarka, Suedia, Italia dhe Zvicra.

⁹⁸ Hockerts, Überblick, faqe 18. Përkthyer nga gjermanishtja.

⁹⁹ Walgenbach, Arndt. 2007. ‘Zwangsarbeiter-Entschädigung’. Në Fischer, Torben & Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der ‘Vergangenheitsbewältigung’ in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 323-325. Bielefeld: Transkript.



Deri në fund të vitit 2011, Gjermania kishte investuar në tërësi rreth 69 miliardë euro për kompensimin e padrejtësive naziste¹⁰⁰. Në këtë mënyrë, Gjermania morri përgjegjësitë e saja për padrejtësitë NS-ve dhe vuajtjet shumta të të persekutuarve. Përmes tyre nuk përfituan vetëm viktimat. FRGJ-ja në përgjithësi fitoi prestigj të konsiderueshëm ndërkombëtar i cili ishte mjaft i rëndësishëm për integrimin me Perëndimin.

Kjo ishte, megjithatë larg «Wiedergutmachung» në kuptimin fjalë për fjalë të ndreqjes së padrejtësive të shkaktuara. Duke pasur parasysh karakterin dhe dimensionin e krimeve naziste, «Wiedergutmachung» ishte jo vetëm i paimagjinueshëm dhe i pamundshëm. Kompensimi financiar mund të konsiderohej më shumë një gjest simbolik i pranimit dhe ndihmës për të zbutur vuajtjet e shkaktuara. Nga ana tjetër, në realitet mund të ishte bërë edhe më shumë, kjo për shkak të njohjes së vonuar të shumë nga viktimave të nazizmit dhe pretendimeve të tyre. Shumë marrëveshje mbi kompensimin mbërritën tepër vonë. Vetëm në vitin 2015, të burgosurit sovjetikë të luftës u njohën zyrtarisht si viktimat të NS-it. Nga 5.3 milionë të burgosur, vetëm 2 milion i mbijetuan burgimit dhe prej tyre vetëm një pjesë e vogël janë ende gjallë. Pavarësisht shumëve të mëdha të paguara si kompensim, vlen të theksohet se më shumë se 20 milion viktimat të NS-it, nuk morën ndonjëherë kompensim.¹⁰¹

III. Politika e Kompensimit në RDGJ

Që në fillim të periudhës së pushtimit, një qasje tjetër ndaj kompensimit u shfaq në Gjermaninë Lindore. Këtu, kuptimi i «Wiedergutmachung» ishte i kufizuar në detyrimin për të paguar dëmshpërblim ndaj Bashkimit Sovjetik. Kjo erdhi për shkak se Gjermania Lindore, ndryshe nga RFGJ-ja, nuk e paraqiste veten si «shtet pasues» apo «pasardhësi juridik» i «Rajhut të Tretë», por përkundrazi si një «entitet i ri shtetëror sipas ligjit ndërkombëtar».¹⁰² RDGJ-ja pretendonte se nuk i përkiste «vazhdimësisë historike të Rajhut Gjerman dhe për pasojë nuk mbante përgjegjësi për krimet e Gjermanisë Naziste».¹⁰³ Kur Bashkimi Sovjetik njoftoi fundin e reparacioneve në vitin 1953, shteti i Gjermanisë Lindore e konsideroi detyrimin e tij të përmbushur. Ndonëse pagesa u kryen viktimave të NS-it, këto pagesa ndoqën një logjikë krejtësisht të ndryshme nga ajo e RFGJ-së. Ato nuk e konsideroheshin si kompensim i paguar nga një «shoqëri e autorëve përgjegjës» ndaj viktimave, por si përfitimeve sociale nga shteti për qytetarët në nevojë dhe më vonë si pagesa honorifike për qytetarët e dalluar. Për këtë arsye, pagesat u kufizuan për individët që banonin në RDGJ, ndërsa kërkesat nga vendet të tjera u refuzuan kategorikisht.¹⁰⁴

Pak para themelimit të RDGJ-së, më 5 tetor 1949, u lëshua një Dekret për «Krijimin e një Urdhri të ri për Sigurimin e të Drejtave të Viktimave të Njohura të Persekutimit Nazist». Ky dekret rregulloi përfitimet e mirëqenies sociale për të persekutuarit e NS-it deri në vitin 1965. Të persekutuarit e regjimit nazist (Verfolgte des Naziregimes, VdN) u përcaktuan si persona të «persekutuar brenda ose jashtë Gjermanisë për shkak të fesë, racës, aktivitetit politik, rezistencës kundër regjimit nazist apo pasigurisë politike»¹⁰⁵ si dhe personave në varësi të tyre. Këta persona kishin të drejtë të përfitonin mbështetje sociale më të madhe në formën e sigurimit të invaliditetit dhe pensioneve, si dhe për-

¹⁰⁰ Bundesministerium der Finanzen. 2012. 'Entschädigung von NS-Unrecht. Regelungen zur Wiedergutmachung.'

¹⁰¹ Hockerts, 'Bilanz,' faqe 213; Musial, David. 2007. 'Wiedergutmachungs- und Entschädigungsgesetze.' Në Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der 'Vergangenheitsbewältigung' in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 58-60. Bielefeld: Transkript, Reichel, 'Vergangenheitsbewältigung,' faqe 96.

¹⁰² Hockerts, Bilanz, faqe 208. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹⁰³ Goschler, Schuld, faqe 316. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹⁰⁴ Për këtë edhe për paragrafët ne vijim Hockerts, Überblick, faqe 21; Ibid., 'Bilanz,' faqe 203-209; Guckes, 'Opferentschädigung,' faqe 44; veç. Goschler, 'Wiedergutmachung,' faqe 361-411.

¹⁰⁵ Cituar nga Goschler, Schuld, faqe 373. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹⁰⁶ Këto përfshinin konsiderata preferenciale në ndarjen e hapësirës së banimit dhe lokaleve afariste, në strehim dhe në kujdesin shëndetësor. Përveç kësaj, fëmijët e tyre përfitonin grante studimi. Personat e punësuar përfitonin një mbrojtje të veçantë në punë dhe ditë shtesë pushimi.

itime dhe privilegje të mëtejshme.¹⁰⁶ Ndryshe nga RFGJ, përfitimet për viktimat NS-it nuk ishin të lidhura me dëmet si pasojë e persekutimit. I vetmi parakusht për përfitimin e tyre ishte njohja e statusit të viktimës së regjimit nazist. Ky status ishte i hapur për të persekutuariat politik, luftëtarët e rezistencës, hebrenjtë, të ashtu-quajturit «Versippte»¹⁰⁷, «ciganët» dhe viktimat e sterilizimit të detyruar. Megjithatë, në rastin e të persekutuuarve politike, luftëtarëve të rezistencës, Sinti dhe Romëve, njohja e statusit ishte e lidhur me të ashtuquajturën «sjellje të mirë». Për të persekutuariat dhe luftëtarët e rezistencës pritej ndër të tjera vazhdimësia e «qëndrimeve antifashiste-demokratike» edhe pas vitit 1945. Sinti dhe Romët duhet të tregonin besnikëri ndaj RDGJ-së dhe të regjistroheshin në agjencinë e punësimit pas vitit 1945. Çdo veprim në kundërshtim me sa më sipër konsiderohej shkak për përjashtim nga përfitimi.¹⁰⁸ Ashtu si në RFGJ, viktimat e «eutanzisë», punëtorët e detyruar dhe homoseksualët nuk u konsideruan përfitues.

Në vitin 1949, 36.200 persona u njohën si viktimat të persekutimit nazist, numër i cili arriti në 40.622 në vitin 1953. Në vitin 1953, kostot e përfitimeve të dhëna në formën e mirëqenies sociale arritën në 40.3 milionë marka gjermane lindore. Numri i viktimave të regjimit nazist shënoi rënie të vazhdueshme në vitet e ardhshme. Kjo si rezultat i vdekjeve, migrimit në Perëndim, por edhe tërheqjeve të shumë viktimave të nazizmit të motivuara politikisht dhe ekonomikisht, sidomos të personave që nuk konformoheshin me idetë politikë të regjimit dhe SED.

Pensionet u llogaritën në bazë të të ardhurave të fundit vjetore të viktimave para persekutimit ose arritjes së moshës për pension. Si pasojë, luftëtarët e rezistencës që i përkisnin kryesisht klasës punëtore kishin pensione më të ulëta dhe kështu e konsideronin veten të disavantazuar në krahasim me grupet e tjera të persekutuara. Kjo ishte «në kundërshtim me qëndrimin socialist ndaj luftës së klasave».¹⁰⁹ Në vitin 1965, RDGJ-ja ndryshoi politikën e saj. Përfitimet e mëparshme u zëvendësuan me pensionet e nderit. Vendimtar për përcaktimin e shumave të përfitimit ishte statusi si «luftëtar» ose «viktimë», dhe vetëm të persekutuariat politikë dhe luftëtarët e rezistencës u përkasin grupit të parë. Në përputhje me «sistemin e vlerave të RDGJ-së»,¹¹⁰ «luftëtarët» merrnin një pension nderi prej 800 marka gjermane lindore në muaj kur mbërrinin moshën e pensionit, ose në rast invaliditeti. Këta ishin më të favorizuar se personat me statusin e «viktimës», të cilët merrnin 600 marka gjermane lindore.¹¹¹ Këto përfitime nuk jepeshin vetëm për motive humanitare. Ato ishin gjithashtu një investim në marrëdhëniet publike të shtetit në mbështetje të «viktimave», veçanërisht «luftëtarëve» të cilët konsiderohej si «ikona të luftës kundër fashizmit»¹¹² edhe si të tillë legjitimomin ekzistencën RDGJ-së si «shtet antifashist» dhe kështu sundimin e SED-it.

Kërkesat për kompensime individuale ose kolektive nga jashtë territorit u refuzuan vendosmërisht nga RDGJ-ja. Deri në rënien e saj, sidomos Shtetet e Bashkuara, Izraeli dhe Konferenca për Kërkesat e Hebrenjve i bëri RDGJ-së thirrje të përsëritura.¹¹³ Qeveria e RDGJ-së, këmbënguli në të qenit një shtet të ri, pa asnjë përgjegjësi morale apo politike për padrejtësitë naziste. Përveç kësaj, u argumentua se shteti kishte dhënë shërbime të shquara për «çrrënjosjen e rrënjëve të fashizmit», ku vetë «ekzistenca

¹⁰⁷ Në regjimin Nazist, personat e lidhur me martesë me Hebrenjtë quheshin «versippt».

¹⁰⁸ Kriteret të ngjashme përjashtimi u përcaktuan nga në BEG Gjermanisë Perëndimore ku individët të caktuar përjashtoheshin kur ata «luftuan rendin themelor demokratik e të lirë.» Kjo ishte kryesisht kundër komunistëve.

¹⁰⁹ Goschler, Schuld, faqe 379. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹¹⁰ Ibid. faqe 384

¹¹¹ Krahasuar me pensionet mesatare të zyrtarëve dhe punonjësve të M 164, dy pensionet e nderit ishin të larta. Shuma u ngrit disa herë në vitet në vijim.

¹¹² Goschler, 'Schuld,' faqe 397. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹¹³ Konferenca e Kërkesave të Hebrenjve kërkoi pagesa kompensuese në një shumë prej 1.5 bilionë dollarë: dy të tretat nga RFGJ dhe një të tretën nga RDGJ. RFGJ pagoi pjesën e saj takuese përmes marrëveshjes së Luksemburgut. Pas 1989/90, pjesa takuese e RDGJ-se u pagua gjithashtu.



e RDGJ-së [konsiderohej] kompensim në vetvete».¹¹⁴ Përveç kësaj, pretendimet e përmbushura për reparacione ndaj Bashkimi Sovjetik dhe përfitimet gjithëpërfshirëse ndaj të persekutuarve të regjimit nazist u përdorën gjithashtu si argumente.

e) Dokumentimi, Paralajmërimi, Përkujtimi

I. Riedukimi dhe Edukimi Qytetar në Zonat Perëndimore dhe RFGJ

Riedukimi i shoqërisë gjermane u kuptua nga Aleatët si një “fillim të ri radikal kulturor përmes denazifikimit dhe kontrollit të gjithë jetës kulturore gjermane.”¹¹⁵ Paralelisht me denazifikimin, menjëherë pas luftës, fuqitë pushtuese filluan të mbyllnin qendrat informative, institucionet kulturore dhe arsimore të tilla si shkollat, agjencitë e shtypit, stacionet e radios, kinematë, teatrot, shtëpitë botuese dhe bibliotekat. Të gjitha llojet e mediave kontrolloheshin në lidhje me përmbajtjen e tyre naziste, militariste dhe raciste. Shkrimet, simbolet, institucionet dhe organizatat nacional-socialiste u ndaluan. Përveç kësaj, Aleatët përballën popullsinë gjermane me krimet nacional-socialiste, duke shpresuar për diskreditimin përfundimtar të «Rajhut të Tretë» dhe ideologjisë naziste. Për këtë qëllim në kinematë gjermane dhe kampet e të burgosurve filluan të shfaqen të ashtuquajturat filma “të mizorive të luftës”, duke treguar skena nga çlirimi i kampeve të përqendrimit dhe të shfarosjes në masë. Megjithatë, qëllimi i riedukimit nuk ishte vetëm «spastrimi» i kulturës gjermane nga nazizmi dhe militarizmi. Fuqitë e huaja punuan shumë për rindërtimin pozitiv të jetës kulturore, sidomos përmes importimit të produkteve të veta kulturore si letërsi, lojëra, filma, por edhe përmes stacioneve radiofonike dhe gazetave. Ata krijuan edhe institucionet e tyre, të tilla si “Shtëpitë Amerikane”. Konceptuar fillimisht si biblioteka informative, ato u zhvilluan në vijimësi si institucione kulturore me programe të pasura. Përveç institucioneve të përhershme, 130 biblioteka të lëvizshme u krijuan dhe u vunë në dispozicion të qyteteve më të vogla. Fokusi i këtyre përpjekjeve ishte në përcimin e konceptimit amerikan të demokracisë dhe «ushtrimit» të pjesëmarrjes demokratike. Si «dritare për në Perëndim», këto programe ishin të destinuara të pasqyronin kulturën amerikane dhe për ta paraqitur atë si një model me vlerë për tu kopjuar. Qëllime të ngjashme u ndoqën edhe në qendrat kulturore në zonën britanike dhe programin amerikan të shkëmbimit kulturor përmes të cilit 14.000 gjermanë udhëtuan në Shtetet e Bashkuara deri në fund të viteve 1950.¹¹⁶

Vëmendje e veçantë iu kushtua “riedukimit” të të rinjve gjermanë, të cilët konsidero-heshin si e ardhmja e vendit por që ishin ndikuar mjaft nga ideologjia NS-te. Kështu, përpjekje të mëdha u zhvilluan në lidhje me reformimin e sistemit arsimor. Mësuesit e komprometuar u shkarkuan dhe u zëvendësuan nga mësues të rinj politikisht të besueshëm. Mësuesit më pak të komprometuar u ri-trajnuan. Librat shkollorë të periudhës Naziste u zëvendësuan me ato të Republikës së Vajmarit ose libra të shkruar rishtazi. Përveç kësaj, kurrikula u pastrua nga idetë naziste dhe u zëvendësua nga subjekte të reja për edukimin qytetar, të tilla si e drejta civile dhe studimet shoqërore. Praktikrat autoritare mësimore u zëvendësuan me praktika arsimore demokratike. Mësimi me ide-alet demokratike kërkonte që nxënësit dhe prindërit e tyre të integroheshin në organizimin e jetës së përditshme shkollorë.

¹¹⁴ Goschler, ‘Schuld,’ faqe 401. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹¹⁵ Schildt, Axel. 1999. ‘Kultur und geistiges Leben.’ Në Benz, Wolfgang (Ed.) Deutschland unter alliierter Besatzung 1945-1949/55. Ein Handbuch, faqe 134. Berlin: Akademie Verlag.

¹¹⁶ Kreis, Reinhild. 2014. ‘Nach der “amerikanischen Kulturoffensive”. Die amerikanische Reeducation-Politik in der Langzeitperspektive.’ Në Gerund, Katharina dhe Paul, Heike (Ed) Die amerikanische Reeducation-Politik nach 1945. Interdisziplinäre Perspektiven aus America’s Germany, faqe141-161. Bielefeld: Transkript; Benz, Wolfgang. 2009. Auftrag Demokratie. Die Gründungsgeschichte der Bundesrepublik und die Entstehung der DDR 1945-1949. Berlin: Metropol Verlag. Gjithashtu për paragrafët në vijim Gerund, Katharina dhe Paul, Heike (Ed). 2014. Die amerikanische Reeducation-Politik nach 1945: Interdisziplinäre Perspektiven auf ‘America’s Germany’. Bielefeld: Transkript. Për më shumë në lidhje me programet e shkëmbimit kulturor shih: Latzin, Ellen. 2005. Lernen von Amerika? Das US-Kulturaustauschprogramm für Bayern und seine Absolventen. Stuttgart: Franz Steiner Verlag.

Plani i reformave shkoi edhe më larg, në riorganizimin e sistemin shkollor sipas standardeve të secilit nga vendet që kontrollonte zona të caktuara të vendit, por kjo ide dështoi për shkak të kundërshtimit si nga politika dhe vetë njerëzit. Megjithatë, përpjekjet aleate nuk u kufizuan vetëm në sistemin shkollor. Amerikanët, për shembull, themeluan “Aktivitetet Gjermane për të Rinjtë” (GYA) dhe organizuan netë kulturore me shfaqje filmash, mbledhje vallëzimi, diskutime, evente sportive, klasa fotografie dhe shumë më tepër në qendrat e tyre rinore. Në një atmosferë informale dhe të hapur, të rinjtë do të përvetësonin ideale të tilla demokratike si toleranca, loja e ndershme, pluralizmi, autonomia dhe vetë-iniciativa. Të mësuar deri tani me indoktrinim dhe nënshtrim ndaj autoritetit, ata duhet të ekspozoheshin ndaj vlerave të kulturës popullore amerikane. Në Zonën Franceze, nga ana tjetër, takimet ndërkombëtare rinore u organizuan me qëllim shkëmbimin kulturor.¹¹⁷

Në rrjedhën e Luftës së Ftohtë dhe integrimin e Gjermanisë me Perëndimin, politika e riedukimit ndryshoi. Qasja e “pedagogjisë nga lartë poshtë” u zëvendësua me trajtimin e gjermanëve si partnerë të barabartë. Me rifitim të sovranitetit të Gjermanisë në vitin 1955, masat e Aleatëve morën fund. Vetëm disa institucione të tilla si “Shtëpitë Amerikane” (të cilat më pas u quajtën Institute Gjermano-Amerikane) vazhduan të ekzistojnë. Kjo nuk çoi në fundin e “edukimit qytetar” por në vazhdimin e tij nga ana e Gjermanisë me kushtet e veta. Ndër nismat dhe institucionet qendrore ishte Agjencia Federale për Edukim Qytetar, e themeluar në që vitin 1952.¹¹⁸ Si një agjenci shtetërore për edukimin qytetar, ajo kishte për detyrë të informonte publikun për gjendjen e demokracisë në shtetin gjerman të krijuar rishtas, institucionet, funksionimin, rregullat dhe vlerat, dhe për të promovuar pjesëmarrjen demokratike dhe angazhimin kritik në lidhje me të kaluarën nacional-socialiste. Për këtë qëllim, kjo agjenci boton një revistë javore dhe botime të shumta, organizon konkurse, prodhon filma edukativë, mesazhe në media dhe shumë të tjera. Përveç kësaj, ajo ofron udhëtime studimore që promovojnë shkëmbimin kulturor dhe të botëkuptimin ndërkombëtar.¹¹⁹

II. Përmbysja “Antifashiste - Demokratike” në Zonën Sovjetike dhe RDGJ

Riedukimi i shoqërisë gjermane nuk ishte vetëm një qëllim i ndjekur nga Fuqitë Perëndimore por edhe nga Bashkimi Sovjetik në SOZ. Megjithatë, në Gjermaninë Lindore riedukimi ishte pjesë e “përmbysjes antifashiste - demokratike”, riorganizimit socialist të shtetit dhe të shoqërisë. Ishte formuar jo vetëm nga një kuptim krejtësisht i ndryshëm i demokracisë nga Zonat Perëndimore, por edhe një përkufizimi socialist sipas të cilit demokracia ishte sundimi i klasës punëtore që realizohet duke shtetëzuar mjetet e prodhimit dhe përmes sundimit të Partisë Marksist-Leniniste. «Fashizmi», nga ana tjetër, u përcaktua si «diktaturë e hapur terroriste me elementet më reaksionare, shoviniste dhe imperialiste të kapitalit financiar».¹²⁰ Kapitalizmi, veçanërisht në formën e industrisë dhe pronësisë së tokës në shkallë të gjerë, u konsiderua kështu burimi kryesor i Nacional-socializmit.¹²¹ Për këtë arsye, me qëllim eliminimit e parakushteve strukturore të fashizmit u morën një sërë masash të cilat synonin jo vetëm spastrimet edhe

¹¹⁷ Füssl, Karl-Heinz. 1994. Die Umerziehung der Deutschen: Jugend und Schule unter den Siegermächten des Zweiten Weltkriegs 1945-1955. Paderborn: Ferdinand Schöningh; Füssl, Karl-Heinz. 1999. ‘Bildung und Erziehung.’ Në Benz, Wolfgang (Ed.) Deutschland unter alliierter Besatzung 1945-1949/55. Ein Handbuch, faqe 99-105. Berlin: Akademie Verlag; Herzig, Simone. 2012. ‘Entnazifizierung und Re-Education in den westlichen Besatzungszonen. Konzeption, Durchführung und Scheitern.’ Në: Glunz, Claudia (Ed.) Attitudes to War. Literatur und Film von Shakespeare bis Afghanistan, faqe 129-134. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht; Benz, Auftrag, faqe 136-139.

¹¹⁸ Deri në vitin 1963 quhej Agjencia Federale për Shërbimin ndaj Atdheut (Federal Agency for Homeland Service)

¹¹⁹ Bundeszentrale für politische Bildung. Geschichte der Bundeszentrale für politische Bildung. ‘Gründung und Aufbau 1952-1961.

¹²⁰ Welsh, Umwälzung, faqe 103. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹²¹ Osterloh, Jörg. 2011. ‘Diese Angeklagten sind die Hauptkriegsverbrecher. Die KPD/SED und die Nürnberger Industriellen-Prozesse 1947/48.’ Në Osterloh, Jörg dhe Vollnhals, Clemens (Ed.) NS-Prozesse und deutsche Öffentlichkeit. Besatzungszeit, frühe Bundesrepublik und DDR, faqe 107-131. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht; Felbick, Dieter. 2003. ‘Demokratie.’ Në Felbick, Dieter (Ed.) Schlagwörter der Nachkriegszeit 1945-1949, faqe 175-206. Berlin: De Gruyter.



një reformë të tokës dhe shpronësim të «kriminelëve të luftës» dhe «kapitalistëve». Këto konsideroheshin hapa të domosdoshëm për demokratizim e vendit në konceptin socialist të demokracisë dhe u plotësuan më tej me masat e riedukimit të cilat kishin për qëllim eliminimin e vlerave dhe ideve nacional-socialiste, rritjen e ndërgjegjes së klasës punëtore, krijimin e «unitetit të klasës punëtore»¹²² dhe një «njeriut të ri».¹²³

Ashtu si në Zonat Perëndimore, vëmendje e veçantë iu kushtua të rinjve. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të bashkoheshin dhe shoqërizoheshin në organizatat komuniste. Pas shpërbërjes së organizatave rinore NS-te, SED lejoi krijimin e «Rinisë së Lirë Gjermane» (RLG), e cila në kishte monopolin mbi organizatat rinore. Edhe pse anëtarësimi ishte formalisht vullnetar, mospjesëmarrja kishte pasoja negative sociale dhe profesionale. RLGJ dhe filiali i saj organizata e fëmijëve «Ernst Thälmann», ofronte një mbulim të gjerë aktiviteteve duke filluar nga ngjarjet sportive në organizimet me karakter politike. Aktivitetet e këtyre organizatave ishin të lidhura ngushtë me SED-in dhe i shërbenin qëllimeve indoktrinuese politike. Në vend të pluralizmit dhe për zhvillimin e lirë të individit, riedukimi në Zonën Sovjetike çoi në nënshtrim dhe konformizëm.

Planet për riorganizimin e sistemit arsimor gjerman u hartuan në Bashkimin Sovjetik gjatë luftës. Qëllimet kryesore ishin uniformizimi i sistemit shkollor, ndarja e shkollës nga kisha si dhe «thyerja e monopolit borgjez në arsim»¹²⁴ përmes hyrjes së lirë të të gjithë fëmijëve në shkolla dhe «frymës së re të demokracisë luftarake».¹²⁵ Ashtu si në zonat e tjera të pushtuara, shkollat naziste u mbyllën, materialet mësimore nacional-socialiste u eliminuan dhe trupat mësimore u rishqyrtuan. Kjo e fundit u ndoq me rigorozitet në SOZ deri në fund të vitit 1949, ku më shumë se dy të tretat e mësuesve u zëvendësuan nga mësues me bindje të reja politike. Këtu përfshiheshin edhe mësuesit e padëshiruar për arsye të tjera politike. Kështu, personeli mësimor i politizuar i shërbente qeverisjes së SED. Përveç kësaj, kurrikula u ndryshua në mënyrë të konsiderueshme. Ndryshimet përfshinin ndër të tjera edhe studimin e historisë e cila tashmë të dominohej nga materializmi historik për hir të edukimit socialist.

Në qendër të reformës shkollore sovjetike ishte shkolla e dekonfesionalizuar dhe e detyrueshme tetë-vjeçare. Sipas planeve sovjetike, fëmijët e punëtorëve dhe fermerëve do të privilegjoreshin për tu pranuar në shkollën e mesme katër vjet, Oberschule. Duke filluar nga vitet 1949-1950, fëmijët nga klasat e tjera sociale filluan gjithashtu të pranohen në nivelet më të larta të edukimit nëse tregonin përputhshmëri dhe bindje ndaj sistemit. Reformat prekën edhe arsimin universitar. «Arbeiter- und Bauernfakultäten» (universitetet e punëtorëve dhe fermerëve) u menduan si ndarje përfundimtare me konceptin borgjez të «arsimit të privilegjuar» dhe si mjet për formësimin e elitave të reja drejtuese. Aspiratat socialiste për edukimin e masave u zgjeruan gjithnjë e më shumë në të gjitha sferat e jetës së të rinjve dhe të rriturve. Depërtimi totalitar i «Rajhut të Tretë», u pasua nga kontrolli i përgjithshëm dhe konformizmi i detyruar politik i regjimit të SED.

III. Kulturat Përkujtimore në «Lindje» dhe në «Perëndim»

Në territorin e RFGJ-së u ngritën një numër i konsiderueshëm vendesh përkujtimore, pllakate, monumente, muzeume, ekspozita dhe qendra të dokumentimit të përkushtuara ndaj përkujtimit të viktimave dhe informimit të publikut në lidhje me krimet e

¹²² Füssl, 'Umerziehung,' faqe 192 Përkthyer nga gjermanishtja.

¹²³ Kleßmann, Christoph. 1981. 'Politische Rahmenbedingungen der Bildungspolitik in der SBZ/DDR 1945 bis 1952.' Në Heinemann, Manfred (Ed.) Umerziehung und Wiederaufbau. Die Bildungspolitik der Besatzungsmächte in Deutschland und Österreich, faqe 229-243. Stuttgart: Klett-Cotta, veç. faqe 234-236; Fritsch-Bournazel, Renata. 1979. Die Sowjetunion und die deutsche Teilung. Die sowjetische Deutschlandpolitik 1945-1949. Opladen: Westdeutscher Verlag. Gjithashtu të rëndësishme për paragrafët në vijim, 'Umerziehung,' faqe 29-33, 187-364; Ibid., 'Bildung,' faqe 99-105.

¹²⁴ Füssl, 'Bildung,' faqe 103. Përkthyer nga gjermanishtja

¹²⁵ Ibid., 'Umerziehung,' faqe 193. Përkthyer nga gjermanishtja.

NS-it. Sot, e kaluara naziste është më e pranishme se kurrë më parë. Ajo është bërë një “pikë qendrore referimi e identitetit kombëtar»¹²⁶ duke zbehur realitetin problematik të përballjes tepër të ndryshme me të kaluarën në dy shtetet gjermane për dekada.

Deri në vitet 1960, angazhimi me të kaluarën në RFGJ karakterizohej shtypja selektive dhe mohimi. Të përballur me ndjenjën e fajit dhe përgjegjësisë përmes procesit të denazifikimit dhe ekspozimit të krimeve në gjykimet e NS-ve, shoqëria gjermane nuk u angazhua në një vlerësim kritik dhe konstruktiv të së kaluarës së saj në vitet e pushimit dhe kaosit të pasluftës. Në vend të saj, duke injoruar besnikërinë në masë dhe përgjegjësinë e përbashkët, pjesë të mëdha të shoqërisë e përshkruan veten si viktime: si njerëz që u joshën dhe më pas u tradhtuan nga një elitë e vogël naziste e cila ishte edhe fajtorja e vetme për krimet dhe luftën; si viktime të luftës dhe të pushtimit të padrejtë. Shpesh, kjo u shoqërua me tendencën e “fajtorëve fajësues” ku vrasjet masive naziste u vendosën në kontrast me sulmet ajrore Aleate dhe dëbimin e gjermanëve nga Lindja. Në këtë mënyrë, krimet naziste u zhvendosen në kontekstin e një “luftë përgjithësisht të dhunshme”, ose u errësuan nga shprehje dhe metafora abstrakte.¹²⁷

Ndërsa themelimi i RFGJ-së dhe krijimi i Ligjit Bazik shënoi një shkëputje me të kaluarën në nivel institucional, “heshtja” kaploi shoqërinë e Gjermanisë Perëndimore. Dëshira për normalitet dhe harmoni pas viteve të kaosit dhe vështirësive të luftës u plotësua edhe me bindjen e përhapur se gjermanët kishin pësuar mjaftueshëm për të shlyer fajet e tyre. Shumica kërkonte lëniën pas të së kaluarës, gjë që ndikoi jo vetëm në uljen e gjykimeve, por edhe në një angazhim të përgjithshëm në rënie lidhur me krimet e nacional-socialistëve. Në vend të saj, qëndrimi indiferent dhe «nuk-dua-t'ia-di»-ja¹²⁸ u bënë dominuese.

Në këtë atmosferë të përgjithshme, përpjekjet e fillestare të përkujtimit erdhën nga viktimat NS-it dhe më pak nga Aleatët. Fillimisht, kryqet, pllakat përkujtimore apo faqet e dekoruara të varreve për të kujtuar viktimat që kishin humbur jetën, u ngritën në vendet historike të krimeve. Megjithatë, shumë iniciativa u penguan nga kundërshtimet e banorëve; ndërtesa të shumta u shkatërruan ose u përdorën për qëllime të tjera për shkak të pragmatizmit, indiferencës apo dëshirës së vetëdijshme për të harruar atë që kishte ndodhur.¹²⁹ Në rrjedhën e viteve 1950, si skenat historike të krimeve ashtu dhe ngjarjet që kishin ndodhur atje, ranë në harresë.¹³⁰

Në RDGJ, nga ana tjetër, përpjekjet e sponsorizuara nga shteti për përkujtim filluan që në fund të viteve 1940. Iniciativat e ish të burgosurve u morën parasysh dhe përkujti-

¹²⁶ Köhr, Katja. 2012. Die vielen Gesichter des Holocaust. Museale Repräsentationen zwischen Individualisierung, Universalisierung und Nationalisierung. Göttingen. faqe 91. Përkthyer nga gjermanishtja.

¹²⁷ Thelbësore për këtë kapitull: Ibid. faqe 91-94; Wielenga, Friso 1995. Schatten deutscher Geschichte. Der Umgang mit dem Nationalsozialismus und der DDR-Vergangenheit in der Bundesrepublik. Vierow bei Greifswald: SH-Verlag, faqe 27-50 (vijon shkurtimisht si Wielenga, Geschichte); Wielenga, Friso. 2002. 'Erinnerungskulturen im Vergleich. Deutsche und niederländische Rückblicke auf die NS-Zeit und den Zweiten Weltkrieg.' Në: Wielenga, Friso dhe Geeraedts, Loek (Ed) Erinnerungskultur und Vergangenheitspolitik, faqe 11-20. Münster: Aschendorf Verlag, Herbert, Ulrich dhe Groehler, Olaf. 1992. Zweierlei Bewältigung. Vier Beiträge über den Umgang mit der NS-Vergangenheit in den beiden deutschen Staaten. Hamburg: Ergebnisse Verlag, faqe 7-28; Frei, Norbert. 2009. 'Deutsche Lernprozesse – NS-Vergangenheit und Generationenfolge seit 1945.' Në Frei, Norbert (Ed.) 1945 und wir. Das Dritte Reich im Bewußtsein der Deutschen, faqe 38-55. München: Deutscher Taschenbuch Verlag, Thamer, Hans-Ulrich. 2006. 'Der Holocaust in der deutschen Erinnerungskultur vor und nach 1989.' Në: Brinkmeyer, Jens dhe Blasberg, Cornelia (Ed) Erinnern des Holocaust? Eine neue Generation sucht Antworten, faqe 81-93. Bielefeld: Aisthesis Verlag.

¹²⁸ Sipas Hermann Lübke, faza e “heshtjes” ishte e nevojshme për shumicën e njerëzve për tu asimiluar me shoqërinë e re demokratike. Kjo teza pati kundërshtime. Wielenga, Geschichte, faqe. 49 f.

¹²⁹ Në periudhën e pasluftës, shumë nga ish-kamperit e përqendrimit dhe burgjet u përdorën si kampe pritje për personat e zhvendosur (IDP), refugjatët dhe të dëbuarit, apo si kampe internimi të aleatëve. Më ato pas u përdorën si burje, fabrika, stacione policore, struktura ushtarake apo hapësire strehimi.

¹³⁰ Garbe, Detlef. 1992. 'Gedenkstätten. Orte der Erinnerung und die zunehmende Distanz zum Nationalsozialismus.' Në: Loewy, Hanno (Ed.) Holocaust. Die Grenzen des Verstehens. Eine Debatte über die Besetzung der Geschichte, faqe 260-284. Hamburg: Rowohlt; Endlich, Stefanie. 2009. 'Orte des Erinnerns. Mahnmale und Gedenkstätten.' In: Reichel, Peter et. al. (Ed) Der Nationalsozialismus - die zweite Geschichte. Überwindung, Deutung, Erinnerung, faqe 350-377. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung.



more e monumente u ngritën në vendet e mizorive naziste. Megjithatë, përmendoret qendrore të RDGJ-së, u realizuan vetëm në 1950 kur forca pushtuese sovjetike mbylli të ashtuquajturat «kampe të posaçme» dhe në këtë mënyrë, ish kampet e përqendrimit Sachsenhausen dhe Buchenwald nuk u përdorën më si kampe internimi. Politika e përkujtimit e drejtuar nga shteti në RDGJ-së u zgjerua masivisht në vitet në vijim. Tre Memorialë Kombëtare «Nationale Mahn- und Gedenkstätten» u dizenuan sipas udhëzimeve uniforme të hartuara nga regjimi i SED dhe që përputheshin me konceptimin zyrtar të historisë. Këto memorialë u ngritën brenda ose në afërsi të ish kampeve të përqendrimit Buchenwald, Sachsenhausen dhe Ravensbrück. Ato iu përkushtuan në rezistencës komuniste dhe çlirimit nga Ushtria e Kuqe. Viktimat komuniste në këtë mënyrë u heroizuan dhe u paraqitën si grupi kryesor i të persekutuuarve dhe kundërshtarëve më të rëndësishëm të regjimit nazist. Duke evokuar vazhdimësinë nga rezistenca komuniste gjatë luftës tek krijimi i RDGJ-së antifashiste, përmendoret u përdorur si mjet për të propaganduar fitoren e komunizmit ndaj fashizmit dhe për të legjitimuar shtetin e krijuar nën udhëheqjen e SED.

Në të mirë të vetë-përfaqësimit të shtetit, viktimat e tjera, shkaqet dhe mekanizmat e regjimit nazist u lanë jashtë pothuajse tërësisht. Kapitalizmi u portretizua si themeli i nacional-socializmit. Ndërsa «kapitalistët» dhe «pronarët e tokës» u shpallën si fajtorët e vërtetë të nazizmit, besnikëria e masave u injorua dhe shoqëria e Gjermanisë Lindore u çlirua (pothuajse ekskluzivisht) ndjenja e fajit dhe përgjegjësisë për krimet naziste. Në këtë mënyrë, e kaluara naziste u shtrembërua dhe keqinterpretua në mënyrë të konsiderueshme.³³¹

Në RFGJ “mohimi i të kaluarës”,³³² vetëm gradualisht i hapi shteg angazhimit kritik dhe publik në lidhje me regjimin nazist dhe krimet e tij. Ky ndryshim u katalizua ndër të tjera nga një valë kundërshtimi ndaj anti-semitizmit e shfaqur në disa ngjarje si gjyqi “Einsatzgruppen” në Ulm (1958), gjyqi ndaj Eichmann në Izrael (1961) dhe gjyqi i Aushvicit në Frankfurt (1963-1965); transmetimi i serisë amerikane “Holokaust” në 1979 si dhe rritja e kritikave nga ana e një gjenerate të re e cila nuk pranonte kompromisin me të shkuarën. Me kalimin e viteve, u bë gjithnjë e më tepër e qartë se çfarë ishte shtypur dhe fshehur më parë, dhe kjo çoi në kritika edhe më të ashpra ndaj (mos)angazhimit me të kaluarën. Zhvillim i një publiku kritik solli të kaluarën në fokusin e shoqërisë dhe ndihmoi për të thyer gradualisht³³³ “paktin e heshtjes së brezit të përfshirë”.³³⁴

Fokusi i debateve në vijim ishin më në fund viktimat e regjimit nazist, sidomos ato të Holokaustit, për të cilin Aushvici u kthye në simbol. Ndërsa më parë, vetëm të mbijetuarit kishin evokuar dhe mbajtur gjallë kujtimet, përpjekjet e tyre filluan të mbështeten gjithnjë e më shumë nga nismat e qytetarëve. Duke filluar nga fundi i viteve 1970, shumë klube lokale të historisë (Geschichtswerkstätten) u zhvilluan dhe filluan të bëjnë kërkime mbi të kaluarën përkatëse naziste. Së bashku me organizatat rinore, shkollat, kishat dhe grupet sindikale ata iniciuan projekte për dokumentimin dhe përkujtimin në vende me rëndësi historike në lidhje me krimet e nazizmit.

Një shembull i mirënjohur i iniciativave në nivelin komunitar është organizata e paqes Aksioni i Pajtitimit (Aktion Sühnezeichen),³³⁵ e themeluar në vitin 1958 për t’u përballur me trashëgiminë NS-te dhe për të evokuar paqen dhe pajtimin. Organizata organizon vizita për të rinjtë në vendet e prekura nga Lufta e Dytë Botërore, ku ata ofrojnë kontrib-

³³¹ Endlich, ‘Orte,’ veç. faqe 354, 360.

³³² Garbe, ‘Gedenkstätten,’ faqe 273.

³³³ Thünemann, Holger. 2005. Holocaust-Rezeption und Geschichtskultur. Zentrale Holocaust-Denkmal in der Kontroverse. Ein deutsch-österreichischer Vergleich. Idstein: Schulz-Kirchner Verlag, faqe 55-57; Endlich, ‘Orte,’ faqe 362-366. Vendimtare për këtë ndryshim ishin rritja, demokratizimi dhe liberalizimi i shoqërisë gjermane.

³³⁴ Köhr, Gesichter, faqe 93.

³³⁵ Që prej vitit 1968, organizata mban emrin Shërbimi i Aksionit të Pajtitimit për Paqe (Action Reconciliation Service for Peace).

utin e tyre vullnetar ndaj viktimave të luftës dhe të regjimit nazist, në projekte kundër ksenofobisë dhe antisemitizmit, “kërkimit të faljes dhe paqes”¹³⁶ Që nga viti 1967, organizata ka ofruar kontributin e saj vullnetar në memorialin e Aushvicit.¹³⁷

Përveç kësaj, Nacional – Socializmi, krimet dhe vuajtjet e viktimave u trajtuan gjithnjë e më shumë nga akademikët, në filma, pjesë teatrale dhe letërsi. Pas 1980, fokusi u zgjerua edhe tek përndjekësit dhe kushtet strukturore të nazizmit, të cilat lejuan evidentimin e kompleksitetit të këtyre krimeve. Ky zhvillim gjeti shprehjen e vet në hapjen e ekspozitës «topografia e terrorit», në vitin 1987. Kjo ekspozitë merret me autoritetet kryesore të planifikimit dhe ekzekutimit të krimeve naziste. Më 1990, një tjetër ekspozitë e identifikoi krimet e kryera nga ana e Vermahtit, i cili deri më atëherë ishte idealizuar si një organizatë që kishte mbetur «e mirë» me gjithë mizoritë e luftës. Ekspozitat kontribuuan në rënien e mitit se vetëm një elitë e vogël naziste kishte qenë përgjegjëse për krimet NS-te. Megjithatë, në të njëjtën kohë, reagimet treguan këmbënguljen dhe rezistencën e shumë në lidhje me të kaluarën dhe ndjenjën e fajit që e shoqëronte atë. Zërat që kërkonin të vinin një gur mbi të kaluarën ishin akoma të pranishëm në vitet 1980, por tashmë ato nuk kishin më mundësi të mbizotëronin debatin.

Krahasimisht, një angazhim i tillë ndaj së kaluarës, nuk ndodhi në RDGJ. Përkujtimi publik i saj mbeti i lidhur me konceptin e historisë së SED, e cila instrumentalizoi të kaluarën për edukimin patriotik dhe promovimin e ideologjisë marksiste-leniniste. Iniciativat komunitare u lejuan në raste të rralla, pasi qeveria dhe SED i perceptonte ato si një rrezik për politikën zyrtare të përkujtimit.¹³⁸ Deri në Parlamentin e fundit Popullor të RDGJ-së nuk kishte ndarje të qartë me politikën e përkujtimit të SED. Në prill të vitit 1990, parlamenti pranoi publikisht përgjegjësinë e RDGJ -së për Holokaustin në emër të qytetarëve të saj, dhe i kërkoi Izraelit dhe të gjithë hebrenjve falje për mangësitë në ballafaqimin me të kaluarën.

Vitet 1990 panë një rritje të mëtejshme në angazhimin publik me të kaluarën NS-te.¹³⁹ Kjo erdhi, nga fakti se pjesa më e madhe e shoqërisë gjermane tani i përkiste një brezi të ri, identiteti i të cilit nuk ishte aq i ngarkuar sa i mëparshmi me ballafaqimin me të kaluarën. Përveç kësaj, konteksti i ballafaqimit me të kaluarën kishte ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme nga fundi i “Luftës së Ftohtë” dhe ribashkimi i dy shteteve gjermane. Ajo nuk ishte më e ngarkuar me konflikte ideologjike, dhe “Perdja e Hekurt” nuk pengonte më pamjen e krimeve të kryera në “Lindje”. Për më tepër, rënia e RDGJ-së si një pikë qendrore referimi për identitetin kombëtar të RFGJ-së solli një kërkesë të re për kuptuar. Në këtë kontekst, përkujtimi erdhi në qendër të vëmendjes politike dhe shoqërore.

Deri më tani, më tepër vëmendje iu kushtua Holokaustit dhe viktimave hebraike. Por vëmendja ndaj viktimave të tjera u rrit në vazhdimësi.¹⁴⁰ Këto zhvillime gjetën shprehje në vendet kryesore përkujtimore në Berlin. Pas debateve të gjata, «Memoriali Përkujtimor i Hebrenjve të vrarë në Evropë», u përfundua në vitin 2005. Ai u pasua nga «Memoriali i Përkujtimit të Homoseksualëve» të përndjekur nën regjimin nazist në vitin 2008 dhe «Përkujtimorja e viktimave Sinti dhe Romë» në vitin 2012. Përveç kësaj, u zhvilluan

¹³⁶ Westphal, Jasmin. 2007. ‘Aktion Sühnezeichen.’ Në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (Ed) Lexikon der ‘Vergangenheitsbewältigung’ in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 69- 71. Bielefeld: Transkript.

¹³⁷ Ibid., faqe 69-71. Aksioni i Pajtitimit punoi si në RFGJ ashtu edhe në RDGJ, por u nda me ndërtimin e Murit të Berlinit në vitin 1961. Organizata është ende aktive sot; projektet dhe çështjet e adresuara prej saj kanë ndryshuar dhe janë zgjeruar që nga themelimi.

¹³⁸ Endlich, Orte, faqe 364.

¹³⁹ Niven, Bill. 2002. Facing the Nazi Past. United Germany and the Legacy of the Third Reich. New York: Routledge, faqe 2; Bergem, Wolfgang. 2003. ‘Barbarei als Sinnstiftung? Das NS-Regime in Vergangenheitspolitik und Erinnerungskultur der Bundesrepublik.’ Në: Bergem, Wolfgang (Ed.) Die NS-Diktatur im deutsche Erinnerungsdiskurs, faqe 88-101. Opladen: Lenke und Budrich.

¹⁴⁰ Disa grupe të persekutuarish (si Sinti dhe Roma, homoseksualët, punëtorët e detyruar, komunistët, dhe të burgosurit Sovjetikë të Luftës) prej shume kohësh nuk njiheshin si viktimë të regjimit NS për shkak të paragjyqimeve ndaj tyre (kapitulli 2 d ii).



iniciativa të ndryshme lokale dhe forma krejtësisht të reja të përkujtimit. Ndër këto janë të ashtuquajturat Stolpersteine, të cilat janë pllaka të vogla prej bronzi (të instaluar në kalldrëm) në të cilat shkruhet emri, datëlindja dhe informacion mbi fatin e viktimës. Këta gurë përkujtimorë u vendosën në ish vendin e fundit të banimit të viktimës. Deri më sot, 50.000 Stolpersteine janë vendosur në 1.300 vende të ndryshme nëpër Evropë. Ky projekt përkujtimor u zgjerua më tej me vendosjen e gurëve të mëdhenj përkujtimorë në vendet ku u kryen krime masive.¹⁴¹

Me kalimin e kohës, e shkuara u bë gjithmonë e më e pranishme. Sot, krimet e NS-te dhe viktimat e tyre janë pjesë përbërëse e kujtesës kolektive dhe identitetit politik të Gjermanisë. Fakti që shoqëria gjermane ishte në gjendje të zhvendosej nga shtypja dhe heshtja në një angazhim aktiv me krimet dhe fajin është konsideruar shpesh një faktor qendror në demokratizimin e saj. Megjithatë, angazhimi në përballjen me të kaluarën naziste ishte dhe ende është një proces jo i lehtë dhe unanim, por një i formuar nga debate të nxehta. Deri më sot, ai ka çuar në polemika për mënyrën e drejtë të trajtimit dhe interpretimit të së kaluarës. Megjithatë, edhe kjo është pjesë e natyrshme e përballjes me të.

¹⁴¹ Deming, Gunter. 'Start.' <http://www.stolpersteine.eu/start>; Deming, Gunter. 'Technik' <http://www.stolpersteine.eu/technik>; Thurn, Nike. 2007. 'Stolpersteine.' Në: Fischer, Torben dhe Lorenz, Matthias N. (ed) Lexikon der 'Vergangenheitsbewältigung' in Deutschland. Debatten- und Diskursgeschichte des Nationalsozialismus nach 1945, faqe 338-340. Bielefeld: Transkript.



SCHLUB MIT STASI u. SED:
DIKTATUR u. NAZISMUS
viel UNRECHT und LEID klagt euch an



3. Drejtësia Tranzicionale pas vitit 1990: Përballja me Diktaturën në RDGJ

a) Sfidat dhe Rrethanat

Pas rënies së regjimit të SED dhe ribashkimit të dy shteteve gjermane në 1989/90, shoqëria gjermane ishte dhe ende është duke u ballafaquar me një proces të konsiderueshëm transformimi dhe nevojë për t'u marrë me një të kaluar diktatoriale për të dytën herë brenda 50 viteve. Ndërsa procesi i përballimit të pasojave të diktaturës pas vitit 1945 është konsideruar si një nga rastet më komplekse të drejtësisë së tranzicionit për shkak të sfidave dhe rrethanave të tij specifike (shih kapitullin 2 i), ai i pas viteve 1989/90 është konsideruar rast i veçantë historik.

Rrethanat në të cilat procesi u zhvillua ishin tërësisht të ndryshme nga ato pas vitit 1945. Rënia e diktaturës së SED nuk ishte shkaktuar nga lufta, por nga një revolucion paqësor brenda shtetit. Për këtë arsye procesi i përballimit me të kaluarën nuk ishte i udhëzuar apo kontrolluar «nga jashtë, por nisur nga vetë populli i Gjermanisë Lindore dhe në vazhdim nga e gjithë shoqëria gjermane (pas bashkimit). Këtu, vlen të theksohet se bashkimi kuptoi inkorporimin e shtetit sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare, i cili do të thoshte një zgjerim i territorit të RFGJ-së dhe jo një ndryshim në «statusin e saj si shtet apo subjekt i së drejtës ndërkombëtare».¹⁴² RDGJ-ja pushoi së ekzistuari si subjekt i ligjit ndërkombëtar. I ashtuquajturit Beitrittsgebiet (territori aderues) u përfshi në dhe iu bashkëngjiti të gjitha strukturave para-ekzistuese demokratike të Gjermanisë Perëndimore. Kështu RFGJ, ndryshe nga pas vitit 1945, nuk u konsiderua si pasardhës ligjor apo shtet pasues. Të drejtat dhe detyrimet kaluan tek RFGJ ashtu siç u përcaktua shprehimisht në Traktatin e Bashkimit, i cili përbënte bazën kryesore ligjore për procesin e transformimit dhe përballjes me të kaluarën.

Sa u përket sfidave, shoqëria gjermane ishte mjaft e ndryshme nga ajo e pas vitit 1945. Asaj nuk i duhej të përballej me një ngarkesë të dyfishtë të ballafaqimit me pasojat e luftës dhe diktaturës në të njëjtën kohë. Jo vetëm që në këtë rast nuk kishte krime lufte, por proceset e përballjes me të kaluarën nuk komplikoheshin as nga probleme të kaosit e të pasluftës si uria, varfëria dhe integrimi i miliona refugjatëve dhe të përndjekurve. Në të kundërtën, shteti i Gjermanisë Perëndimore ishte në gjendje për të siguruar burime të mjaftueshme materiale dhe jo materiale. Për më tepër, qëllimi ishte i qartë që nga fillimi: «integrimi i RDGJ-së së shpërbërë në RFGJ-në moderne, të pasur dhe demokratike».¹⁴³

Edhe pse “aderimi” rezultoi të ishte më i vështirë nga çfarë parashikohej, thuhet se “parakushtet ishin ideale”¹⁴⁴ për ballafaqimin me të kaluarën në krahasim me situatën e Gjermanisë së pas vitit 1945 apo në krahasim me shtetet e tjera post-komuniste.¹⁴⁵ Megjithatë, përballja me diktaturën e SED u shoqërua me sfidën e bashkimit të brendshëm të dy shoqërive gjermane, marrëdhëniet mes të cilave ishin ftohur gjatë dyzet viteve të ndarjes. Ata nuk ishin një “komunitet i fateve të përbashkëta”, i lidhur me një të kaluar të përbashkët. Përvojat e tyre ndryshonin në mënyrë të jashtëzakonshme. Kështu, shoqëria e sapo bashkuar gjermane duhej të merrej me të kaluarën diktatoriale

¹⁴² Guckes, ‘Opferentschädigung,’ faqe 22 . Përkthyer nga gjermanishtja.

¹⁴³ Wielenga, ‘Geschichte,’ faqe. 111. Përkthyer nga gjermanishtja

¹⁴⁴ Glate, Sarah. 2011. Judging the (East) German Past. A Critical Review of Transitional Justice in Post-Communist Germany. Unpublished Bachelor's Thesis, University of Bath, United Kingdom.

¹⁴⁵ Glatte, ‘German Past’, faqe 6-8.; Glatte, Sarah. 2010. ‘Twenty Years On – A Unified Germany? The Shortcomings of the German Reunification Process.’ German as a Foreign Language 2:89-103. Gjithashtu Wielenga, ‘Geschichte’, faqe 19-26, 108-113; Wielenga, Friso. 1994. ‘Schatten der deutschen Geschichte. Der Umgang mit der Nazi- und DDR-Vergangenheit in der Bundesrepublik Deutschland.’ Deutschland Archiv 10:1058-1073 (shkurtuar në vijim si Wielenga, ‘Schatten’).



të vetëm 20 për qind të qytetarëve të saj në mënyrë që të hidhte themelet për një të ardhmeje paqësore dhe të qëndrueshme të përbashkët. Procesi i transformimit ishte tejet asimetrik. Ndërsa asgjë nuk ndryshoi për 80 për qind të popullsisë, çdo gjë ishte e re për qytetarët e ish RDGJ-së (për shkak të nevojës për barazimin e kushteve, standardeve dhe strukturave me ato të Gjermanisë Perëndimore). Kjo rezultoi të ishte një barrë e konsiderueshme.

Ka dallime të tjera të rëndësishme në krahasim me konfrontimin me të kaluarën pas vitit 1945. Së pari, procesi i transformimit dhe përballimit me të kaluarën pas 1989/90 gëzoi popullaritet më të madh. Kjo mund t'i atribuohet faktit se diktatura SED nuk ishte pranuar dhe mbështetur në masë të ngjashme me atë të regjimit nazist. Pikënisja si për përballjen me të kaluarën dhe demokratizimin ishte në këtë mënyrë më e mirë pasi «shumica e gjermano-lindorëve nuk kishin nevojë të bindeshin për avantazhet e sundimit të ligjit [Rechtsstaat]. Në ndryshim nga shumë gjermanë pas vitit 1945, ata nuk ishin dyshues por plot shpresë dhe besim tek demokracia».¹⁴⁶

Së dyti, krimet e dy diktaturave gjermane ndryshonin në karakter dhe në shtrirje. RDGJ-ja as udhëhoqi ndonjë luftë pushtuese edhe as kreu vrasje masive e të miliona njerëzve. Megjithatë, regjimi i SED kishte shkelur të drejtat e njeriut në mënyrë sistematike dhe masive për të ruajtur pushtetin dhe zbatuar ideologjinë e vet sunduese. Ndryshe nga regjimi nazist, diktatura e SED kishte kryer krime pothuajse ekskluzivisht kundër qytetarëve të vet. Edhe pse nuk mund të barazoheshin me mizoritë e «Rajhut të Tretë», krimet e kryera gjatë dyzet viteve të ekzistencës së RDGJ-së kishin arritur në një masë të tillë që ndjekja e tyre penale përbënte një sfidë më vete.

Së treti, çështja e fajit ishte e ndryshme pas 1989/90 në krahasim me atë pas vitit 1945. Numri i autorëve, bashkëpunëtorëve dhe mbështetësve të krimeve ishte më i vogël. Vetëm për një grup relativisht të vogël njerëzish konfrontimi me të kaluarën e pas viteve 1989/90 ishte një konfrontimi me «fajin e tyre politik dhe moral».¹⁴⁷ Përveç kësaj, pjesa më e madhe e shoqërisë gjermane tregoi më shumë solidaritet me viktimat e regjimit të SED se sa me viktimat e regjimit nazist. Të dy aspektet e bënë më të lehtë për t'u marrë me padrejtësitë e së kaluarës.

Së katërti, ishte e mundur të shihej prapa në përvojën e mëparshme me drejtësinë e tranzicionit, e cila shërbeu edhe si një pikë referimi pozitive dhe negative. Një nga efektet që procesi i parë i ballafaqimit me të kaluarën pati mbi të dytin është se ky i fundit u trajtua që në fillim të tranzicionit, intensivisht dhe me vendosmëri për të mos përsëritur gabimet e përpjekjeve të mëparshme.¹⁴⁸

Në vija të përgjithshme qasja e ndërmarrë ishte e ngjashme: ndjekja penale, lustracioni, rivendosja e së drejtës, edukimi qytetar dhe përkujtimi. Gjithsesi duke pasur parasysh kontekstin specifik, procesi i drejtësisë tranzicionale pati dallime të theksuara nga masat e marra pas vitit 1945. Për shembull në vend të riedukimit, fokusi u vendos tek rehabilitimi i cili luajti një rol vendimtar. Si një pikë referimi, e kaluara naziste dhe masat iniciuara për t'u përballur me të patën dy pasoja të mëtejshme dhe të rëndësishme për tu theksuar: krahasuar me mizoritë e regjimit nazist, ekzistonte rreziku që krimet e regjimit të SED të nënvlerësoheshin (apo që krimet naziste të relativizoheshin si pjesë e një debati të thjeshtuar mbi "totalitarizmin") dhe; suksesi i përpjekjeve të ndërmarrë të matej kundrejt atyre të pas vitit 1945, dhe perceptimet e suksesit nuk ishin universalisht të kënaqshme.

¹⁴⁶ Wielenga, 'Geschichte', faqe 113. Përkthyer nga gjermanishtja

¹⁴⁷ Ibid., 'Schatten,' faqe 1071. Përkthyer nga gjermanishtja

¹⁴⁸ Karstedt, Susanne. 1996. 'Die doppelte Vergangenheitsbewältigung der Deutschen. Die Verfahren im Urteil der Öffentlichkeit nach 1945 und 1989.' Zeitschrift für Rechtssoziologie 1:58-104; Weinke, Annette. 1998. 'Der Umgang mit der Stasi und ihren Mitarbeitern.' Në König, Helmut et. al. (Ed) Vergangenheitsbewältigung am Ende des zwanzigsten Jahrhunderts, faqe 167-191. Wiesbaden: VS Verlag für Sozialwissenschaften.

b) Ndjekja Penale: Gjykimi i Krimeve të kryera në RDGJ

Zbulimi dhe ndjekja e krimeve të kryera në RDGJ filloi që herët. Disa zyrtarë të lartë të SED ishin arrestuar ose vënë nën arrest shtëpiak gjatë periudhës së trazirave në fund të vitit 1989, ndërsa RDGJ-ja ekzistonte ende. Komisione të posaçme për hetimin e akuzave të manipulimit të zgjedhjeve, keqpërdorimit të autoritetit administrativ, korrupsionit dhe ryshfetit, u ngritën në nivele të ndryshme. Hetimet penale kishin filluar gjithashtu ndaj zyrtarëve të policisë dhe Ministrisë së Sigurimit të Shtetit (MfS) për shkak të dhunës së ushtruar kundër demonstruesve.¹⁴⁹ Megjithatë, vetëm disa procedura mund të kryeshin përpara bashkimit. Pjesa më e madhe e tyre u dorëzua gjyqësorit të RFGJ-së, i cili në këtë mënyrë kishte për detyrë të ndëshkonte krimet e kryera gjatë dyzet viteve të diktaturës.

Ashtu si pas vitit 1945, sfida kryesore ishte ndëshkimi i krimeve të kryera nga shteti totalitar me anë të mjeteve të shtetit të së drejtës. Kjo ishte problematike për shkak të shtrirjes dhe të larmishmërisë së padrejtësive. Krimet që do të ndiqeshin penalisht shkonin nga vrasje dhe akte të tjera të dhunshme në kufirin e brendshëm gjerman, shtrëmbërim të drejtësisë, krime të MFS-së si abuzimi¹⁵⁰ me të burgosurit dhe denoncimet, mashtrimi në votime, abuzimi me detyrën administrative, korrupsioni dhe vepra të tjera penale me natyrë ekonomike, spiunazh, doping u detyruar, etj.¹⁵¹

Rregullat e vendosura për ndjekjen penale dhe baza ligjore e parashikuar në Traktatin e Bashkimit përbënte një tjetër sfidë. Për tu përballur me të ashtuquajturin ndalim të fuqisë prapavepruese të ligjit (Rückwirkungsverbot)¹⁵² mishëruar në Ligjin Themelor Gjerman, nuk u miratua ndonjë ligj i veçantë penal ex-post facto (si në rastin e Gjyqit të Nurembergut të pas vitit 1945). Veprimet e konsideruara si të dënueshme duhet të ndëshkoheshin sipas ligjit që ishte në fuqi në kohën e veprës penale, d.m.th ligjit të RDGJ-së, dhe vetëm nëse akti ishte gjithashtu i dënueshëm sipas ligjit të RFGJ-së. Në rastet kur ligji i RFGJ-së ishte më i favorshëm për të akuzuarin, ai duhej të konsiderohej në vend të ligjit RDGJ.

Në këtë mënyrë, gjyqësori gjerman u përball me një situatë komplekse. Ai ishte njëkohësisht i legjitimuar nga Traktati i Bashkimit dhe i detyruar nga parimi i ligjshmërisë (Legalitätsprinzip¹⁵³) për të ndjekur penalisht krimet e ndodhura në RDGJ por edhe në pamundësi për të ndëshkuar shumë vepra në kundërshtim me sundimin e ligjit të cilat ose nuk ishin të dënueshme sipas ligjit RDGJ-së ose perspektiva e ndjekjes së tyre ishte shumë e dyshimtë. Çështja u komplikua edhe më tej nga fakti se gjyqësori jo vetëm që duhet të zbatonte formalisht ligjin RDGJ-së, por edhe të interpretonte atë në përputhje me ndalimin e prapaveprimit.¹⁵⁴ Si rezultat, shumë akte shpëtuan pa u ndëshkuar ose me standardet morale të drejtësisë shkuan pa u dënuar mjaftueshëm. Problemi themelor i cili ishte parashkrimi të një numri të madh krimesh u zgjidh me një vendim të legjislaturës së marsit të vitit 1993. Ky vendim parashikoi pezullimin e afateve të parashkrimit dhe rivendosjen e tyre në afat pas 3 tetorit 1990 me arsyetimin se këto krime nuk

¹⁴⁹ Karstedt, 'Vergangenheitsbewältigung', faqe 83.; Marxen, Klaus et.al 2007. Die Strafverfolgung von DDR-Unrecht. Fakten und Zahlen. Berlin: Stiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur, faqe 11-13.

¹⁵⁰ Këto përfshijnë akte të tilla si rrëmbime dhe burgosje të kundërshtarëve politikë, shtrëngime dhe shtrëmbërim të thënieve, kalim i paligjshëm kufiri, dhunimi i konfidencialitetit, përgjime telefonike, hapje e letrave dhe grabitje e sendeve me vlerë. Pjesërisht, denoncimet dhe abuzimet e të burgosurve janë të përfshirë gjithashtu në krimet e MFS.

¹⁵¹ Për më shumë informacion mbi secilin lloj krimi shih, Marxen, Klaus dhe Werle, Gerhard (Ed). 2007. Strafjustiz und DDR-Unrecht. Berlin: De Gruyter.

¹⁵² Rückwirkungsverbot është ndalimi i fuqisë prapavepruese: një akt mund të dënohet vetëm nëse ai ishte i dënueshëm me ligj në kohën e kryerjes së tij.

¹⁵³ Legalitätsprinzip ose parimi i ligjshmërisë është parimi i ndjekjes penale të detyrueshme: Prokurorët duhet të ngrenë padi kur ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një akuze.

¹⁵⁴ Juristët në veçanti, i shihnin këto dispozita si gabime të rënda në trajtimin juridik të krimeve në RDGJ. Shumë komplikacione mund të ishin shmangur nëse RFGJ nuk do ta kishte përjashtuar të ashtuquajturën Klauzola Nurembergut, (e cila lejonte prapaveprimin në rastet e krimeve të rënda) me nënshkrimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1952.



ishin hetuar për arsye politike. Katër vjet më pas, afati u shty për rastet e «krimeve të mesme» deri më 3 tetor 2000.¹⁵⁵

Me gjithë pengesat e shumta, gjyqësori demonstroi një gatishmëri më të madhe për të ndëshkuar shkelësit, seç kishte bërë me krimet e NS-it. Kjo i atribuohet pjesërisht faktit se zëvendësimi i elitave në gjyqësor ishte më thelbësor dhe se gjyqësori i pas viteve 1990 ishte i pa kompromentuar me padrejtësitë e «veta». Kjo gjeti shprehje në punën sistematike hetimore të filluar herët¹⁵⁶ dhe veçanërisht në një numër të madh të hetimeve kundër gjyqësorit të RDGJ-së për shtrembërim të drejtësisë¹⁵⁷. Pothuajse gjysma e 52.000 procedurave penale që filluan deri në vitin 1995 dhe iu përkushtuan hetimit të këtij lloj krimi.¹⁵⁸

Sipas ligjit të RDGJ, shtrembërimi i ligjit aplikohej kur vendimi i paligjshëm ishte bërë me vetëdije. Për të ndjekur penalisht një veprim të tillë, duhej provuar njëkohësisht si paligjshmëria ashtu dhe qëllimi fillestar.¹⁵⁹ Për të mos rënë në kundërshtim me ndalimin e prapaveprimit në zbatimin e gabuar të ligjit të RDGJ-së,¹⁶⁰ Gjykata Federale e Drejtësisë vendosi se jo çdo aplikimi i gabuar i ligjeve nga gjyqësori i RDGJ-së mund të konsiderohej si «shtrembërim i drejtësisë». Vetëm në rastet «e vendimeve haptazi të paligjshme dhe në të cilën të drejtat e veçanërisht të drejtat e njeriut, janë shkelur në një masë aq të madhe sa vendimi konsiderohet si akt arbitrar»¹⁶¹ mund të shpallëshin si shtrembërim i drejtësisë.

Në këtë mënyrë, mundësitë e penalizmit të shtrembërimit të ligjit u të kufizuan jashtëzakonisht duke qenë se jo vetëm actus reus (akti objektiv), por edhe mens rea (qëllimi) ishin të vështira për tu provuar. Rrëfimet nga të akuzuarit ishin të rralla. Kjo bëri të nevojshme kërkimet dhe të dhënat dokumentare siç ishin dosjet e MFS për indicje ose prova të tjera materiale. Kapacitetet njerëzore për të kryer këtë detyrë ishin pashmangshmërisht të pamjaftueshme, kështu që hetimet shpesh morën shumë kohë. Në shumë raste, provat nuk mund të mblidheshin (si për shembull, të dhënat ishin shkatërruar, arkivat nuk ishin të arritshme, ose provat ishin zhdukur) dhe një numër i madh hetimesh u ndërpreu. Edhe pse gjykimet për shtrembërim të drejtësisë shënuan pjesën më të madhe (36.6 për qind) të të gjitha gjykimeve lidhur me krimet RDGJ-së, numri i tyre absolut arriti në vetëm 374 gjyqe¹⁶². Duke pasur parasysh numrin

¹⁵⁵ Eser, Albin et. al (Ed). 2010. Strafrecht in Reaktion auf Systemunrecht. Vergleichende Einblicke in Transitionsprozesse. Freiburg: Max-Planck-Institut für ausländisches und internationales Strafrecht; Roggemann, Herwig. 1998. 'Die strafrechtliche Aufarbeitung der DDR-Vergangenheit am Beispiel der "Mauerschützen" und der Rechtsbeugungsverfahren. Eine Zwischenbilanz.' në: Drobniç, Ulrich (Ed.) Die Strafrechtsjustiz der DDR im Systemwechsel. Partei und Justiz. Mauerschützen und Rechtsbeugung, faqe 111-131. Berlin: Duncker dhe Humblot; Schaeffgen, Christoph. 1996. Vergangenheitsbewältigung durch die Justiz. Die Strafverfolgung von DDR-Regierungskriminalität. Regensburg: Roderer.

¹⁵⁶ Tërësisht ndryshe nga adresimi i hershëm i krimeve naziste, vetëm tre deri në pesë për qind të të gjitha hetimeve u filluan me iniciativa të personave privatë dhe raportimeve në polici. Gjyqësori mundi të përfitojë nga puna paraprake e kryer në "Regjistrin Qendror Shtetëror të Administratës Gjyqësore", në Salzgitter, i cili kishte filluar të mblidhte prova për shkeljet të të drejtave të njeriut në RDGJ që në vitin 1961. Shih Roggemann, Aufarbeitung, faqe. 229 f.

¹⁵⁷ Në të kundërt, nuk kishte hetime dhe ndjekje penale për krime gjyqësore NS (kapitulli 2 b ii).

¹⁵⁸ Hummer, Waldemar dhe Mayr-Singer, Jelka. 2000. 'Der deutsche Sonderweg bei der Aufarbeitung von SED-Unrecht. Vergangenheitsbewältigung durch Strafjustiz,' Neue Justiz 11:561-567.

¹⁵⁹ Edhe pse normat politike të Kodit Penal RDGJ ishin në kundërshtim me sundimin e ligjit si p.sh. shkelja masive e të drejtave themelore të njeriut, zbatimi i tyre nuk u kualifikua si shtrembërim i së drejtës. Dënimet bazuar në këto norma mund anuloheshin vetëm përmes procedurave të rehabilitimit (kapitulli 3 d). Për këtë edhe për paragrafët në vijim Meinertzhagen, Ulrich. 1995. 'Die Verfahren gegen ehemalige Richter der DDR.' në: Weber, Jürgen dhe Piazzolo, Michael (Ed) Eine Diktatur vor Gericht. Aufarbeitung von SED-Unrecht durch die Justiz, faqe115-136. München: Olzog-Verlag; Amelung, Knut. 1996. Die strafrechtliche Bewältigung des DDR-Unrechts durch die deutsche Justiz. Dresden: Dresden University Press, faqe 21-28.

¹⁶⁰ Me këtë, gjykatat llogaritën faktin se pavarësia e gjyqtarëve në RDGJ ishte e kufizuar dhe se ata ishin të detyruar nga kushtetuta të zbatonin ligjet në interes të SED.

¹⁶¹ Marxen, Klaus et al. (ed.): Strafrecht und DDR-Unrecht. Volumi 5: Rechtsbeugung. Sektionsi 2. Berlin 2007, faqe 1010. Përkthyer nga gjermanishtja. Ky ishte rasti kur teksti i ligjit ishte jashtëzakonisht i zgjeruar, kur dënimet ishin të rënda dhe në disproporcion me veprën e kryer, kur të drejtat e njeriut ishin shkelur rëndë nga praktika procedurale apo kur gjykimi nuk kishte qëllim vendosjen e drejtësinë, por ishte përdorur për qëllime të persekutimit politik. Idid. faqe 1010 f.

¹⁶² Marxen, Werle dhe Schäfer, 'Strafverfolgung,' faqe 28 .

e madh si të gjykimeve politike ashtu edhe procedurave paraprake në RDGJ, një pjesë e madhe¹⁶³ e krimeve të gjyqësorit mbeti pa u ndëshkuar.

Një tjetër drejtim i ndjekjes penale u fokusua në vrasjet e qytetarëve që u përpoqën të arratisen nga RDGJ-ja përmes kalimit të kufirit të brendshëm gjerman dhe që përmblihet në të ashtuquajturat gjykimet e të “Shtënave të Murit”.¹⁶⁴ Numri i personave të vrarë me armë zjarri, mina dhe armë shpërthyes në kufi është kontestuar. Megjithatë, vlerësimet e fundit flasin për më shumë se 1.000 persona.¹⁶⁵ Edhe pse vrasja (në rrethana cilësuese) ishte e dënueshme sipas ligjit të RDGJ-së, dënimi i vrasjeve në kufi ishte i diskutueshëm. Rojet kufitare kishin vepruar në përputhje me rregulloret e brendshme, urdhrat eprore dhe “Aktin e Kufijve” të vitit 1982 i cili i autorizonte ata të përdorin armët nëse do të ishte e nevojshme për të parandaluar kryerjen e veprës penale të “kalimit të paligjshëm të kufirit”.

Edhe pse “përdorimi i tepruar” i armëve të zjarrit ishte në teori i paligjshëm, ky krim nuk ishte dënuar ndonjëherë dhe veçanërisht rastet e parandalimit të arratisjes nga RDGJ-ja ose Republikflucht shpërbleheshin nga regjimi i kohës. Prandaj ishte e diskutueshme nëse urdhrat dhe ligjet justifikonin veprimet e tyre dhe përjashtonin personat nga përgjegjësia penale. Në një nga gjyqet më të hershme, Gjykata Federale vendosi se “Akti i Kufirit” nuk ishte një bazë për justifikimin e këtyre pasi ishte në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe më saktësisht me të drejtat e njeriut për jetën dhe lirinë e lëvizjes sipas Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), që ishte nënshkruar nga RDGJ-ja në vitet 1970. Arsyetimi se rojet ishin gabuar në lidhje me paligjshmërinë e veprimeve të tyre u hodh poshtë gjithashtu nga Gjykata Federale, e cila theksoi se vrasjet ishin haptazi të padrejta. Megjithatë, gjykata mori parasysh kontekstin e regjimit totalitar ku këto veprime ishin kryer dhe i vlerësoi ato si «vrasje në rrethana lehtësuese». Dënimet u pezulluan dhe personat u vendosën nën shërbimin e provës.

Aktgjykimi i Gjykatës Federale ishte novator për shumicën e gjyqeve në vijim të vrasjeve në kufi. Megjithatë, ky vendim tërhoqi kritika të shumëfishta. Ankesa mbërritën deri në Gjykatën Kushtetuese Federale e cila konfirmoi vendimin e Gjykatës Federale por edhe zbatoi formulën e zhvilluar nga Gustav Radbruch në dritën e krimeve naziste. Regjimi i kufirit ka qenë një «padrejtësi ekstreme e sponsorizuar nga shteti» dhe për të cilën «çdo justifikim në bazë të tij është i parëndësishëm».¹⁶⁶ Në sytë e gjykatave, ndalimi i prapaveprimit nuk u shkel, por thjesht u mënjana në favor të vendosjes së drejtësisë (materiale). Në pranverën e vitit 2001, vendimi u konfirmua edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Përpara gjyqit duhet të dilnin jo vetëm “Rojet e Murit” që shkaktuan vrasje të shumta në kufirin e brendshëm gjerman, por edhe anëtarët e Këshillit të Mbrojtjes Kombëtare, Byrosë Politike si dhe gjeneralët dhe komandantët e trupave kufitare, që kishin qenë përgjegjës për regjimin kufitar. Ndryshe nga gjykimet e NS-ve, ata që kishin dhënë urdhra nuk u konsideruan si planifikues apo ndihmës në kryerjen e këtyre veprave, por si autorë indirektë. Këtyre u atribuohet më shumë përgjegjësi se sa rojeve të kufirit. Dënimet e tyre ishin zakonisht më të rënda në krahasim me ndëshkimet relativisht të buta me 1-2 vite provë të «rojeve të murit». Për shembull, disa nga anëtarët e udhëheqjes së RDGJ-së, u dënuan me tre deri në shtatë vite e gjysmë burgim. Megjithatë,

¹⁶³ Përafërsisht u zhvilluan rreth 200,000 deri 250,000 gjyqe politike. Borbe, Ansga. 2010. Die Zahl der Opfer des SED-Regimes. Landeszentrale für politische Bildung Thüringen, faqe 15-20.

¹⁶⁴ Hummer & Mayr-Singer, ‘Sonderweg,’ faqe 563-566; Amelung, ‘Bewältigung,’ faqe 11-17; Amelung, Knut. 2005. ‘Die juristische Aufarbeitung des DDR-Unrechts. Strafrechtsdogmatik und politische Faktizität im Widerstreit.’ në: Kenkmann, Alfons dhe Zimmermann, Hako (Ed) Nach Kriegen und Diktaturen. Umgang mit Vergangenheit als internationales Problem. Bilanzen und Perspektiven für das 21. Jahrhundert, faqe 99-101. Essen: Klartext.

¹⁶⁵ 138 nga ata u vranë në Murin e Berlinit. Për shifrat shih Borbe, Zahl, faqe 32-34.

¹⁶⁶ Hummer & Mayr-Singer, ‘Sonderweg,’ faqe 564. Përkthyer nga gjermanishtja



disa nga figurat qendrore të regjimit të SED i shpëtuan përgjegjësisë edhe u konsideruan të paaftë për të dalë në gjyq për shkak të moshës dhe shëndetit. Fakti që kreu i shtetit, Erich Honecker nuk u ndëshkua, ishte një zhgënjim i madh për viktimat dhe kundërshtarët e regjimit.¹⁶⁷

Ndërsa referimi tek e drejta ndërkombëtare dhe formula Radbruch mundësuan ndjekjen penale të vrasjeve në kufi dhe disa prej krimeve më të rënda të regjimit të SED, raste të tjera “më pak të rënda” por shumë të shpeshta padrejtësie mbetën pa u ndëshkuar. Ky ishte fati i shumicës së të ashtuquajturave “krime të MfS”. Këto krime përbënë vetëm 14 për qind të gjykimeve, por duke pasur parasysh numrat e 231 të akuzuarve dhe 69 të dënuarve në total në krahasim me rreth 90,000 persona të punësuar me kohë të plotë dhe më shumë se 170,000 bashkëpunëtorëve jozyrtare të MfS, mungesa e proporcionalitetit të ndëshkimit duket mjaft e theksuar. Nga këta, vetëm një numër i vogël morri dënime me burgim. Këto në më të shumtën e rasteve u pezulluan apo u vendosën në regjimin e provës.¹⁶⁸

Numri i ulët i dënimeve pati disa arsye. Disa nga veprat e kryera rëndom si hapja e korrespondencës, hyrja e fshehtë në banesë dhe shkelja e fshehtësisë nga ana e mjekëve apo avokatëve mund të ndiqeshin penalisht vetëm nëse viktimat ngre padi brenda një kohe të shkurtër. Shkeljet e privatësisë, telekomunikacionit postar dhe fshehtësisë ishin aspak apo pak të dënueshme sipas ligjit RDGJ-së. Për këtë arsye, vetëm krimet më të rënda të MfS si rrëmbimi, vrasja apo ajo e mbetur në tentativë ishin të gjykeshme. Fakti që Erich Mielke, kreu i MfS, nuk u dënua për shkak të veprimeve të tij në RDGJ, por për shkak të një vrasje që daton në 1931, ishte për shumë njerëz një dëshmi e turpshme për ndjekjen e padrejtësive të ndodhura në RDGJ. Nga një tjetër pikë vështrimi, dënimi Mielke mund të shihet si dëshmi për vullnetin e gjyqësorit për të ndëshkuar një nga figurat më qendrore të regjimit të SED.¹⁶⁹

Ndjekja penale e padrejtësive të RDGJ-së ka përfunduar praktikisht. Rezultatet sasiore janë mjaft të pakta. Deri në vitin 2005, procedura hetimore u filluan kundër 100 mijë personave, por vetëm 1.737 prej tyre u akuzuan. Nga këta, vetëm 750 u dënuan dhe vetëm rreth 40 prej tyre morën dënime me burgim (të cilat nuk u pezulluan).¹⁷⁰ Kjo shpuri në gjykime të ndryshme. Disa flasin për “dorëzimin e sistemit juridik RFGJ-së ndaj krimeve të RDGJ-së”.¹⁷¹ Të tjerë e shohin ndjekjen e krimeve të SED si një histori suksesi ose të paktën në krahasim me ndjekjen e krimeve të nazizmit¹⁷². Ajo që duket e sigurt është se prokuroria nuk i përmbushi pritshmëritë dhe veçanërisht ato të viktimitave dhe kundërshtarëve të regjimit. “Ne kërkuam drejtësi dhe morëm sundimin e ligjit”¹⁷³, u shpreh me zhgënjim aktivisti i të drejtave civile Bärbel Bohley. Më shumë do të mund të realizohej përmes një agjencie qendrore të hetimit apo kapaciteteve të zgjeruara të personelit. Mbi të gjitha, përpjekjet e gjyqësorit për të ndëshkuar krimin

¹⁶⁷ Wassermann, Rudolf. 1995. ‘Sind politische Verbrechen justitiabel? Möglichkeiten und Grenzen des Strafrechts.’ në: Weber, Jürgen dhe Piazolo, Michael (Ed). Eine Diktatur vor Gericht. Aufarbeitung von SED-Unrecht durch die Justiz. München: Olzog-Verlag, faqe. 30 - Vergau, Jutta. 2000. Die Aufarbeitung von Vergangenheit vor und nach 1989. Eine Analyse des Umgangs mit den historischen Hypothesen totalitärer Diktaturen in Deutschland. Marburg: Tectum Verlag, faqe 156-158. Në total u zhvilluan 244 gjykime ndaj 466 të pandehurve për akte të dhunshme në kufi. 275 të pandehur u dënuan. Marxen, Werle & Schäfer, ‘Strafverfolgung,’ faqe 28, 32, 41.

¹⁶⁸ Ibid. faqe 41-43, 48.

¹⁶⁹ Schroeder, Friedrich-Christian. 1995. ‘Die strafrechtliche Verfolgung von Unrechtstaten des SED-Regimes.’ në: Brunner, Georg (Ed.) Juristische Bewältigung des kommunistischen Unrechts in Osteuropa und Deutschland, faqe 213-215. Berlin: Arno Spitz Verlag; Knabe, Hubertus. 2007. Die Täter sind unter uns: Über das Schönreden der SED-Diktatur. Berlin: Propyläen, faqe 100ff, Schaefer, Vergangenheitsbewältigung, faqe 16-19.

¹⁷⁰ Marxen, Werle dhe Schäfer, ‘Strafverfolgung,’ faqe; Eppelmann, Rainer. 2007. ‘Zum Geleit.’ në: Marxen, Klaus et. al. Die Strafverfolgung von DDR-Unrecht. Fakten und Zahlen, faqe 3-4. Berlin: Stiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur. Gjatë ndjekjes penale të krimeve të tjera pa lidhje me RDGJ 30 për qind e hetimeve u pasuan me vendime. Shih. Knabe, ‘Täter,’ faqe 102 ff.

¹⁷¹ Për një vlerësim tepër kritik, Knabe, ‘Täter,’ faqe 79-200.

¹⁷² P.sh. Roggemann, ‘Aufarbeitung,’ faqe 229 ff.

¹⁷³ Bohley, Bärbel. 2010. ‘Zitate.’ Përkthyer nga gjermanishtja.

shtetëror ishin të kufizuara për shkak të ndalimit të prapaveprimit të ligjit. Fakti se padrejtësitë (morale) të dukshme (nuk) u dënuan mjaftueshëm, ishte e vështirë për t'u kuptuar nga njerëzit e zakonshëm.

Krahasuar me ndjekjen penale të krimeve naziste, autoritetet trajtuan parashkrimin në mënyrë më të arsyeshme, u përmbajtën nga dhënia e amnistive, iniciuan hetimet sistematike më herët, dënuan krimin gjyqësor të paktën pjesërisht, dënuan të ashtuquajturit Schreibtschtäter ("kriminelë zyre")¹⁷⁴ në mënyrën më të përshtatshme dhe morën parasysh çdo mundësi sado të kufizuar, duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare dhe formulës Radbruch për të ndëshkuar të paktën krimet më të rënda dhe për të t'i klasifikuar ato ligjërisht si padrejtësi.¹⁷⁵ Megjithatë, këto arritje nuk arritën të balancojnë çdo zhgënjim.

c) Lustracioni: "Destasifikimi" i Shërbimit Civil

Transformimet politike të personelit nuk filluan me ribashkimin e dy shteteve gjermane. Hapa të rëndësishëm ishin marrë tashmë. Në rrjedhën e ngjarjeve "revolucionare", duke filluar që nga vjeshta e vitit 1989 me rënien e regjimit të SED dhe fillimin e demokrazizimit të RDGJ-së, shumë zyrtarë të regjimit të mëparshëm u mënjanuan nga pozicionet qendrore sociale dhe nga ato ku SED kishte humbur ndikimin e tij politik për shkak të përjashtimeve, tërheqjeve dhe dorëheqjeve;¹⁷⁶ shpërbërjes së strukturave të partisë dhe të shtetit;¹⁷⁷ dhe tranzicionit të pushtetit politik tek autoritetet demokratike.

Ribashkimi nisi një fazë të re të lustrimit. Në përgjigje të dëshirës së përhapur gjerësisht për pastrimin e institucioneve dhe «destasifikimin» e tyre si dhe nevojës për një përshtatje strukturore dhe politike të aderimit (Beitrittsgebiet), të dy qeveritë përcaktuan kushtet për rishqyrtimin e shërbimit civil në Traktatin e Bashkimit. Në parim, të gjithë punonjësit e shërbimit civil duhet vazhdonin punë në strukturat publike në mënyrë që të sigurohej funksionimi i tyre. Megjithatë, njerëzit e komprometuar politikisht duhet të largoheshin përmes mjeteve ligjore të përcaktuara në kodin e punës (përmes një lloji "përzgjedhjeje negative"). Traktati parashikonte mjete për shkarkimin e jashtëzakonshëm, kur punonjësi shkelte «parimet e humanizmit ose të sundimit të ligjit»¹⁷⁸ apo ka punuar për strukturat e MfS-së dhe për këtë arsye "një vazhdim i kontratës së punës bëhet i [pa] papranueshëm».¹⁷⁹ Mbi këtë bazë, një rishikim i gjerë i nëpunësve civil filloi pas ribashkimit. Personat e prekur duhej të plotësonin pyetësorë dhe të jepnin informacion mbi aktivitetet e mundshme si bashkëpunëtorë të MfS-së, anëtarësimin dhe funksionet në SED ose organizatave të lidhura me të.

Përveç kësaj, Komisionerit Federal për Dosjet e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit (BStU; Behörde des Bundesbeauftragten für die Unterlagen des Staatssicherheitsdienstes der ehemaligen Deutschen Demokratischen Republik)¹⁸⁰ iu kërkua të hetonte dhe mblidhte

¹⁷⁴ Termi Schreibtschtäteru referohet njerëzve në sfond të cilët thurin plane, organizojnë, dhe japin urdhra për të kryer krime.

¹⁷⁵ Për shkak të avancimit të konsiderueshëm të së drejtës ndërkombëtare mes 1945 dhe 1990, një sistem i mbrojtjes së të drejtave të njeriut (të cilit RDGJ-ja iu nënshtrua) ishte i pranishëm për hetimin dhe ndëshkimin e krimeve të rënda të SED. Diçka e ngjashme nuk kishte ndodhur në rastin e hetimit dhe ndëshkimit të krimeve të Nazizmit.

¹⁷⁶ Numri i anëtarëve të partisë kishte rënë nga 2.3 milion në 1.8 milion në dhjetor 1989, dhe më në fund në 350,000 deri në gusht të vitit 1990. Për zëvendësimin e njëpasnjëshëm në nivelet e sipërme drejtuese, shih Derlien, Hans-Ulrich. 1997. 'Elitenzirkulation zwischen Implosion und Integration. Abgang, Rekrutierung und Zusammensetzung ostdeutscher Funktionsebenen 1989-1994.' në: Wollmann, Hellmut et. al. (Ed) Transformation der politisch-administrativen Strukturen in Ostdeutschland. faqe 329-416. Opladen: Leske und Budrich.

¹⁷⁷ Të tilla si Këshilli Kombëtar të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave, Këshilli i Shtetit, Byrosë Politike, Komitetit Qendror dhe Ministrisë së Sigurimit të Shtetit.

¹⁷⁸ Këto përfshinin shkeljet e të drejtave të njeriut dhënë nga ICCPR ose emëruar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

¹⁷⁹ Fakti se protestuesit kishin arritur kryesisht të siguronin dosjet e MFS duke okupuar zyrat e saj ishte një parakusht vendimtar për rishikimet.

¹⁸⁰ BStU është përgjegjës për administrimin dhe hulumtimin e të dhënave të MFS.



informacion për aktivitetet e individëve në lidhje me MfS. Deri më 1997, 1.42 milion he-time ishin zhvilluar nga BStU. Në 6.3 për qind të krejt shqyrtimeve u zbuluan aktivitete zyrtare ose jozyrtare të lidhura me MfS-në.

Kjo nuk çonte automatikisht në shkarkim. Personat e identifikuar si të kompromentuar iu dha mundësia e një seancë dëgjimore nga ana e punëdhënësit dhe secili rast u shqyrtohej në mënyrë individuale. Sipas vlerësimeve të përafërta deri në vitin 1997, u kryen 42.000 shkarkime për shkak të bashkëpunimit me MfS-në, që përbën rreth gjysmën e të gjithë anëtarëve të identifikuar të MfS-së.¹⁸¹

Mënyra se si rishikimet e personelit dhe shkarkimet u trajtuan ndryshoi nga shteti në shtet dhe pjesërisht nga njëri qark në tjetrin, gjë që lidhet me llojin dhe madhësinë e pyetësorit, por edhe me kriteret e shkarkimit dhe rrethin e njerëzve të prekur. Kjo situatë mund t'i atribuohet në radhë të parë faktit se as kriteri i «bashkëpunimit me MfS-në» dhe as epiteti «të papranueshme» nuk u përcaktuan qartë në Traktatin e Bashkimit.¹⁸² Ndërsa, për shembull, në Saksoni ose Berlin-Weissensee mbizotëronte mendimi që edhe kopshtarët, sekretarët, infermierët dhe pastruesit e lidhur me MfS duhet të shkar-koheshin, të njëjtat grupe të punësuarish u mbajtën në punë Brandenburg pa ndonjë shqyrtim personal.¹⁸³ Megjithatë, ngjashmëri ekzistonin. Punonjësit e shërbimit policor apo sistemit arsimor si dhe degët që kishin luajtur një rol udhëheqës në regjimin e SED u prekën relativisht fuqishëm kudo.¹⁸⁴

Megjithatë, ndryshimet më thelbësore në shërbimin civil nuk erdhën nga shkarkimet e jashtëzakonshme.¹⁸⁵ Në më të shumtën e rasteve ato shoqëruan shpërbërjen e institucioneve të shumta të RDGJ-së dhe përshtatjen e aparatit të tejfryrë të shtetit dhe makinerisë administrative¹⁸⁶ të strukturave të Gjermanisë Perëndimore në rrjedhën e procesit të bashkimit. Sërish Traktati Bashkimit përbënte bazën ligjore duke qenë se aty parashikoheshin shkarkimet e zakonshme në rastet e:

- kualifikimit të mangët profesional
- aftësive të pamjaftueshme personale dhe
- mungesës së kërkesave për personelit për shkak të ndryshimeve strukturore (shpërbërjes apo ndryshimeve të vendit të punës).¹⁸⁷

600,000 persona u prekën vetëm nga shpërbërja e institucioneve RDGJ-së¹⁸⁸. Për më tepër, shkurtime masive u kryen në sistemin arsimor me përafrimin e standardeve drejt

¹⁸¹ Glatte, 'German Past,' faqe 19 ff.; Wielenga, 'Geschichte,' faqe 87-89; Vergau, 'Aufarbeitung,' faqe 127 ff. Pak para shpërbërjes së saj, MfS kishte 94,000 zyrtare dhe 174,000 anëtarë të mëtejshme jozyrtare. Mothes, Jörn dhe Schmidt, Jochen. 2000. 'Die Aufarbeitung der DDR-Vergangenheit. Versuch einer Zwischenbilanz.' *Der Bürger im Staat* 4:192-196.

¹⁸² Will, Rosemarie. 1997. 'Das Bundesverfassungsgericht und der Elitenwechsel in Ostdeutschland.' *Neue Justiz* 10:513-517; Majer, Diemut. 1996. 'Entnazifizierung gleich Entstasifizierung?' *Vergangenheitsbewältigung und Rechtsstaat.* në: Haney, Gerhard et. al. (Ed) *Recht und Ideologie. Festschrift für Hermann Klenner zum 70. Geburtstag*, faqe 349-384. Freiburg: Rudolf Haufe Verlag.

¹⁸³ Trajtimi i "lirshëm" i rishikimeve në Brandenburg, i cili është treguar edhe ndaj grupeve të tjera profesionale, të lejuara, për shembull, juristët dhe policët udhëheqës i cili kishte punuar për MfS për të mbajtur pozitën e tyre gjatë pas 2010. Kjo filloi të ndryshojë vetëm me krijimin e një komisioni hetimor në Brandenburg në vitin 2010.

¹⁸⁴ Wielenga, 'Geschichte,' faqe 87-91; Vergau, 'Aufarbeitung,' faqe 129; Weichert, Thilo. 1991. 'Überprüfung der öffentlich Bediensteten in Ostdeutschland,' *Kritische Justiz* 4: 457-475; McAdams, James A. 2001. *Judging the Past in Unified Germany*. Cambridge: Cambridge University Press, faqe 75 ff.

¹⁸⁵ Vollnhals, Clemens. 1995. 'Abrechnung mit der Diktatur. Politische Säuberung nach 1945 und 1989.' *Deutschland Archiv* 28:68-71; Wielenga, 'Geschichte,' faqe. 89.

¹⁸⁶ Shërbimi civil i RDGJ numëronte 2 milionë të punësuar, në një popullatë prej 16 milionë (nga të cilat 9 milion fuqi punëtore). Matur kundrejt popullatës, shërbimi civil përbënte rreth 14 për qind, që ishte dy herë më i lartë në krahasim me RFGJ-së ku shërbimi civil ishte në nivelin 7 për qind. Keller, Berndt dhe Henneberger, Fred. 1992. 'Beschäftigung und Arbeitsbeziehung im öffentlichen Dienst der neuen Bundesländer.' *Gewerkschaftliche Monatshefte* 6:331-342.

¹⁸⁷ Bundeszentrale für politische Bildung, Einigungsvertrag Annex I Kap XIX Sachgebiet A Paragraph III Nr. 1 passage 4.

¹⁸⁸ Loschelder, Wolfgang. 1995. 'Die Weiterbeschäftigung von Funktionsträgern des SED-Regimes im öffentlichen Dienst.' në: Brunner, Georg (Ed.) *Juristische Bewältigung des kommunistischen Unrechts in Osteuropa und Deutschland*, faqe 203-213. Berlin: Arno Spitz Verlag.



atyre të Gjermanisë Perëndimore në lidhje me raportin nxënës - mësues¹⁸⁹ si dhe heqjen e subjekteve të tilla nga mësimdhënia si shkencat civile dhe ushtarake. Përveç kësaj, pushime nga puna pati edhe për shkak të «kualifikimit të pamjaftueshëm profesional» si në rastin e mësuesve që kishin mbuluar mësimdhënien e lëndëve me subjekte ideologjike. Shkarkimet nga shërbimi diplomatik dhe Ushtria Popullore Kombëtare ishin edhe më drastike. Vetëm katërmbëdhjetë nga 1700 ish diplomatë dhe vetëm 6,000 nga ish 40.000 oficerë të ushtrisë u mbajtën në punë.¹⁹⁰ Jo të gjitha këto largime kishin të bënin me të kaluarën e personit të prekur. Megjithatë, mund të supozohet se në rastet e shkurtimeve përfshirja personale në regjimin e SED ishte një faktor në përzgjedhjen e kush duhej të shkarkohej.¹⁹¹

Aspektet politike luajtën një rol edhe më të madh kur erdhi puna tek largimet e zakonshme për shkak të “aftësisë së pamjaftueshme personale”. Besnikëria ndaj kushtetutës ishte një parakusht për dhënien e statusit të nëpunësit civil. Kjo besnikëri shihej si e diskutueshme në rastin e aplikantëve, përfshirja e të cilëve në organizatat qendrore të SED, i identifikonte ata veçanërisht me regjimin e kaluar. Prandaj, personave të komprometuar mund të thuhet se u mungonte zotësia personale dhe punësimi i tyre mund të ndërpritej.

Në fakt Traktati i Bashkimit nuk përcaktonte se cila nga organizatat e lidhura me SED konsiderohej si komprometuese, përveç bashkëpunimit me strukturat e MfS-së dhe shkëlja e parimeve të humanizmit dhe të sundimit të ligjit, si arsye për shkarkime të jashtëzakonshme. Kjo doli të jetë mjaft problematike. Diskrecioni i gjerë çoi në dallime të mëdha në trajtimin e largimeve. Trajtimi i pabarabartë gjeti shprehjen e vet në faktin se disa shtete bënë dallime rast-pas-rasti ndërkohë që disa të tjera si për shembull Saksonia, larguan nga shërbimi civil të gjithë ish mbajtësit e pozitave dhe profesioneve të caktuara në regjimin e SED. Pasiguria ligjore rriti numrin e ankimeve gjyqësore një pjesë e të cilave mbërriti deri në Gjykatën Kushtetuese Federale.¹⁹²

Gjyqësori përbënte një rast të veçantë të lustrimit. Ai tërhoqi vëmendje të veçantë për shkak të përfshirjes së tij të konsiderueshme në regjimin e SED. Prokurorët dhe gjyqtarët duhej t'i nënshtroheshin një vlerësimi të veçantë individual, i cili vendoste punësimin e tyre në vazhdimësi. Komitetet e përzgjedhjes dhe emërimit kishin përdetyrë të bënin vlerësime në lidhje me aftësinë dhe mundësinë që personi do të vepronte sipas vlerave të RFGJ-së dhe rendit ligjor. Aktiviteti i mëparshëm në SED apo MfS nuk konsiderohej automatikisht komprometues. Praktikantët e mëparshëm ligjore që kishin qenë çnjerëzore ose në kundërshtim me sundimin e ligjit u panë me më shumë skepticizëm.

Megjithatë, kriteret e vlerësimit ishin të ndryshme nga shteti në shtet dhe çuan në kuota të ndryshme të vazhdimësisë së punësimit. Ndërsa në Berlin vetëm disa aplikantët u pranuan sërish në shërbimin civil, pothuajse gjysma e të gjithë aplikantëve të shqyrtuar morën rezultate pozitive në të gjithë ish-territorin e RDGJ-së që aderoi në Gjermaninë e bashkuar (Beitrittsgebiet). Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e gjyqësorit të RDGJ-së kishte hequr dorë nga kërkimi për shqyrtim të përshtatshmërisë

¹⁸⁹ Wielenga, 'Geschichte,' faqe 89; Vollnhals, 'Abrechnung,' faqe 69.

¹⁹⁰ Eckert, Rainer. 1997. "Entnazifizierung" und "Entkommunisierung". Aufarbeitung der Vergangenheit in Deutschland. në: Jesse, Eckhardt dhe Kailitz, Steffen (Ed) Prägekräfte des 20. Jahrhunderts: Demokratie, Extremismus, Totalitarismus, faqe 305-327. Baden-Baden: Nomos Verlagsgesellschaft; Deutscher Bundestag. 1998. 'Schlussbericht der Enquete-Kommission, Überwindung der Folgen der SED-Diktatur im Prozeß der deutschen Einheit.' <http://dip21.bundestag.de/dip21/btd/13/110/1311000.pdf>, faqe. 36 (shkurtuar në vijim si Schlussbericht, 'Enquete-Kommission'); Weichert, 'Überprüfung,' faqe 463. Sipas informacioneve nga Ministria e Jashtme, vetëm 4 diplomatë karriere u mbajtën në punë.

¹⁹¹ Wielenga, 'Geschichte,' faqe 89.

¹⁹² Will, 'Bundesverfassungsgericht'; Loschelder, 'Weiterbeschäftigung,' faqe 197-203; Majer, 'Entnazifizierung,' faqe 361-364. Gjykata Federale Kushtetuese vendosi se anëtarësimi në organizatat e SED ose të ngjashme me të nuk mund të konsiderohej në përgjithësi si një mangësi e aftësive personale. Çdo person duhej të shqyrtohej individualisht dhe sjellja personale pas ribashkimit duhej të merrej parasysh.



për të qëndruar në pozicionet e mëparshme, kështu që vetëm rreth një e treta ose më saktësisht 1.080 nga 3.018 ish gjyqtarët dhe prokurorët e RDGJ-së (në fund të vitit 1989), u mbajtën në punë.¹⁹³

Lustracioni nuk u zhvillua pa probleme. Së pari, vendosja e theksit tek ish anëtarët dhe bashkëpunëtorët e MfS-së dhe së dyti, mungesa e kriterëve uniforme për konsiderimin e personave si të kompromentuar dhe për rekomandimin e tyre për shkarkim¹⁹⁴ ishin mjaft problematike. Tendanca për të atribuuar përgjegjësinë e regjimit kryesisht shërbimit të fshehtë të “Stasi-t” dhe lënies jashtë konsideratës së më shumë se 330 mijë anëtarëve të “nomenklaturës” gjeti shprehje edhe në Traktatin e Bashkimit. Vetë autoritetet përgjegjëse për proceset rishqyrtuese nuk kishin njohuritë e nevojshme për të kuptuar dhe vlerësuar rëndësinë e funksioneve të caktuara dhe institucionet e regjimit të SED.¹⁹⁵ Fakti që nuk pati kriterë të përcaktuara saktë në traktat për largimet nga puna, përveç bashkëpunimit me MfS-në, mundësoi vazhdimësinë e shumë ish anëtarëve të SED apo personave të kompromentuar rëndë në shërbimin civil pas vitit 1990.

Kjo do të thoshte se nuk ishin ata që kishin në dorë pushtetin shtetëror por “xhelatët” e tyre në radhët e shërbimit sekret që u vendosën para përgjegjësisë. Kjo mund të korrigjohet vetëm pjesërisht më pas, duke qenë se dispozitat e traktatit lidhur me shkarkimet e zakonshme ishin të vlefshme vetëm deri në fund të vitit 1993. Ende nuk është studiuar mjaftueshëm se sa ish-zyrtarë qendrore mbetën në shërbimin civil dhe se si rrjetet e vjetra vazhduan të kenë efekt.¹⁹⁶ Supozohet se vazhdimësia e personelit ekzistoi në nivelet të ulëta dhe të mesme si dhe se një pjesë e nomenklaturës gjeti mundësi për tu futur në ekonomi, ku nuk u zhvillua ndonjë rishikim.¹⁹⁷ Megjithatë, mbizotëron mendimi se përkundër të gjitha gabimeve, masat e marra çuan në një zëvendësim të konsiderueshëm të personave të kompromentuar me persona të pa kompromentuar, veçanërisht në pozicione drejtuese. Për këtë arsye, spastrimi përmes lustracionit duket më i suksesshëm se denazifikimi (në Zonat Perëndimore dhe RFGJ) i pas vitit 1945. Mjaft persona të pa kompromentuar, si nga Lindja dhe nga Perëndimi, ishin në dispozicion për të plotësuar vendet e lira të punës. Për këtë arsye, ndryshe nga pas vitit 1945, nuk ekzistonte ndonjë frike për kolapsin e strukturave administrative si pasojë e një spastrimi të plotë.¹⁹⁸

Për më tepër, ekzistonte një konsensus i fortë për nevojën e largimit të personave të kompromentuar, edhe pse ky konsensus filloi të dobësohet me kalimin e kohës. Ndjenja

¹⁹³ Wassermann, Rudolf. 1999. ‘Rechtssystem.’ në: Weidenfeld, Werner dhe Korte, Karl-Rudolf (Ed) Handbuch zur deutschen Einheit 1949-1989-1999, faqe 650-661. Frankfurt am Main: Campus Verlag; Staats, Johann-Friedrich. 2011. “Lustration” - oder die Überprüfung der Richter und Staatsanwälte aus der DDR.’ në: Bästlein, Klaus (Ed.) Die Einheit. Juristische Hintergründe und Probleme. Deutschland im Jahr 1990, faqe 85-104. Berlin: Berliner Landesbeauftragten für die Unterlagen des Staatssicherheitsdienstes der ehemaligen DDR; Weinke, Umgang, faqe 182. Ata të cilët e kaluan procesin e vlerësimit u mbajtën në provë. Gjatë periudhës së provës e cila zgjaste nga tre deri në pesë vjet, duhet të vlerësoheshin mangësitë në kualifikim, qëndrimi demokratik dhe praktika ligjore në përputhje me rregullat e sundimit të ligjit.

¹⁹⁴ Kjo ishte një nga dallimet më thelbësore mes denazifikimit në zonën amerikane të pushtimit pas 1945, ku u hartuan dhe shpërndanë lista të detajuara me kriteret për shkarkim. (Kapitulli 2 c i). Cit. Majer, ‘Entnazifizierung.’

¹⁹⁵ Kjo u përkeqësua nga dosjet e anëtarësimit në SED të cilat u asgjësuan në Nëntor 1989. Kjo do ta kishte bërë rishikimin më të lehtë.

¹⁹⁶ Landesbeauftragter für die Unterlagen des Staatssicherheitsdienstes der ehemaligen DDR. 1995. ‘Zweiter Tätigkeitsbericht.’ <http://www.berlin.de/imperia/md/content/lstu/taetigkeitsberichte/jb95.pdf?start&ts=1441800999&file=jb95.pdf>; Deutscher Bundestag. 1994. Bericht der Enquete-Kommission, ‘Aufarbeitung von Geschichte und Folgen der SED-Diktatur in Deutschland.’ <http://dipbt.bundestag.de/dip21/btd/12/078/1207820.pdf>, faqe. 214-218. Për paragrafët në vazhdim shih: Schlussbericht Enquete-Kommission, faqe 36-43. Rastet studimore të komisionit hetimor tregojnë se anëtarët e nomenklaturës mbanin pozita me përgjegjësi në nivel komuniteti. Megjithatë në total ata zinin një pjesë të vogël të shërbimit civil në shtetet e reja.

¹⁹⁷ Në gjithë sektorin privat, vetëm personat në poste drejtuese iu nënshtruan rishikimit përmes dosjeve të Stasit. Në rastin e punonjësve të zakonshëm, rishikimi i u krye vetëm përmes vetë-deklarimit. Bundesregierung. 2012. ‘Bericht der Bundesregierung zum Stand der Aufarbeitung der SED-Diktatur.’ https://www.bundesregierung.de/Content/DE/_Anlagen/BKM/2013-08-16-bericht-aufarbeitung-sed-diktatur.pdf?__blob=publicationFile&v=1, faqe. 55. Në ekonomi, privatizimet funksionuan si “mekanizëm automatik spastrimi” përmes të cilave funksionarët e lartë drejtues humbën pozicionet e tyre. Karstedt, ‘Vergangenheitsbewältigung,’ faqe 85, 88.

¹⁹⁸ Megjithatë, gjithashtu pas 1989/90, ishte e pamundur të anashkalohejshin të gjithë personat e kompromentuar dhe njohuritë e tyre. Ish oficerët e MfS ishin të nevojshëm në dorëzimin e pronësisë dhe vlerësimit të dosjeve të MfS. Weichert, ‘Überprüfung,’ faqe 458.

e trajtimit të padrejtë filloi të rritet nga shumë drejtime. Dallimet e mëdha midis masave të ndërmarra çoi në dyshime rreth besueshmërisë dhe drejtësisë së procesit të rishikimeve. Për shumë disidentë dhe viktime të regjimit të SED, pushimet nga puna nuk shkuan aq larg sa duhej. Përveç kësaj, shumë u zhgënjyën nga fakti se vendet e liruar nga përkrahësit e SED nuk u plotësuan automatikisht me kundërshtarë të regjimit të vjetër, por me konformistë të rinj apo persona të ardhur nga Gjermania Perëndimore.¹⁹⁹

d) Rehabilitimi dhe Rivendosja e së Drejtës

I. Ligje për Korrigjimin e Padrejtësive ndaj viktimave të regjimit

Gjatë dyzet viteve të ekzistencës së RDGJ –së, padrejtësia ndaj qytetarëve të vet nuk kishte qenë vetëm në masë të madhe, por edhe në forma të ndryshme. Ajo fillonte nga burgosja, dhuna fizike dhe vrasja, në shpronësimet e pronave, ndalimet profesionale dhe ngacmimet e anëtarëve të familjes, në terror psikologjik dhe represion përmes përgjimit, frikës dhe diskreditimit publik. Çdo lloj sjelljeje e supozuar apo aktuale, rezistence ose thjesht jo-konformizmi ishte e kriminalizuar dhe shkak për persekutim. Persekutimi kryhej si në nivel gjyqësor me anë të përdorimit të Kodit Penal Politik ashtu edhe jashtë sistemit gjyqësor. Sipas vlerësimeve, 200.000 deri në 250.000 persona ishin përndjekur dhe burgosur kryesisht vetëm me anë të Kodit Penal Politik.²⁰⁰ Kështu, rehabilitimi i viktimave²⁰¹ luajti një rol vendimtar në procesin e sqarimit të padrejtësive të sistemit politik të SED.

Dëshira për rehabilitim gjeti shprehje që gjeti në fazën e trazirave për përmbyshjen e regjimit. Në tetor 1989, të gjithë të burgosurve për «kalim të paligjshëm të kufirit», u dha amnisti dhe u liruan. Paralelisht me këtë, disa të dënuar u rehabilituan përmes apelimit të dënimeve. Në qershor të vitit 1991, Parlamenti Popullor i zgjedhur me votim të lirë filloi të hartojë një ligj për rehabilitimin i cili kishte të bënte jo vetëm me rehabilitimin e historisë penale, por edhe me rehabilitimin administrativ dhe profesional të viktimave të regjimit. Rehabilitimi synoi të krijojë parakushtet për të drejtën e kompensimit financiar. Megjithatë, para miratimit të ligjit, Traktati i Bashkimit hodhi themelet e unitetit të Gjermanisë. Përmes tij, RFGJ-ja merrte përsipër detyrimin për të rehabilituar dhe kompensuar ata që kishin qenë «viktime të ndjekjes penale për motive politike ose ndonjë vendimi tjetër gjyqësor në kundërshtim me sundimin e ligjit apo kushtetutës».²⁰²

Qeveria Federale nuk ishte e gatshme për të marrë përsipër ligjin e hartuar nga Parlamenti Popullor, nga frika e shpenzimeve të paparashikueshme. Ideja e rehabilitimit dhe dëmshpërblimit u përcaktua më pas dhe përfundimisht në të ashtuquajturin Statuti për Korrigjimin Padrejtësive të diktaturës së SED.²⁰³ Pjesë e tij ishte “Akti i Rehabilitimi Penal” i nëntorit 1992. Ky akt lejonte anulimin e vendimeve përfundimtare dhe vendimeve të tjera gjyqësore të Zonës Sovjetike dhe RDGJ-së për aq sa ato konsiderohen në kundërshtim me sundimin e ligjit. Për më tepër, ligji përcaktoi kushtet për të drejtat financiare për personat e rehabilituar.

Vendimet konsideroheshin në kundërshtim me sundimin e ligjit, nëse ato binin në kundërshtim me parimet bazë të një rendi të lirë demokratik. Përkatesisht, rehabilitimi

¹⁹⁹ Karstedt, ‘Vergangenheitsbewältigung,’ faqe 90-100; Vergau, ‘Aufarbeitung,’ faqe 130-132; Wielenga, ‘Schatten,’ faqe 1065-1068; ibid. ‘Geschichte,’ faqe 89-96; Majer, ‘Entnazifizierung,’ faqe 364-366.

²⁰⁰ Eser, Albin et. al. (Ed). 2001. Strafrecht in Reaktion auf Systemunrecht. Vergleichende Einblicke in Transitionsprozesse. Ein Projektbericht. Freiburg: Max-Planck-Institut, Mothes & Schmidt, Aufarbeitung, faqe 192. Në lidhje me numrin e viktimave, shih Borbe, ‘Zahl,’ faqe 15-20.

²⁰¹ Termi “rehabilitim” i referohet rikthimit të reputacionit dhe nderit të viktimave. Pas reunifikimit “rehabilitimi” u përdor si një ombrellë e disa proceseve siç ishin anulimi i vendimeve të padrejta dhe rehabilitimit material. Guckes, ‘Opferentschädigung,’ faqe 12 ff. E rëndësishme për paragrafët në vijim: Ibid., faqe 53-69; Eser dhe Arnold, ‘Strafrecht,’ faqe 433-499; Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 21.

²⁰² Përkthyer nga gjermanishtja në Eser dhe Arnold, ‘Strafrecht,’ faqe 438.

²⁰³ Para krijimit të këtyre parashikimeve ligjore uniforme mbarëkombëtare, një numër i madh rregulloresh dhe instrumentesh të veçanta u aplikuan. Shih, Guckes, ‘Opferentschädigung,’ faqe 53-63; Eser dhe Arnold, ‘Strafrecht,’ faqe 443-451.



ishte në mënyrë të veçantë në dispozicion të atyre personave që u persekutuan politikisht me anë të vendimeve penale,²⁰⁴ ose që kishin marrë dënime të rënda në disproporcion me veprën e kryer. Më tej, ligji u drejtohej atyre që ishin mbyllur në institucione psikiatrike ose në arrest shtëpiak për shkaqe të persekutimit politik ose qëllime të tjera të paligjshme. Personat e prekur mund të aplikojnë për rehabilitim në senatet dhe dhomat e autorizuar të rehabilitimit deri në fund të 2019. Personat e rehabilituar fitojnë të drejtën e kthimit apo dëmshpërblimit të pronës së shpronësuar dhe të rimbursimit të gjobave dhe shpenzimeve procedurale. Në disa raste, ata kanë të drejtë për përfitime sociale si kompensim për burgim, dëm shëndetësorë të zgjatur dhe humbje të pensionit.²⁰⁵

Dy ligje plotësuese pasuan në korrik 1994: “Akti i Rehabilitimit Administrativ” dhe “Akti i Rehabilitimit të Punës” që së bashku formojnë Statutin e dytë për Korrigjimin e Padrejtësive të SED. I pari trajton anulimin e «vendimeve administrative në kundërshtim me sundimin e ligjit nga ana e institucioneve të RDGJ-së apo deklarimin e mospërputhjes së tyre me sundimin e ligjit»²⁰⁶ nga 8 maj 1945 deri më 2 tetor 1990. Më saktësisht, ligji u drejtohet personave që kishin pësuar akte të arbitraritetit dhe padrejtësisë administrative, dhe të cilët në këtë mënyrë kishin pësuar dëmtime të shëndetit, humbje të pronës apo disavantazhe të tjera profesionale. Veprimet rregullatore mund të anulohen me kërkesë të të interesuarit në qoftë se ato janë të papajtueshme me parimet bazë të një rendi të lirë demokratik të bazuar në sundimin e ligjit²⁰⁷ dhe të personit të prekur që ende vuan pasoja të papranueshme prej tyre. Këto përfshijnë, për shembull, rastet e dëbimeve me forcë nga zonat pranë kufirit dhe shpronësimet, por edhe rastet e dëmtimit fizik për shkak të internimit në kampet e punës, abuzimit nga ana e policisë dhe reprezaljet e MfS-së. Personat e rehabilituar kanë të drejtë për përfitime sociale në rast se kanë pësuar dëme të qëndrueshme shëndetësore dhe për kompensim për pronën e shpronësuar dhe disavantazhet profesionale.²⁰⁸

BerRehaG ose “Akti i Rehabilitimit Profesional”, nga ana tjetër, dha përfitime për rehabilitimin social personave të cilët ende vuajnë pasojat e ndërhyrjes në karrierën e tyre profesionale. Kështu, për shembull, hyjnë personat e persekutuar politikisht të cilët nuk ishin lejuar të punonin në fushën ku ata kishin studiuar, praktikuar apo kishin nisur punë. Përfitimet përfshijnë dëmshpërblimin për disavantazhet në skemën e pensioneve, pagesat mujore për personat në kushte varfërie, si dhe përgatitje profesionale dhe rikualifikim.²⁰⁹ Ndërmjet viteve 1993 dhe 2011, qeveritë gjermane federale dhe shtetërore shpenzuan 1.4 miliardë euro për projektin e rehabilitimit.²¹⁰

Statutet për Korrigjimin e Padrejtësive të SED morën kritika të forta nga viktimat e regjimit. Kryesisht, u sugjerua se përfitimet kompensuese ishin shumë prapa atyre që u dhanë për viktimat e NS-it. Shumë u ndjenë të trajtuar padrejtësisht, si viktimat të klasit të dytë. Çështje e vërteta, ka disa dallime të cilat fillojnë që me termat e përdorur. Ndërsa në rastin e viktimave të NS-it, u përdor termi *Entschädigung* (shlyerje) i cili kupton korrigjimin e plotë apo ndreqjen e padrejtësisë, termi i përdorur në rastin

²⁰⁴ SI p.sh. Konventa “kundër trafikimit të qenieve njerëzore” për ndihmën ndaj një personi të arratisur, “nxitja e armiqësisë ndaj shtetit” për lirinë e fjalës, “kontakte ilegale” për kontaktet me persona jashtë vendeve socialiste, dhe “kalim i paligjshëm i kufirit” për ata që tentuan të largoheshin nga RDGJ. Shih, Akti i Rehabilitimit Penal § 1.

²⁰⁵ Shih gjithashtu Aktin e Rehabilitimit Penal; Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur. 2016. ‘Strafrechtliche Rehabilitierung,’ <http://www.bundesstiftung-aufarbeitung.de/strafrechtliche-rehabilitierung-1475.html>.

²⁰⁶ Përkthyer nga gjermanishtja, Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 21.

²⁰⁷ Këto përmbanin akte të cilat dhunonin parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike. Këto akte u karakterizoheshin nga arbitrariteti dhe persekutimi me motive politike.

²⁰⁸ Shih gjithashtu Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur. 2016. ‘Verwaltungsrechtliche Rehabilitierung,’ <http://www.bundesstiftung-aufarbeitung.de/verwaltungsrechtliche-rehabilitierung-1479.html>.

²⁰⁹ Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur. 2016. ‘Berufliche Rehabilitierung,’ <http://www.bundesstiftung-aufarbeitung.de/berufliche-rehabilitierung-1477.html>.

²¹⁰ Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 28. Fakte dhe shifra mbi rehabilitimin mund të gjenden në faqen e Fondacionit Federal për Rishikimin e Diktaturës së SED.

e viktimave të diktaturës së SED është Ausgleich i cili do të thotë barazimin ose balancimin nga disavantazhet. Për këtë arsye edhe pagesat ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në vlerën e tyre. Në ndryshim nga rasti i viktimave të NS-it, Statutet për Korrigjimin e Padrejtësive të SED nuk kishin për qëllim të dëmshpërblejnë të gjithë padrejtësitë e vuajtura dhe nuk vlerësohen sipas dëmit të pësuar. Përfitimet janë të kufizuara vetëm në format më të rënda të padrejtësisë, dhe synojnë lehtësimin e dëmeve të qëndrueshme dhe janë të detyruar pjesërisht të kompensojnë për varfërinë apo disavantazhet ekonomike.

Nëse ky trajtim i pabarabartë është moralisht legjitim duke pasur parasysh dallimet në llojin dhe masën e padrejtësisë së kryer nga të dy diktaturat, është objekt debatesh të nxehta.²¹¹ Sipas qeverisë gjermane, “padrejtësitë e 40 viteve të sistemit të RDGJ-së nuk mund të zhbëhen”,²¹² duke qenë se veprimet arbitrare dhe persekutimi politik nga shteti ka ndodhur në të gjitha sferat e shoqërisë, një rishikim i plotë do të ishte i pamundur. Nga pikëpamja ligjore, rregulloret janë legjitime. Me bashkimin e Gjermanive, RDGJ-ja pushoi së ekzistuari. Së bashku me të pushuan së vepruari të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me të. Ato u morën përsipër nga RFGJ-ja vetëm për aq sa thuhet shprehimisht në Traktatin e Bashkimit. RFGJ-ja ishte e detyruar vetëm të gjente një «zgjidhje të duhur për dëmshpërblim» dhe ky detyrim ishte relativisht i hapur për interpretime të mëtejshme.²¹³

Megjithatë, kritikak e forta e nxitën qeverinë të bëjë disa përmirësime. Periudhat e aplikimit u zgjatën disa herë dhe përfitimet u rritën e u përmirësuan. Viktimat që nuk kishin pësuar dëme afatgjata për shëndetin e tyre për shembull, iu dha mundësia për një rehabilitim moral. Një rritje e veçantë e pensioneve të viktimave hyri në fuqi në gusht të vitit 2007 që njihet edhe si Statuti i Tretë për Korrigjimin e Padrejtësive të SED.²¹⁴ Për më tepër, në korrik 2012 u ngrit fondi i “Edukimit Rezidencial në RDGJ në mes të viteve 1945 dhe 1990”.²¹⁵ Përkundër të gjitha kritikave, masat patën rëndësi të madhe psikologjike për shumë viktimat dhe përbëjnë një njohje zyrtare dhe publike të statusit si dhe një njohje zyrtare të vuajtjeve të tyre.²¹⁶

II. Zgjidhja e Çështjes së Pronës përmes Kthimit dhe Kompensimit

Korrigjimi i çështjes së pronës ishte një proces edhe më i vështirë se sa rehabilitimi.²¹⁷ Lista e viktimave ishte e gjatë. Mijëra qytetarë të RDGJ-së ishin prekur nga shpronësimi në periudhën e transformimit socialist të pronës nëpërmjet shtetëzimit. Mijëra të tjerë u shpronësuan si pasojë e persekutimit politik. Pronat e atyre që arratiseshin apo largoheshin nga vendi²¹⁸ si dhe atyre që nuk u kthyen pas 8 majit të 1945 në territorin që më pas u bë pjesë e RDGJ-së, bëheshin objekt i administrimit dhe shitjes së detyrueshme. Për më tepër, viktimave të Nacional-Socializmit asnjëherë nuk iu kthyen pronat e tyre, në të kundërt pjesa më e madhe e tyre u shtetëzuan.²¹⁹

²¹¹ Për krahasime të mëtejshme, shih Guckes, ‘Opferentschädigung’ dhe vështrim kritik Knabe, ‘Täter,’ faqe 201-239.

²¹² Përkthyer nga gjermanishtja, Guckes, ‘Opferentschädigung,’ faqe 66.

²¹³ Cit. ibid. faqe 20-24, 64-67; Eser dhe Arnold, ‘Strafrecht,’ faqe 438-443.

²¹⁴ Ky lloj pensioni iu akordua personave të burgosur më shumë se 180 ditë dhe në nevojë për mbështetje financiare. Sot ky pension kap shumën 300 euro në muaj.

²¹⁵ Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 27-29; Knabe, ‘Täter,’ faqe 232-239. Një shume prej 40 milionë euro u akordua për rehabilitimin e personave të vendosur në shtëpitë e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve në Zonën Sovjetike të pushtimit apo RDGJ dhe që kishin vuajtur aty padrejtësi të ndryshme. Vlerësimet e përafërta flasin për 500,000 persona të prekur; 140,000 prej të cilëve ishin vendosur në të ashtuquajturat shtëpi speciale apo shtëpi transit.

²¹⁶ Schuller, Wolfgang. 2006. ‘Ziele und Prioritäten der strafrechtlichen Vergangenheitsbewältigung.’ Der Bürger im Staat 3:161-165.

²¹⁷ E rëndësishme për kapitullin në vijim. Fieberg, Gerhard dhe Reichenbach, Harald. 1995. ‘Zu den Eckwerten der offenen Vermögensfragen.’ në: Weber, Jürgen dhe Piazolo, Michael (Ed) Eine Diktatur vor Gericht. Aufarbeitung von SED-Unrecht durch die Justiz, faqe 201-214. München: Olzog-Verlag.

²¹⁸ Rreth 3.5 milionë u larguan nga RDGJ pas 1949, shumica prej tyre para fillimit të ndërtimit të Murit të Berlinit në 1961. Për të pasur mundësi që të pajiseshin me një vizë dalje, aplikuesit ishin të detyruar të shisnin pronat e tyre shtetit apo palëve të treta.

²¹⁹ Knabe, ‘Täter,’ faqe 239-241; Borbe, ‘Zahl,’ faqe 51-54.



Një rikthim i të gjitha ndryshimeve që ishin bërë me pronat nuk mund të realizohej pasi kjo nënkuptonte një tjetër transformim tërësor të pronësisë i cili do të kishte pasojë të paparashikueshme ekonomike, administrative dhe financiare për Beitrittsgebiet dhe tërë RFGJ-në. Prandaj duhej të vendosej cili shpronësim duhej të kthehej, dhe cili jo. Qeveritë e RDGJ-së dhe RFGJ-së ranë dakord që pronat e “revolucioneve socialiste, të urdhrave ekonomike me marrëdhëniet e pronës”²²⁰ të mos ktheheshin por të ndryshoheshin vetëm masat e marra për shkak “të diskriminimit për shkaqe politike ose lloje të tjera”.²²¹ Edhe pse shpronësimet nga forcat pushtuese sovjetike mund të konsideroheshin si diskriminuese, ato mbeteshin në fuqi për sa kohë që ato konsideroheshin se ishin bërë “në bazë të ligjit ose autoritetit të pushtimit”.²²²

Veçanërisht problematik ishte fakti se ndërkohë shumë pasuri të shpronësuar kishin kaluar tek të tjerë posedues, qytetarë të RDGJ-së. Prandaj, kthimi duhej të organizohej në mënyrë të tillë që edhe të drejtat e pronarëve të rinj të mos cenoheshin. Mendimet dhe nevojat e ish-pronarëve ishin krejtësisht të kundërta. Nga njëra anë ishin ish-pronarët nga Gjermania Perëndimore që ishin kryesisht të arratisur apo larguar nga RDGJ-ja dhe të ashtuquajtur të pakthyeshëm, të tjerë qytetarë të RDGJ-së që ishin shpronësuar në mënyrë të padrejtë, si edhe viktimat e NS-it dhe nga ana tjetër ishin ata qytetarë të RDGJ-së që e kishin përfituar të drejtën për të marrë pronë nga shteti. Të parët shpresonin për kthim të pronave të tyre dhe i konsideronin të padenja të drejtat e pronarëve të rinj, pasi ata kishin qenë në dijeni që po blinin një pronë të shpronësuar. Pronarët e rinj nga ana tjetër, u trembën se mos humbnin mjetet e tyre të ekzistencës dhe mjedisin e tyre jetësor. Sipas tyre, ish pronarët i kishin lënë pronat e tyre vullnetarisht për një “jetë të artë në Perëndim”. Fakti që prona e tyre ishte bërë tashmë një objekt negocimi shkaktoi ndjenjën e të qenit “në anën e humbësve gjatë procesit të bashkimit”.²²³ Çështja e hapur e pronës u kthye në një barrë për të gjithë procesin e bashkimit të Gjermanive.

Një nga parimet kryesore të përcaktuara për të zgjidhur çështjet e pronës,²²⁴ ishte ai i “kthimit para kompensimit”. Kështu, pikëpamja e mbrojtur më së shumti nga gjermano-perëndimorët, mbizotëroi në dëm të kompensimit financiar të kërkuar nga gjermano-lindorët. Kjo për faktin se një numër i madh i të ikurve, si “grupi më i prekur nga çështja e hapur e pronave”²²⁵ nuk ishte shpronësuar zyrtarisht, por privuar posedimi apo nga kontrolli administrativ i pronës së tyre. Në aspektin ligjor, ata ishin ende pronarë, kështu që Republika Federale Gjermane, do të duhej ose t’i shpronësonte refugjatët (të larguarit), ose t’i përjashtonte ata nga dëmshpërblimi. Kjo e fundit do të ishte joligjore dhe si e tillë nuk u morr në konsideratë.

Megjithatë, për të gjetur një kompromis të pranueshëm social u bënë disa përjashtime nga parimi “kthim përpara kompensimit”. Kompensimi u realizua i pari kur rikthimi ishte “i pamundur për arsyeje ligjore ose faktike”.²²⁶ I tillë ishte, për shembull, rasti kur pronarët e rinj kishin fituar të drejta të pronësisë ose përdorimit në përputhje me ligjet e RDGJ-se.²²⁷ Dijenia mbi faktin se prona ishte më parë e shpronësuar nuk kishte rëndësi. Kështu vazhdimësisë iu dha prioritet mbi interesat e kthimit të pronave. Në disa raste përjashtimore kthimi u konsiderua i pamundur. Këto raste përfshijnë pjesë të tokës ose

²²⁰ Përveç kur prona ishte marrë nga shteti për shkak të politikës së ngarkimit me borxhe apo metodave të tjera të padrejta.

²²¹ Fieberg, ‘Vermögensfragen,’ faqe 213. Përkthyer nga gjermanishtja.

²²² Supozohet se ky ishte një nga kushtet e Bashkimit Sovjetik për të pranuar ribashkimin e Gjermanive. Mikhail Gorbachev e ka mohuar këtë. Knabe, ‘Täter,’ faqe 243-245; Lege, Joachim. 2004. ‘Gleichheit im Unrecht für die Alteigentümer?’ Neue Justiz 9:385-388.

²²³ Fieberg, ‘Vermögensfragen,’ faqe 206. Përkthyer nga gjermanishtja.

²²⁴ Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz. 1990. ‘Gesetz zur Regelung offener Vermögensfragen (Vermögensgesetz).’ <http://www.gesetze-im-internet.de/vermg/BJNR211590990.html>.

²²⁵ Fieberg, ‘Vermögensfragen,’ faqe 207. Përkthyer nga gjermanishtja.

²²⁶ Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 41. Përkthyer nga gjermanishtja.

²²⁷ Konsiderohej i padrejtë posedimi i pasurisë përmes korrupsionit, përmes ushtrimit të pushtetit, mashtrimit apo duke shfrytëzuar pamundësinë e pronarit të mëparshëm.

ndërtesa që ishin përdorur nga komunitetet, ato që kishin ndryshuar destinacion dhe që përdorshin për interes publik, ato që ishin përdorur si ndërtime rezidenciale, ose ato që përdorimi ekonomik i tyre, do të dëmtohej nga kthimi.²²⁸ Kërkesat për kthim u refuzuan edhe në rastet e interesave të caktuara për investime. Këto përfshinë, për shembull, projekte për të krijuar punësim ose hapësira banimi. Në të gjitha këto raste, ish pronarët morën kompensim në vlerë monetare.²²⁹ Vlera monetare erdhi nga një fond kompensimi, i cili u krijua, midis të tjerave edhe nga të ardhurat nga shitja e pronave të shtetëzuara (të cilat nuk ishin objekt konflikti pronësie) përmes privatizimit²³⁰ dhe granteve nga qeveria.

Përkundër të gjitha përpjekjeve të zellshme për të balancuar interesat e kundërta, zgjidhja e çështjes së pronës u kritikua hapur dhe gjerësisht. Ajo u përshkrua shpesh si “gabim në procesin e bashkimit [...] dhe u fajësua për pothuajse të gjitha problemeve të përshtatjes në territorin»²³¹ e ish RDGJ-së. Nga të gjitha anët, njerëzit ndjeheshin në situatë të pafavorshme. Veçanërisht protestat erdhën nga ata që ishin shpronësuar, si pjesë e reformës socialiste të tokës. Megjithatë, ajo që duhet të nënvizohet është se, edhe pse të përjashtuar nga kthimi, ata morën pagesa të barazimit, të cilat ishin jo më pak se pagesat e kompensimit.²³² Kritikët rrallë i nënvizuan vështirësitë e agjencive qeveritare të cilat u përballën me këto probleme në tërësinë e tyre. Siç u përmend më lart, nuk kishte asnjë alternativë të realizueshme edhe të ligjshme në parimin «kthim përpara kompensimit”.

Polemikat mbi çështjet e hapura të pronësisë nuk ishin të dobishme për procesin e rëndësishëm të bashkimit të dy pjesëve të ndara të popullsisë gjermane. Megjithatë, padrejtësitë materiale të kryera nga regjimi i SED, nuk mund të liheshin mënjë pas moszgjidhja e çështjeve të hapura të pronës do të kishte shkaktuar edhe më shumë pakënaqësi dhe do të përbënte një barrë edhe më të madhe për bashkimin.²³³

Deri në fund të vitit 2011, janë përpunuar 99.4 për qind e të gjithë kërkesave për kthimin e pronave lidhur me më shumë se 2.2 milion parcela toke dhe 93 për qind e të gjitha pretendimeve për pagesa kompensimi apo barazimi.²³⁴ 1.9 bilion euro u paguan për viktimat e NS-it në formën e rivendosjes së të drejtës dhe rreth 1.6 bilion euro të tjera iu paguan personave të shpronësuar pas vitit 1945 si kompensim apo barazim nga fondi i kompensimit.²³⁵

²²⁸ Cit. gjithashtu Vermögensgesetz § 4 and 5.

²²⁹ Shih gjithashtu Entschädigungs- und Ausgleichsleistungsgesetz (EALG; Ligji i Kompensimit dhe Barazisë në Pagesa) i 27 shtatorit 1994. Shuma ndryshonte sipas llojit të përdorimit të pronës në fjalë dhe ishte tre deri në njëzet herë vlera e vlerësuar për kohën e shpronësimit për të arritur deri në vlerën aktuale në kohën e bashkimit. Pagesat të marra tashmë, të tilla si pagesa e Barazimit e peshave Ligjit të vitit 1952, u zbriten. “Nga shuma prej 10.000 marka gjermane e tutje, pagesat janë renditur me rënie; pagesat e më shumë se 20.000 marka gjermane, për shembull, janë shkurtuar me 40 për qind, pagesat e më shumë se 3 milion marka gjermane me 95 për qind”. Përkthyer nga gjermanishtja. Lege, ‘Gleichheit,’ faqe 385. Për llogaritjen e pagesave, shih. Klüsener, Robert. 2011. Rechtsstaat auf dem Prüfstand. Wiedervereinigung und Vermögensfragen. Berlin: Lit Verlag, faqe 169.

²³⁰ Këto përfshinin, ndër të tjera, të ardhurat e Agjencisë së Privatizimit (Treuhand) në vlerë prej 3 miliardë marka gjermane, të ardhurat nga shitja e ish pronave shtetërore me ato ish- qytetarëve të RDGJ të cilët kishin fituar tashmë të drejtat e përdorimit, si edhe të personave të tjerë privatë. shih. EALG § 10.

²³¹ Fieberg, ‘Vermögensfragen,’ faqe 206. Përkthyer nga gjermanishtja.

²³² Lege, ‘Gleichheit,’ Knabe, ‘Täter,’ faqe 245-252. Dispozitat e mëtejshme iu drejtuan grupeve të tjera të cilat u përjashtuan nga kthimi. Personat të cilët ishin shpronësuar për shkak të ndërtimit të kufirit të brendshëm – gjerman p.sh. iu dha mundësia për të blerë pronën e tyre me pas, duke paguar një pjesë të vogël të vlerës aktuale ose kishin të drejtë të përfitonin pagesa kompensuese.

²³³ Për shkak të kompensimeve të mëparshme të pasojave të diktaturës dhe luftës, nuk mund të liheshin pa u adresuar padrejtësitë e SED dhe neglizhoheshin apo diskriminoheshin viktimat e SED. Për më tepër, kjo do të kishte shkaktuar pasiguri të konsiderueshme ligjore, qe mund t'i bënte njerëzit të përiqeshin të parashtronin pretendimet me ane të ligjit civil. McAdams, ‘Past,’ faqe 164-166; Bundesministerium der Finanzen. 2007. ‘Die Regelung offener Vermögensfragen.’ http://www.bundesfinanzministerium.de/Content/DE/Standardartikel/Themen/Oeffentliche_Finzen/Vermoegensrecht_und_Entschaeedigungen/Offene_Vermoegensfragen/regelung-offener-vermoegensfragen.html.

²³⁴ Përveç kësaj, duhet përmendur kthimi dhe kompensimi i viktimave të NS, që preken rreth 224,000 pronarë. Vetëm 63 për qind e tyre u trajtuan në kohën e përmendur. Kjo për shkak se marrëdhëniet pronësore kishin ndryshuar shpesh në këto raste, gjë që e komplikonte edhe më tepër situatën. Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 41.

²³⁵ Cit. Ibid.



e) Dokumentimi, Paralajmërimi, Memorializimi

Ndërsa angazhimi kritik me të kaluarën e nacional-socializmit në formën e memorializimit ndodhi gradualisht dhe në disa faza, angazhimi me diktaturën e SED, filloi menjëherë në fazën e trazirave duke proceduar paralelisht me ndjekjen penale, lustracionin dhe dëmtshpërblim me “një intensitet të madh emocional”.²³⁶ Në vend të “nuk duam të dimë” dhe “nuk duam të kujtojmë”, shumica e njerëzve kishte një dëshirë të fortë për të zbuluar se çfarë kishte ndodhur. Kjo i dha forcë një debati intensiv rreth «aspiratave të larta morale».²³⁷

Fokusi i procesit fillestar të përballjes me të kaluarën u përqendrua te Ministria e Sigurimit të Shtetit (MfS). Zbulimi i masës së madhe të spiunimit dhe represionit shkaktoi një goditje të fortë, jo vetëm për ata që zbuluan se miqtë e tyre më të afërt apo anëtarët e familjes kishin qenë spiunë. Dëshira e madhe për transparencë gjeti shprehje në debate të gjata dhe kontroverse në lidhje me mënyrën se si do të trajtoheshin 180 km dosje të shërbimit të fshehtë, të cilat përmbanin informacione për më shumë se gjashtë milion njerëz dhe që ishin grumbulluar gjatë dyzet viteve të ekzistencës së RDGJ –së.²³⁸ Gjermano-lindorët kërkuar që dosjet të bëheshin publike për të ditur shkallën e mbikëqyrjes dhe përfshirjes, dhe sidomos për të qartësuar të kaluarën e tyre. Por qeveria, në të kundërt, kishte frikë se zbulimi i informacionit që ishte grumbulluar nëpërmjet shkeljeve të rënda të privatësisë, mund të shkaktonte përçarje dhe trazira sociale. Kërkesa për transparencë të balancuar dhe pranimit të së kaluarës u ballafaqua me kundërshtimin e klasifikimit të informacionit. Kjo çoi në një kompromis në vitin 1990 ku u përjashtua hapja e përgjithshme por nën një mbrojtje strikte të të dhënave personale, dosjet u bënë të aksesueshme për njerëz që ishin spiunuar, për kërkime historike, proceset gjyqësore, lustracionin dhe rishqyrtimin e pozitave të zyrtarëve qendrorë. Deri më sot, BstU ose autoriteti përgjegjës për dosjet, ka marrë rreth 3 milion kërkesa për tu informuar nga ana e qytetarëve. Sipas informatave nga Fondacioni Federal për Rivlerësimin e Diktaturës së SED, më shumë se 1.8 milionë njerëz kanë aksesuar “dosjet e tyre» deri në vitin 2012.²³⁹ Këto të dhëna ishin të një rëndësie të konsiderueshme për përballjen me të kaluarën. Ato nuk shkaktuan trazira sociale edhe pse hapja e tyre shkaktoi disa skandale sensacionale në media.²⁴⁰

Fokusi i fuqishëm te “Stasi” pati pasoja në perceptimin publik dhe në faktin se anëtarët e MfS-së u konsideruan personat kryesorë përgjegjës për diktaturën e SED. “Demonizimi”²⁴¹ i tyre mjegulloi faktin, se “personat përgjegjës dhe drejtues për veprimet e MfS-së gjendeshin në qeveri dhe se jo çdo bashkëpunëtor ishte një “tradhtar i madh” ose “fajtor kryesor”.²⁴² Vetëm kur vala e madhe emocionale mbi temën e “Stasi”-t kishte kaluar, filloi edhe një kuptim më i diferencuar i fajit, përgjegjësisë, konformizmit dhe oportunitetit. Për pasojë reagimi kaloi në çështje të tjera më të thella dhe më objektive. Kjo kryesisht mund t’i atribuohet fillimit të një «bumi kërkimor»,²⁴³ si edhe të projekteve urgjente mbi dokumentimin dhe kujtesën.²⁴⁴

²³⁶ Wielenga, ‘Geschichte,’ faqe 108. Përkthyer nga gjermanishtja.

²³⁷ Ibid. ‘Schatten,’ faqe 1064. Përkthyer nga gjermanishtja. Ibid., ‘Geschichte,’ faqe 107.

²³⁸ Cit. Mothes dhe Schmidt, ‘Aufarbeitung,’ faqe 192.

²³⁹ Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 20, 52-58; Glatté, ‘German Past,’ faqe. 20; Bundesbeauftragte für die Unterlagen des Staatssicherheitsdienstes der ehemaligen Deutschen Demokratischen Republik. ‘BStU in Zahlen.’ http://www.bstu.bund.de/DE/BundesbeauftragterUndBehorde/BStUZahlen/_node.html.

²⁴⁰ Jo vetëm që gjermano-lindorët u tronditën nga informacionet që mësuan në lidhje me MfS. Një imazh mjaft pozitiv i RDGJ kishte mbizotëruar në RFGJ në rrjedhën e viteve 1970 me fillimin e politikës së relaksimit dhe afrimit në 1980. Edhe gjermanët e perëndimit i përjetuan të tronditur këto shpalosje.

²⁴¹ Vergau, ‘Aufarbeitung,’ faqe 103. Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁴² Wielenga, ‘Geschichte,’ faqe 80. Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁴³ Ibid. faqe 108 Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁴⁴ Cit. ibid. faqe 73-81, 95; Vergau, ‘Aufarbeitung,’ faqe 103.

Të dy komisione hetimore, njëri mbi «Historinë dhe Pasojat e Diktaturës së SED në Gjermani» dhe tjetri mbi «Kapërcimin e Pasojave të Diktaturës së SED në Procesin e Bashkimit të Gjermanive», u themeluan nga Bundestagu në vitin 1992 dhe 1994. Këto u përshkruan nga shumë si “komisionet e së vërtetës” dhe renditen në mesin e autoriteteve qendrore të përbaljes me të kaluarën e RDGJ-së. Komisionet kishin detyrë informimin e publikut në lidhje me diktaturën e SED, përhapjen e njohurive dhe inkurajimin e diskutimit kritik. Për më tepër, ata kishin për detyrë dhënie e rekomandimeve për veprim qeverisë federale lidhur me përbaljen me të kaluarën. Viktimat e shumta, disidentët dhe ekspertët u konsultuan për të zbuluar dhe dokumentuar ngjarjet e diktaturës SED.²⁴⁵

Puna e dy komisioneve hetimore çoi në themelimin e Fondacionit Federal për Rivlerësimin e Diktaturës së SED në vitin 1998. Që atëherë, fondacioni ka promovuar një “angazhim të plotë, të vazhdueshëm dhe pluralist mbi shkaqet, historinë dhe pasojat e diktaturës komuniste, si dhe ndarjen gjermane dhe evropiane”.²⁴⁶ Për këtë qëllim, ai ka organizuar rreth 555 aktivitete deri në vitin 2015, dhe ka botuar më shumë se 200 tekste të shkruara. Përveç kësaj, fondacioni ka mbështetur më shumë se 2.500 projekte të tilla si dokumentarë, gazeta, ekspozita dhe seminare, si dhe punë në vende përkujtimore dhe arkiva.

Këto përpjekje u plotësuan me shërbime që e BStU ofron dhe të cilat variojnë nga ekspozita dhe seminare kërkimore në projekte për nxënësit e shkollave. Përveç kësaj, BStU mban tre qendra informacioni dhe dokumentacioni, si dhe dy faqe mbi dokumentacionin dhe kujtesën. Këtu, qëllimi kryesor është informimi i publikut në lidhje me «strukturat, metodat dhe veprimet e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit».²⁴⁷ Gjithashtu, “Qendra për Histori Bashkëkohore” në Potsdam, “Instituti i Historisë Bashkëkohore” në Berlin dhe “Instituti Hannah Arendt për kërkime mbi Totalitarizmin” në Dresden u janë kushtuar punës dhe kërkimeve historike e të së kaluarës në këto çështje.²⁴⁸

Vendet përkujtimore, memorialët dhe muzeumet kanë një rëndësi të veçantë. Këto përfshijnë qendrat përkujtimore dhe të dokumentimit në vende historike përgjatë ish kufijve të brendshëm të Gjermanisë. Ato tregojnë mbeturinat e instalimeve të kufirit të dikurshëm, dokumentojnë historinë e “Murit” si dhe ndarjen gjermane, gjithashtu edhe histori të veçanta të zonave. Midis më të njohurave janë: Memoriali i Murit të Berlinit i cili përbëhet nga një qendër për vizitorë dhe disa vende përkujtimore. Një nga zonat e ekspozimit i kushtohet “Murit dhe Rripit të Vdekjes” i cili me “Dritaren e Kujtesës” përkujton 138 personat që humbën jetën në Murin e Berlinit.²⁴⁹

Të tjera memoriale janë vendosur në zonat historike të ish burgjeve në gati çdo qendër rajonale të RDGJ-së, si në Berlin-Hohenschönhausen, Erfurt, Halle, Cottbus, Dresden, Schwerin dhe në Bautzen, ku ekspozitat dhe koleksionet u japin vizitorëve një shpjegim të funksionit të qelive të burgut dhe fateve personale të viktimave. Historia e RDGJ-së është temë e të tjera muzeumeve dhe ekspozitave. Kjo përfshin ekspozitën permanente të fondacionit “Shtëpia e Historisë së RFGJ-së”, “Forumit të Historisë Bashkëkohore” në Lajpcig dhe fondacionit “Muzeu Historik Gjerman”.²⁵⁰

²⁴⁵ Për një rrëfim më kritik dhe të detajuar, shih McAdams, ‘Past,’ faqe 88-123.

²⁴⁶ Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 47. Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁴⁷ Ibid. faqe 59. Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁴⁸ Ibid. faqe 47. 59-61, 69-76; Wielenga, ‘Geschichte,’ faqe 108; Vergau, ‘Aufarbeitung,’ faqe. 104. Kërkimet historike të RDGJ nuk filluan me ri-bashkimin. Megjithatë ato u intensifikuan me hapjen e dosjeve.

²⁴⁹ Gedenkstätte Berliner Mauer. 2016. ‘Fenster des Gedenkens.’ <http://www.berliner-mauer-gedenkstaette.de/de/fenster-dg-586.html>; Bundesregierung, Bericht, faqe 79-81.

²⁵⁰ Cit. Bundesregierung, ‘Bericht,’ faqe 92-98, 123-127.



Pavarësisht kërkimeve intensive akademike, dhe bollëkut të dokumentacionit dhe projekteve përkujtimore, të cilat kanë tërhequr disa milionë vizitorë, sot vërehen dy tendenca shqetësuese: së pari, një rënie e njohurive për diktaturën e SED dhe, së dyti, nënvlerësimi dhe glorifikimi i saj.²⁵³ E para mund t'i atribuohet rritjes së një brezi që nuk e ka kujtesën e RDGJ-së. Për të mbyllur këto zbrazëtira njohurish, është shumë e nevojshme të ndërhyhet në edukimin që bëhet nëpër shkolla. Edhe pse historia e RDGJ-së është pjesë e programit mësimor në të gjitha shtetet, studimet tregojnë se shumica e adoleshentëve kanë shumë pak njohuri për të. Shtojmë këtu faktin që vetëm 20 për qind e shoqërisë gjermane ka përjetuar drejtpërdrejt përvojën e RDGJ-së.

Përveç kësaj, interesi publik në historinë e RDGJ-së ka rënë ndjeshëm pas një «bumi» fillestar që pasoi bashkimin e Gjermanive.²⁵² Këtu, është me rëndësi të theksohet se historia e diktaturës SED është lënë në hije nga ajo e «Rajhut të Tretë», si një e kaluar e përbashkët dhe një «katastrofë më të madhe».²⁵³ Edhe pse RDGJ-ja, sipas prognozës së historianit Friso Wielenga, do të nuk zhduket nga kujtesa historike për një kohë të gjatë, «krimet e kryera nga regjimi RDGJ-ja kurrë nuk do të zhyten kurrë aq thellë në kujtesën kolektive sa krimet e nacional-socializmit», dhe diktatura e SED «nuk do të bëhet asnjëherë plagë si e kaluara e naziste».²⁵⁴

Tendanca e dytë e nënvlerësimit dhe lavdërimit, e cila shpesh është referuar si «Ostalgi» ose si «nostalgjia e Lindjes» buron nga vetë ish qytetarët e RDGJ-së.²⁵⁵ Më saktësisht, ajo vjen si pasojë e ndryshimeve radikale që solli bashkimi për ta. Procesi i tranzicionit solli jo vetëm liri të reja dhe mundësi konsumi, por edhe zhvendosje sociale (si normat e larta të papunësisë, rritja e çmimeve, pabarazia sociale, ndjenja e neglizhencës) dhe humbje të identitetit. Kjo provokoi pasiguri, zhgënjim dhe ndjenjën e mbingarkesës nga ndryshimi, madje edhe deri diku atë të «kolonizimit» nga Gjermania Perëndimore. Entuziazmi fillestar për bashkimin shpesh u shndërrua në dëshirë të mohuar të kaluarën dhe refuzim ndaj së resë.

Në këtë kontekst, fokusi tek padrejtësitë e kryera nga regjimi i SED dhe theksi mbi-zotërues i karakterit diktatorial në përkujtimin publik ishte për shumë një zhgënjim, madje më shumë se kaq ishte një imazh i ndikuar nga media se «çdo gjë në RDGJ ishte e keqe».²⁵⁶ Kjo shpesh nuk korrespondonte me kujtimet personale dhe për shumë dukej sikur gjermano perëndimorët po e zëvendësonin historinë e Gjermanisë Lindore dhe se ata po humbnin «jo vetëm kontrollin mbi të tashmen, por edhe mbi të kaluarën e tyre».²⁵⁷ Interpretime të kundërta u shfaqën menjëherë si kundërpërgjigje. Këto ngjajnë shumë me propagandën e SED që e projektonte RDGJ-në si shteti më i mirë gjerman: si shoqëria më humane, në të cilën ishin realizuar vlerat e barazisë, drejtësisë dhe solidaritetit dhe nacional-socializmi ishte eliminuar. Terrori dhe padrejtësia e regjimit të SED nuk ishin pjesë e kësaj narrative.

²⁵³ Cit. ibid. faqe 15.

²⁵² Mungesa e interesit apo një lodhja për t'u ballafaquar me të kaluarën gjeti shprehjen e vet në kërkesat në rritje për të mbyllur këtë kapitull dhe diskutimin mbi këtë temë.

²⁵³ Jarausch, Konrad. 2004. 'Die Zukunft der ostdeutschen Vergangenheit – Was wird aus der DDR-Geschichte?' në: Hüttnann, Jens et. al. (Ed) DDR-Geschichte vermitteln. Ansätze und Erfahrungen in Unterricht, Hochschullehre und politischer Bildung, faqe 81-101. Berlin: Metropol Verlag, veç. faqe 89.

²⁵⁴ Wielenga, 'Schatten,' faqe 1073. Cit. Bundesregierung, 'Bericht,' faqe 65; Knabe, 'Täter,' faqe 22-30; Jarausch, 'Zukunft,' veç. faqe. 81, 89. Përkthyer nga gjermanishtja.

²⁵⁵ I rëndësishëm për paragrafët në vijim. Wielenga, 'Geschichte,' faqe 71-73, 109 ff.; Knabe, 'Täter,' faqe 13-22; Ahbe, Thomas. 2005. Ostalgie: Zum Umgang mit der DDR-Vergangenheit in den 1990er Jahren. Erfurt: Landeszentrale für politische Bildung Thüringen, faqe 36, 42 ff., 64-66; Sabrow, Martin (Ed.). 2009. Erinnerungsorte der DDR. Bonn: C.H. Beck Verlag, faqe 10-22; Großbölting, Thomas. 2010. 'Die DDR im vereinten Deutschland.' Aus Politik und Zeitgeschichte 25-26:35-40; Christoph, Klaus. 2013. 'Aufarbeitung der SED-Diktatur – heute so wie gestern?' Aus Politik und Zeitgeschichte 42-43:27-33

²⁵⁶ Wielenga, 'Schatten,' faqe 1070. Përkthyer nga gjermanishtja

²⁵⁷ Ibid., 'Geschichte'. faqe 72. Përkthyer nga gjermanishtja



Rreth vitit 2005, rreth 30 për qind e gjermano-lindorëve kishin bindjen se RDGJ-ja nuk kishte qenë një diktaturë.²⁵⁸ Në vitin 2010, afërsisht gjysma e gjermano-lindorëve kishte mendimin se RDGJ-ja kishte pasur më shumë aspekte pozitive se sa negative.²⁵⁹ Ka mosmarrëveshje nëse këto zhvillime janë kërcënuese. Nuk duket se kjo tendencë shkon dorë për dorë me refuzimin e sistemit të ri. Vetëm rreth një në dhjetë ish qytetarëve të RDGJ-së dëshiron vërtetë kthimin e saj.²⁶⁰ Kjo është më tepër idealizim i një të kaluarë që kurrë nuk ka ekzistuar dhe njëkohësisht shprehje e pakënaqësive mbi të tashmen.

Për sa i përket bashkimit të brendshëm, disa e konsiderojnë Ostalginë si një mbrojtje të së kaluarës personale, si një mënyrë për krijimin e një vetëbesimi pozitiv dhe si strategji për t'u integruar. Të tjerë interpretojnë tendencën e glorifikimit të së kaluarës si një shprehje dhe shkak i tjetërsimit të brendshëm dhe hendekut mes Lindjes dhe Perëndimit. Sa i përket përkujtimit, glorifikimi mbart rrezikun e shtypjes së kujtimeve të krimeve dhe vuajtjeve të viktimave, duke çimentuar kështu një imazh të shtrembëruar dhe të njëanshëm. Megjithatë, këto tendenca kanë zgjuar kundërshtime dhe debate të shumta për gjetjen e «rrugës së drejtë» për të kujtuar RDGJ-në. Kjo tregon se e kaluara e RDGJ-së është ende një temë e ndjeshme dhe se pranimi i saj ende nuk ka përfunduar. Nëse një pamje e përbashkët që përmbledh gjithë kompleksitetin e regjimit të SED dhe eksperiencat kontradiktore të vendit dhe padrejtësisë do të zhytet thellë në kujtesën kolektive, kjo i takon së ardhmes për të na e treguar.

²⁵⁸ Cit. Knabe, 'Täter', faqe 14.

²⁵⁹ Cit. Christoph, 'Aufarbeitung'.

²⁶⁰ Cit. ibid.



4. Përfundime

Çështja nëse përballja me dy diktatura nga ana e Gjermanisë mund të konsiderohet si e suksesshme, ashtu si në shumë raste të tjera të drejtësisë së tranzicionit, nuk ka çuar në një mendim unanim, apo përgjigje të qartë dhe ndoshta kjo nuk do të ndodhë kurrë. Kjo temë debati është ende mjaft emocionale për tu vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Standardet politike, morale dhe normative janë të shumëllojshme po aq sa edhe idetë mbi drejtësinë, fajin, përgjegjësinë dhe shlyerjen janë shumë të ndryshme. Mendimet rreth prioriteteve dhe qëllimeve janë shumë shpesh «bardhë e zi» për të arritur në një vendim unanim apo edhe në një kategorizim të thjeshtë si sukses apo dështim.

